

Dhjetor 2021  
Numri: 165  
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - [www.progresibotime.com](http://www.progresibotime.com)

# ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë  
Kosovë: 1.5 Euro  
Maqedoni: 90 Den  
Evropë: 7 Euro

## ETIKA NË BOTËN DIGJITALE



revistaetika



progresibotime

Fjala më e bukur është Libri i Allahut. Rruga më e mirë është sunneti profetik. Streha më e sigurt është devotshmëria. Të folurit më me virtyt është përmendja e Allahut.

Tregimet më të bukura gjenden në Kuran. Rrugët më të ndritura janë rrugët udhëzuese të profetëve.

Dija më e mirë dhe më e dobishme, është ajo që kthehet në kulturë. Justifikimi më i keq është ai që bëhet në momentin e vdekjes. Pendimi më i keq, është ai në ditën e kiametit. Pasuria më e mirë, është ajo e zemrës.



Besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një sprovë ndërgegjeje për të gjithë besimtarët.

Allahu i Lartëmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu si ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobëve, të njerëzve me probleme shëndetësore dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: "Pse i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar nevojtarët?" Përgjigjja dihet: "Nevojtarët janë amanet i Allahut (xh.sh.), që ua ka lënë jonevojtarëve." Këtë përgjegjësi e ka dhënë Vetë Allahu.



Kurani Fisnik e përshkruan jetën e kësaj bote si lojë dhe argëtim. Kjo jetë, e cila është një përfitim mashtrues dhe i përkohshëm, është si një shi. Bima që ai e bën të mbijë, i gëzon fermerët. Pastaj ajo bimë fillon të thahet, më në fund bëhet e verdhë dhe më pas kthehet në mbeturinë. Andaj është e nevojshme të mos mashtrohemi në një vend që përbëhet nga lojëra dhe argëtimi dhe ta vlerësojmë atë që është e përhershme, jo e përkohshme. Ato që janë të përhershme janë veprat e mira dhe të dobishme.

Bota digjitale është një nënbotë brenda botës së përkohshme. Përmbajtja e kësaj bote, e cila e ka pushtuar jetën dhe kohën e pothuajse të gjithëve, është e ngjashme me shiun. Është e qartë se ky shi informacioni që bie me gjyma, nuk është frytdhënës dhe kjo e vërtetë shihet nga bimët. Kjo botë, e thurur me perceptime, imazhe dhe ëndrra joreale, rrallë u jep gjëra të përhershme përdoruesve të saj në emër të së vërtetës, kurse shpesh herë i mashtron, i llaston dhe çorienton mendjet.

Bota digjitale; është emri i dhënë mjedisit të komunikimit dhe ndërveprimit të formuar nga interneti, telefonat inteligjentë dhe pajisjet e ngjashme. Kjo botë, në të cilën informacioni i nevojshëm dhe i panevojshëm shpërdorohet, vjedh kapitalin tonë më të çmuar që është koha jonë, dhe më e dhimbshme, zëvendëson jetën me realitetin e saj të rremë. Kufijtë e botës digjitale nuk janë më të kufizuar në temën e ekranit. Që kur teknologjia i ka hequr pengesat për shikimin e njëanshëm ose ndërveprimin e kufizuar, bota digjitale ka marrë një natyrë të re të quajtur realitet virtual.

Realitet virtual; do të thotë prodhim i një realiteti alternativë, të ri në mendjet tona duke tunduar shqisat tona si shikimi, prekja, dëgjimi, nuhatja dhe shijimi. Ky realitet e shtyn të vërtetën në prapavijë, duke lindur një stil jete të rremë dhe të çuditshëm që mund të quhet «të jetosh sikur», dhe ky stil hibrid i jetës, ku realiteti është i përzier me imagjinatën, i shkëput njerëzit nga e vërteta e tyre. Kjo mënyrë jetese, në të cilën pasioni dhe entuziazmi janë kibra e vetme, është e hidhur, sepse është larg gjërave të shenjta, përshtirshmërisë dhe moralit të lartë.

Çfarë dëmi po bën bota digjitale? Si ndikojnë mbi ne pushtet virtuale në të cilët biem dhe shiu i informacionit që bie mbi ne?

## Dhjetor 2021

VITI: XV

NUMRI: 165

## BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

## DREJTOR

Albert Halili

## KRYEREDAKTOR

Alban Kali

## REDAKTOR

Zija Vukaj

## PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

## DIZAJN

Bledar Xama

## ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

## MOBILE

+355 67 340 6182

## E-MAIL

rev.etika@gmail.com

## WEBSITE

www.progresibotime.com

## KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

## MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

## ABONIMI VJETOR


Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrate të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.



Ejani të testojmë fuqinë e besimit tonë  
Doç. dr. Soher Duman

13

# Përmbajtja



8

Mos u mashtro nga loja brenda lojës  
Prof. dr. Sulejman Derin



Pejgamberi dhe jeta jonë  
Ali Byjyçapar

19




11



34

Ramazani dhe Bajrami  
Osman Nuri Topbash

- 5 Bota digjitale ka nevojë për etikë  
Mehmet Lutfi Arslan
- 11 Harta e rrugës  
Ali Riza Temel
- 16 Marrëdhëniet me të afërmit II  
Dr. Adem Ergyl
- 20 Atë e duam shumë  
Adem Saraç
- 22 Të jesh mirënjohës ndaj mirësive  
B. Xhahit Ezedmir
- 24 Mesazhi i Kuranit  
Abdullah Draz
- Të bëhesh Kuran i gjallë
- 29 Dr. Kerim Bulladë
- Përgjegjësia e davetit
- 32 Një Ajet




42

- Ky është një shembull për të gjithë 42  
Xhafer Durmush
- Dhikri 47  
Salih Zeki Meriç
- Macja ka të drejtë 48  
kjo është mendja e kafshëve  
Ekrem Bektash
- Mos thuaj thjeshtë Stomak 50  
Doç. dr. Fërat Erdoan
- Besa e myslimanit 56  
Ferit Piku



44

A mendoni se malet qëndrojnë në vend?  
Dr. Iljas Kandemir



Mbulesa  
Kokje Gënyly

52

# BOTA DIGJITALE KA NEVOJË PËR ETIKË

— Mehmet Lurfi Arslan —

Kurani Fisnik e përshkruan jetën e kësaj bote si lojë dhe argëtim. Kjo jetë, e cila është një përfitim mashtrues dhe i përkohshëm, është si një shi. Bima që ai e bën të mbijë, i gëzon fermerët. Pastaj ajo bimë fillon të thahet, më në fund bëhet e verdhë dhe më pas kthehet në mbeturinë. Andaj është e nevojshme të mos mashtrohemi në një vend që përbëhet nga lojëra dhe argëtimi dhe ta vlerësojmë atë që është e përhershme, jo e përkohshme. Ato që janë të përhershme janë veprat e mira dhe të dobishme.

Bota digjitale është një nënbotë brenda botës së përkohshme. Përmbajtja e kësaj bote, e cila e ka pushtuar jetën dhe kohën e pothuajse të gjithëve, është e ngjashme me shiun. Është e qartë se ky shi informacioni që bie me gjyma, nuk është frytdhënës dhe kjo e vërtetë shihet nga bimët. Kjo botë, e thurur me perceptime, imazhe dhe ëndrra joreale, rrallë u jep gjëra të përhershme përdoruesve të saj në emër të së vërtetës, kurse shpesh herë i mashtron, i llaston dhe çorienton mendjet.

Bota digjitale; është emri i dhënë mjedisit të komunikimit dhe ndërveprimit të formuar nga interneti, telefonat inteligjentë dhe pajisjet e ngjashme. Kjo botë, në të cilën informacioni i nevojshëm dhe i panevojshëm shpërdorohet, vjedh kapitalin tonë më të çmuar që është koha jonë, dhe më e dhimbshme, zëvendëson jetën me realitetin e saj të rremë. Kufijtë e botës digjitale nuk janë më të kufizuar në temën e ekranit. Që kur teknologjia i ka hequr pengesat për shikimin e njëanshëm ose ndërveprimitin e kufizuar, bota digjitale ka marrë një natyrë të re të quajtur realitet virtual.

Realitet virtual; do të thotë prodhim i një realiteti alternativë, të ri në mendjet tona duke tunduar shqisat tona si shikimi, prekja, dëgjimi, nuhatja dhe shijimi. Ky realitet e shtyn të vërtetën në prapavijë, duke lindur një stil jete të rremë dhe



të çuditshëm që mund të quhet «të jetosh sikur», dhe ky stil hibrid i jetës, ku realiteti është i përzier me imagjinatën, i shkëput njerëzit nga e vërteta e tyre. Kjo mënyrë jetese, në të cilën pasioni dhe entuziazmi janë kibla e vetme, është e hidhur, sepse është larg gjërave të shenjta, përsipirtshmërisë dhe moralit të lartë.

Çfarë dëmi po bën bota digjitale? Si ndikojnë mbi ne pusët virtuale në të cilët biem dhe shiu i informacionit që bie mbi ne? Ne nuk mund t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve pa kuptuar natyrën e botës digjitale. Nëse ne nuk mund të identifikojmë dëmin që kjo botë u ka bërë zemrave tona, mendjeve tona dhe lidhjes tonë me realitetin, nuk mund të luftojmë me të dhe ta parandalojmë për të mos e mbuluar të vërtetën. Kjo botë që ndryshon vazhdimisht, që bie ndesh me vlerat tona aktuale dhe botëkuptimin tonë për moralin dhe që i transformon mjetet në qëllime, ka pesë karakteristika kryesore:

1. Shfrytëzimi: Bota digjitale është një botë që e shfrytëzon përdoruesin e saj. Supozohet se shumica e gjërave në këtë botë ofrohen falas. Ndërkohë nuk është kështu. Çdo gjë vjen me një çmim. Kostoja është tregtimi i privatësisë dhe informacionit tonë personal tek palët e treta. Çdo hap që e hedhim si përdorues, çdo faqe që klikojmë, çdo rresht që e shikojmë, çdo kanal që lundrojmë, madje edhe lëvizjet e syve tanë mblidhen dhe klasifikohen, dhe kështu krijohet një bazë të dhënash për ne. Kjo bazë të dhënash, e cila përmban informacionin e gjithsecilit dhe çdo gjëje, të quajtur «të dhëna të mëdha», përpunohet nga inteligjenca artificiale dhe shndërrohet në informacion të tregtueshëm. Njeriu i botës digjitale është një mall i gjurmueshëm, i matshëm dhe i shitshëm. Nuk ka përmbajtje falas, ka përdorues falas.

2. Dominimi i perceptimit: Në botën digjitale, perceptimi ka zëvendësuar të vërtetën. Askujt nuk i intereson se cila është e vërteta. Ajo që

ka rëndësi është se si perceptohen njerëzit ose gjërat. Një fotografi, një shprehje apo një tingull mund të jetë i mjaftueshëm që një gjykim të bëhet shpejt, pa reflektim dhe shpesh pa mëshirë. Nuk ka nevojë për konfirmim dhe nuk ka kureshtje për verifikim, sepse nuk ka kohë. Në fakt, nuk është e nevojshme të shpenzosh kohë për këtë,


sepse informacioni i panumërt për subjekte të panumërta tashmë prodhohet pa pushim. Në një botë ku të gjithë bëhen të famshëm për tri ose pesë minuta, nuk ka mungesë të përmbajtjes. Nuk ka rëndësi çfarë jeni, por mënyra sesi perceptoheni.

3. Shpejtësia, kënaqësia dhe lehtësia: Ideologjia dominuese e kësaj bote është hedonizmi ose, me një fjalë tjetër, «tendenca për të kërkuar lumturi». Shumica vjen për t'u argëtuar, për të qeshur dhe për të kaluar mirë. Çështjet serioze dhe jetësore janë më pak të kërkuara, sepse nuk ka kohë për t'u ndaluar dhe menduar. Ndryshimi është aq i shpejtë sa gjërat e tjera të reja bëhen më dominuese derisa ta kuptoni se çfarë po ndodh. Inovacioni ndjek inovacionin, shqetësimi për të ndryshmen dhe aktualen, e mbulon dhe e vonon kërkimin e së vërtetës. Gjithçka është aq afër sa të arrihet me tri gjeeste (klikim, rrëshqitje, zmadhim). Identitetet dhe ekspeditat virtuale e mbulojnë vështirësinë, frikën dhe rrezikun e realitetit, duke e rritur guximin për të dalë jashtë kufijve të moralit dhe legjitimitetit.

4. Ekspozimi: Në botën digjitale thelbësore është të shohësh dhe të shihesh.

Të shikuarit dhe të vëzhguarit janë mënyra e të ekzistuarit, kurse të shihesh është mënyra e fitimit të kuptimit. Në fazën tjetër të udhëtimit që të gjithë nisin duke thënë «Unë shfaqem, prandaj ekzistoj», ekziston ideali, «marr pëlqime, prandaj kam kuptim». Reputacioni varet nga sa klikime, pëlqime dhe duartrokime merrni. Kurse kjo i ushqen egot. Shpirtrat provokohen. Kështu fillojnë rivalitetet e padrejta dhe të pakuptimta. Njerëzit hyjnë në konkurrencë për të arritur atë që nuk e kanë dhe piren ndaj pamjeve, qëndrimeve

**NJERIU NË BOTËN DIGJITALE DUHET TË LUNDROJË ME ZEMRËN E TIJ, JO ME SYTË E TIJ. MËNYRA PËR TA BËRË KËTË ËSHTË QË TË MOS DALË NGA AGJENDA E ZEMRËS. TË MOS DALËSH NGA AGJENDA E ZEMRËS DO TË THOTË QË ZEMRA TË MOS PREOKUPOHET ME GJËRA QË NUK I INTERESOJNË. KJO ËSHTË NJË MASË E TAKVASË (DEVOTSHMËRISË), SEPSE «TË BRAKTISËSH ATË QË NUK TË PËRKET (NË MËNYRË TË DREJTPËRDREJTË) ËSHTË PREJ ISLAMIT TË MIRË (DEVOTSHMËRISË) TË NJERIUT».**



dhe sjelljeve që nuk kanë të bëjnë me nderin dhe dinjitetin e tyre.

5. Sensacioni: Kapitali i botës digjitale janë lajmet e rreme dhe informacionet e pabaza. Cilado qoftë natyra e saj, e reja, e ndryshmjia dhe interesantja kanë përparësi. Përmbajtja vlerësohet sipas këtij prioriteti, pavarësisht nga qëllimi për të cilin është vënë. Edhe ai që shkon aty nuk ka ndonjë qëllim tjetër. Për këtë arsye gjithmonë bëhet fjalë për ekzagjerim. Qoftë edhe informacioni më i thjeshtë dhe më i qartë duhet të paraqitet me një flluskë (ekzagjerim) në mënyrë që të tërheqë vëmendjen ose të pëlqehet. Popullariteti është për atë që është i jashtëzakonshëm. Ekstremitetet theksohen gjithmonë. Ata që shfaqen janë gjithmonë tipa ekstremë, edhe nëse janë për qortim. Drejtësia, ndershmëria dhe virtyti nuk kanë blerës. Qoftë edhe përmbajtja që shpresohet për mirësi dhe dashamirësi paraqitet kryesisht jo për të tërhequr mëshirë, por për të gjakosur ndërgegjen.

Bota digjitale, për të cilën mund të renditen edhe veçori të tjera, është në thelb një botë ku gjithçka mund të shtrembërohet, joekzistenca tregohet si ekzistuese, supozimi zëvendëson të vërtetën dhe virtualja shtyp realitetin. Këtu nuk mund t'i besojmë asaj që shohim, dëgjojmë ose ndiejmë. Korniza e vizionit e krijuar nga kjo botë është problematike, ajo tërheq syrin para së gjithash. Nuk është e mundur që ndonjë gjë shëruese të dalë nga kjo për zemrën apo kraharorin, sepse kuadri semantik i bazuar te sytë është kryesisht i përbërë nga supozime, perceptime dhe imagjinata. Bota digjitale nga ky aspekt ka një përmbajtje që duhet hetuar. Kushdo që dëshiron të udhëtojë ose të gjendet këtu, duhet të jetë i kujdesshëm sikur po ec në një rrugë të minuar.

Ahlaku/morali, i cili vjen nga e njëjta rrënjë me fjalën krijim (hulk), shpreh aftësitë tona shpirtërore dhe spirituale që formojnë burimin e sjelljeve tona. Morali i lartë është qëllimi i ardhjes sonë në këtë botë. Islami është moral i lartë. I Dërguari i Allahut (a.s.), është dërguar për të plotësuar moralin e lartë. Morali i lartë është thelbësor për të qenë të suksesshëm në vepra të përhershme dhe të dobishme në botën e lojërave dhe argëtimit. Kjo e vërtetë vlen edhe për botën digjitale. Parimet morale të shprehura në Kuranin Fisnik dhe Sunetin e Lartë janë të vlefshme për të gjitha botët, përfshirë këtu edhe botën digjitale.

Mbajtja e drejtësisë, shmangia e syve nga harami, mbrojtja e nderit, bërja e mirësisë, urdhërimi për të mirën, ndalimi i së keqes, fshehja e moszbulimi i saj dhe parime të ngjashme mund të përmenden brenda këtij kuadri. Sidoqoftë, duke pasur parasysh tiparet e lartpërmendura të botës digjitale, katër parimet e mëposhtme janë veçanërisht të rëndësishme:

- Nuk duhet të bredhim pa qëllim dhe synim: Në botën digjitale asgjë nuk humbet. Për këtë arsye, është e nevojshme të mos bredhim në këtë botë pa një qëllim ose synim dhe të mos e ndjekim atë që nuk e dimë, «sepse veshët, sytë dhe zemra janë të gjithë përgjegjës për këto». (Isra, 36)

- Maja e gishtit është jetike: Në botën digjitale, përgjegjësia më e madhe qëndron në majë të gishtit. Maja e gishtit, e cila është tregues i veçantisë i secilit prej nesh, është gjithashtu dëshmitar i gjendjeve dhe veprimeve tona në botën digjitale. As ne, as askush tjetër nuk duhet ta ngarkojë veten për atë që bëjmë me majat e gishtërinjve, sepse «myslimani është një njeri, dora dhe gjuha e të cilit nuk i dëmtojnë të tjerët». (Shik. Buhari, Iman 4-5)

- Mausin duhet ta lëvizim me zemër: Njeriu në botën digjitale duhet të lundrojë me zemrën e tij, jo me sytë e tij. Mënyra për ta bërë këtë është që të mos dalë nga agjenda e zemrës. Të mos dalësh nga agjenda e zemrës do të thotë që zemra të mos preokupohet me gjëra që nuk i interesojnë. Kjo është një masë e takvasë (devotshmërisë), sepse «të braktisësh atë që nuk të përket (në mënyrë të drejtpërdrejtë) është prej Islamit të mirë (devotshmërisë) të njeriut». (Shik. Tirmidhi, Zuhd, 11.)

- Nuk duhet të përcjellim gjithçka: Bota digjitale është vendi ku supozimi, shumica e të cilit është gënjeshtër, qarkullon më së shumti. Çështja nuk është të mos gënjeshtër ose të mos marrësh pjesë në gënjeshtër. Çështja është të mos e shpërndash (tregosh) atë që dëgjohet, ndjehet dhe shihet këtu pa e kaluar nëpërmjet filtrit të zemrës, sepse «njeriut i mjafton si gënjeshtër që t'ua tregojë të tjerëve çdo gjë që dëgjon!» (Muslim, Mukadime, 5.)

Fjala e fundit është kjo: Allahu i Plotfuqishëm dhe i Lartësuar është Zoti edhe i botës digjitale, siç është i të gjitha botëve.

# Mos u mashtro nga loja brenda lojës

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Loja ka një vend të rëndësishëm në edukimin e racës njerëzore. Sepse kur njeriu vjen në jetë, fillon të mësojë përmes lojës, megjithatë, me fundin e fëmijërisë, loja duhet të minimizohet dhe i riu i mençur duhet të ndjekë detyra më të shenjta. Ata që i dorëzohen nefsit të tyre nuk mund të shpëtojnë nga kjo situatë me të cilën janë mësuar në fëmijëri. Sepse, në tharmin e nefsit ekziston dëshira për të bërë vepra të paligjshme (haram) dhe të kota. Imam Rabbani i paralajmëron ndjekësit e tij, të cilët nuk mund ta mbushin jetën e tyre me vepra serioze edhe pse kanë hyrë në rrugën e spiritualitetit:

“Ata nuk duhet ta kalojnë kohën duke luajtur dhe argëtuar... (Njeriu) nuk duhet ta humbasë jetën as me vepra të kota, e lëre më me vepra të ndaluara. Mos bini në një mashttrim të madh duke u kënaqur me instrumente dhe melodi dhe duke i shijuar ato! Sepse instrumenti është një helm në mjaltë.» (Mektubat, Vëll.3, neni 34)

Sidoqoftë, njerëzit po mashtrohen nga kënaqësitë, lojërat dhe argëtimet e kësaj bote dhe lehtë po i harrojnë shpërblimet e botës së përtejme. Zoti i Plotfuqishëm e përshkruan psikologjinë njerëzore në botë si më poshtë:

**“Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbulurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë!.. Jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi e rreme.»** (Hadid, 20)

Në këtë ajet Allahu i Plotfuqishëm përshkruan

proceset nëpër të cilat kalojnë qeniet njerëzore. Kur njeriu vjen në këtë botë, ai së pari fillon me laib/lojën; jetën e mëson përmes lojës, dhe më vonë fillon dëshira për argëtim. Një fëmijë që hyn në moshën e pubertetit nuk mjaftohet më me lodrat dhe lojërat, por dëshiron të shikojë edhe filma, teatër, të dëgjojë muzikë dhe të luajë lojëra në internet. Më vonë, për gjatë adoleshencës, shfaqet dëshira për të zbukuar dhe për të qenë i bukur. Kur moshja të përparojë pak më shumë, dëshira për të studiuar në universitete të mira dhe për t’u mburrur me profesionin dhe fitimet e tij bëhet qëllimi më i madh i të riut. Njeriu i cili as që mendonte të kursente para kur ishte adoleshent, kur të martohet dhe të bëhet me fëmijë në moshë të rritur, i kthehet fitimit dhe kursimit me ambicie të mëdha.

Feja jonë i konsideron të gjitha këto procese si normale përderisa ato nuk i kalojnë kufijtë e shëriatit, ajo nuk e ndalon argëtimin në dasma dhe festa, dhe gëzimin në rrethe legjitime, na inkurajon të fitojmë nga hallalli dhe t’i plotësojmë nevojat e familjes sonë nëpërmjet (atij fitimi). Profeti (a.s.), e këshillon umetin e tij që të mos ecë vërdallë në një mënyrë të çoroditur dhe të jetë i kujdesshëm për veshjen. Por çdo mysliman e di se të gjitha këto procese janë vetëm një mjet, asnjë prej tyre nuk është qëllim në vetvete. Nuk është mençuri që ta humbim jetën tonë të shkurtër për to. Për këtë arsye, Imam Rabbani i drejtohet në mënyrë specifike një nxënësi të ri të tij si më poshtë:

“Biri ynë i çmuar le ta shohë rininë e tij si një pasuri, le të jetë i zënë me edukimin e shkencave fetare dhe të veprojë në përputhje me ato shkencë. Le të kujdeset që të mos e çojë dëm këtë jetë të çmuar në vepra të padobishme dhe të mos e shpërdorojë atë me lojëra dhe argëtime.» (Mektubat, vëll.1, neni 179.)

Sot, një nga problemet tona sociale është se të rinjtë tanë janë të mbërthyer në periudhën e lojës dhe argëtimit dhe nuk mund të heqin dorë nga lojërat dhe argëtimet në adoleshencë dhe moshë të mesme. Bota e lojërave dhe argëtimit të internetit ka kapur rob shumë nga njerëzit tanë, ashtu si alkooli dhe droga. Fjala hamr, e cila përdoret në Kuran për të nënkuptuar pijen, në kuptimin leksikor





do të thotë të mbulosh. Edhe pija është e ndaluar sepse e mbulon mendjen dhe e bën atë jofunksionale. Kur shikojmë jetën moderne të sotme, bota e internetit, ashtu si alkooli, i mpin njerëzit dhe i dëmton aftësinë e tyre të menduarit. Paralajmërimet hyjnore bëhen të parëndësishme për një njeri që e ka robëruar mendjen e tij në botën digjitale. Ajetet e Kuranit Fisnik si: «Shpresohet që të mendoni!», «A nuk mendoni?», bëhen të padëgjueshme në zhurmën e botës së teknologjisë. Aspekti trishtues i kësaj çështjeje është se ndërsa njerëzit tanë e dinë dëmin e substancave që shkaktojnë varësi si droga dhe alkooli dhe përpiqen t'i mbrojnë fëmijët prej tyre, nuk po mundin ta shohin plotësisht dëmin e lojërave dhe argëtimit të botës së internetit që shkaktojnë varësi. Madje, disa prindër tolerojnë qasjen e pakufizuar të fëmijëve të tyre në këtë botë ngaqë fëmijët nuk e preokupojnë veten me gjëra të tjera. Ndërsa kalohet çdo nivel në botën e lojërave dhe argëtimit, të rinjtë tanë zhyten pak më shumë në moçal dhe përsipirtshmëria e tyre pakësohet dita ditës.

Angazhimi me lojëra, argëtim dhe gjëra të padobishme ka qenë gjithmonë i dëmshëm për botën e përtejme. Për fat të keq, lojërat që më parë kërkonin një përpjekje dhe shpenzim të caktuar, tashmë janë bërë lehtësisht të arritshme në çdo kohë të ditës nëpërmjet telefonave inteligjentë dhe pajisjeve digjitale. Është një grup i konsiderueshëm rreth nesh që kalon gjysmën e ditës dhe e shpërdoron pothuajse gjithë natën me lojëra në internet. Për këtë grup, i cili ia ka dorëzuar shpirtin lojërave, realiteti dhe fantazia janë një lëmsh. Divorcet janë rritur për shkak të kohës që bashkëshortët vrasin në internet dhe familjet kanë humbur rehatinë për shkak të rinisë së papunë. Mevlana e krahason situatën e atyre që nuk rriten me mendjen e tyre pavarësisht se janë rritur më moshë dhe nuk largohen nga punët e kota, me fëmijët që luajnë deri në mbrëmje dhe kthehen në shtëpi të uritur. Në të vërtetë, sot njerëzit po ndërtojnë qytete në botën virtuale duke krijuar ferma dhe duke rritur kafshë. Kështu e orvatin veten. Kur të vijë vdekja, të gjithë do ta kuptojnë se janë mashtruar nga një asgjë e madhe:

“Fëmijë, ata luajnë dyqanxhiun... Por ata nuk marrin asgjë tjetër përveç humbjes së kohës nga këto lojëra. Vjen nata dhe fëmija kthehet në shtëpi i uritur... Kjo botë është një vend lojërash, kurse vdekja është nata. Do të kthehesh dhe do të largohesh, por qesja është bosh dhe je i lodhur!” (Mesnevi, vëll.2, 2596-600)

Sipas sufistëve, gjithçka që na orvat në rrugën drejt së vërtetës është lojë dhe argëtim, edhe pse këto mund të duken serioze për njerëzit. Sidomos

argëtimet që nuk kanë dobi për këtë botë dhe botën tjetër janë lojë brenda lojës. Zoti (xh.xh.), bën kërcënimin e mëposhtëm për ata që e kthejnë jetën e tyre në lojëra dhe argëtime:

**“Largohuni nga ata që fenë e tyre e marrin si lojë dhe dëfrim e që janë mashtruar nga jeta e kësaj bote. Këshilloji ata me Kuranin, me qëllim që të mos i humbasin shpirtat e tyre për shkak të veprave të veta. Përveç Allahut, ata nuk do të kenë as ndihmës, as ndërmjetës. Edhe sikur të ofrojnë çdo lloj shpagimi, nuk do t'u pranohet. Këta janë ata që do të lihen në humbje për shkak të veprave që kanë bërë. Ata do të pinë ujë të valuar dhe do të kenë dënim të dhembshëm për shkak të mosbesimit të tyre.”** (En'am, 70)

Fukahatë (juristët myslimanë) tanë kanë arritur në përfundimin e mëposhtëm në lidhje me lojërat që nuk i sjellin dobi trupit të njeriut dhe që ia çojnë dëm jetën atij: “Të luash lojëra me gurë si tavllë dhe shah është mekruh. Sepse të gjitha këto janë të pakuptimta. Nëse luhet bixhoz me këto, është haram... Të luash me to pa para është një preokupim i kotë, është punë e kotë ” I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: «Argëtimi i besimtarit është i pavlefshëm përveç tri gjërave: Stërvitja e kalit, marrja e mësimit për gjuajtjen e shigjetës dhe bërja e shakave me bashkëshorten e tij.» (Hidaye)

Në ditët e sotme ka lojëra shumë më të dëmshme se këto dhe luhen në internet. E njëjta dispozitë vlen edhe për lojërat virtuale. Për t'i mbrojtur të rinjtë tanë nga varësia ndaj internetit, duhet t'i orientojmë te sportet e dobishme si hipizmi, gjuajtja me hark dhe mundja që përmenden në hadithe. Së fundi, është e domosdoshme t'i mësojmë të rinjtë tanë ta përdorin botën digjitale me mençuri. Në fakt, falë kësaj teknologjie, mësimi i një gjuhe të huaj dhe arritja e informacionit të dobishëm pothuajse për çdo lëndë është bërë jashtëzakonisht e lehtë. Gjëja e rëndësishme është të mos bëhemi skllav i këtyre mjeteve përgjatë përdorimit të tyre. Le të mos harrojmë se pas çdo mjeti dhe programi dixhital që përdorim, gjenden dhjetëra inxhinierë që punojnë shumë për të na mbajtur në këtë botë dhe përpiqen të na bëjnë të varur duke përdorur të gjitha llojet e teknikave psikologjike. Sepse çdo i ri që humbim në internet është një fitim financiar për ta. Lutja jonë nga Zoti është që t'i mbrojtë të rinjtë tanë nga tundimet e kohës dhe të na e mundësojë t'i rrisim ata si individë besimtarë dhe të ndërgjegjshëm. Le ta përfundojmë artikullin tonë me hadithin e mëposhtëm të Resulullahut (a.s.): «Kur njeriu i lë gjërat boshe (që nuk i interesojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë), kjo tregon përkushtimin e tij ndaj fesë.» (Ibn Maxhe, «Fiten», 12; Tirmidhi, «Zuhd», 11.)

# HARTA E RRUGËS

— Ali Riza Temel —

ÇDOKUSH ME MENDJE DUHET TA DIJË SE ËSHTË NË NJË UDHËTIM QË, OSE DO TA ÇOJË NË XHENET, OSE DO TA ÇOJË NË XHEHENEM. ANDAJ DUHET T'I BËJË LLOGARITË DHE TË PËRJETOJË ENTUZIAZMIN E SHKUARJES NË XHENET DHE PAMJES SË BUKURISË SË ALLAHUT DUKE VEPRUAR SIPAS SIRATI MUSTAKIMIT (RRUGËS SË DREJTË).

Jeta është rruga, kurse njeriu është udhëtar. Siç ka thënë poeti: Jemi në një rrugë të gjatë dhe të ngushtë, kështu ecim ditë e natë. Çdo rrugë ka një fillim dhe një fund. Një person që nuk e di destinacionin dhe drejtimin e tij është si një anije pa busull që shkon në të panjohurën. Ata që nisen pa një hartë, busull ose udhëzues, nuk mund të arrijnë kurrë në destinacionin e synuar dhe e kalojnë një jetë të tërë në një gjendje të humbur dhe të hutuar.

Sipas shprehjes së Kuranit Fisnik, Allahu Teala është i pari pa fillim, i fundit pa fund, i dukshmi me veprat e tij dhe i padukshmi me urtësinë e tij. Nëse nuk ekziston ai i Pari, ekzistenca e të cilit është e domosdoshme, nuk mund të ekzistojë asgjë. Ajo genie supreme krijoi botën e ekzistencës për ta

njohur dhe adhurar atë. Ai e bëri njeriun mëkëmbësin e tij në botën e ekzistencës dhe e bëri atë më të nderuarin nga krijesat e tij.

Sipas shumicës së dijetarëve myslimanë, së pari u krijuan shpirtrat e njerëzve. Për këtë arsye, pika fillestare e udhëtimit është faza e krijimit të shpirtave. Në një hadith fisnik, Pejgamberi ynë i nderuar ka thënë: «Shpirtrat janë si ushtri të mbledhura. Ata që pajtohen me njëri-tjetrin në botën e shpirtave, gjithashtu pajtohen me njëri-tjetrin edhe në këtë botë. Ata që nuk pajtohen me njëri-tjetrin atje, nuk pajtohen edhe në këtë botë.» (Buhari, Enbija: 2.)



Ky hadith fisnik thotë se shpirti është krijuar para trupit. Nuk është e mundur të njohësh me siguri natyrën e shpirtit. Sipas shprehjes së Kuranit, ai është një çështje hyjnore. Sidoqoftë, brenda kuadrit të pikëpamjes së shumicës së dijetarëve, shpirti është e mundur të përshkruhet si më poshtë. «Është një frymë perceptuese hyjnore që hidhet në trupin e njeriut nga një engjëll gjatë formimit të tij në barkun e nënës - në moshën njëqind e njëzet ditë - dhe që hiqet nga trupi i njeriut në kohën e vdekjes.» Ky shpirt është ai që e dallon njeriun nga gjallesat e tjera. Ky shpirt njerëzor është i ndryshëm nga shpirti shtazor që gjendet te gjallesat e tjera. Ajo që e bën njeriun superior edhe ndaj engjëjve, nëse zhvillohet, është kjo frymë hyjnore.

Në lidhje me botën shpirtërore, bëhet fjalë për «elest bezmi», në ajetin e 172-të të sures A'raf thuhet: **«Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre, u tha: “A nuk jam Unë Zoti juaj?” Ata u përgjigjën: “Po, dëshmojmë se Ti je.” Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Kiametit: “Këtë nuk e kishim ditur.”»**

Edhe pse ka nga ata që e kuptojnë ajetin e mësipërm në këtë kontekst, duket më e arsyeshme që pyetja dhe përgjigja e deklaruar në ajet janë metaforike. Sipas mendimit të shumë dijetarëve të tefsirit, ngjarja e marrjes së fjalës dhe mbajtja e një dëshmitari të shprehur në ajet ka një kuptim përfaqësues. Allahu i Plotfuqishëm i ka krijuar të gjitha qeniet njerëzore me aftësinë për ta njohur Atë dhe për t'u bërë myslimanë, e ka forcuar këtë aftësi me dëshmi objektive dhe subjektive dhe i ka pajisur ata me natyrshmërinë që të thonë: «Po, ti je Zoti ynë.», kur të pyeten: «A nuk jam unë Zoti juaj?» Premtimi dhe dëshmia e përmendur këtu nuk janë një shembull teologjik, por një marrëveshje aktuale dhe e natyrshme. Kjo pikë është pika fillestare e religjiozitetit. Gjëja thelbësore është të jesh fetar duke dëgjuar zërin e natyrshmërisë. Afetarizmi është një gjendje e prishur e natyrshmërisë.

Faza e dytë e udhëtimit të jetës është mitra e nënës. Formimi në mitrën e nënës si rezultat i martesës së prindërve, përfundon në formën e formimit biologjik duke ndjekur fazat si nutfe/zigota - alaka/gjak i ngjizur - mudga/copë mishi - kockat - veshje e kockave me mish. Pastaj, në aspektin shpirtëror, njeriu arrin përsosmërinë. Kjo fazë është etapa në të cilën shpirti fryhet në trup nga engjëlli i caktuar prej Allahut. (Buhari, Bedul-halk, 5, hadithi nr: 3208.) Ky formim i mrekullueshëm në mitrën e nënës tregon për mjeshtërinë dhe fuqinë madhështore të Allahut



të Madhëruar. **«Është Ai që ju formëson në barkun e nënave tuaja si të dojë.»** (Alu Imran, 6)

Faza e tretë e udhëtimit është ardhja në këtë botë: Qëllimi i ardhjes në këtë botë është njohja e Allahut, adhurimi i Tij, bërja e vepra të mira, të jetuarit në përputhje me natyrën dhe kalimi i sprovës së nënshtrimit ndaj Zotit. Ahireti fitohet ose humbet në këtë botë. Të gjithë në këtë botë mbajnë përgjegjësi në masën e fuqisë dhe mundësive të tyre. Sjellja e papërgjegjshme dhe indiferente e një personi i cili është mëkëmbës i Allahut dhe amaneti i Tij në tokë është e papajtueshme me misionin e adhurimit dhe humanizmit. Njeriu duhet të jetojë në këtë botë me një përpikëri që mund të japë llogari për çdo fjalë dhe sjellje. Përndryshe, mund ta shkatërrojë edhe këtë botë, edhe ahiretin e tij.

Faza e katërt e udhëtimit është jeta e varrit-berzahut që fillon me vdekjen. Kjo fazë vazhdon deri në shpërthimin e kiametit. Është si një zonë tampon midis apokalipsit (kiametit) dhe kësaj bote. Siç janë shprehur disa dijetarë, është një gjendje gjumi, është një fazë në stilin për të pasur ëndrra të trishtueshme dhe të këndshme. Siç thuhet në hadithin fisnik, varri është ose një kopsht nga kopshtet

e Xhenetit ose një gropë nga gropat e Xhehenemit. Përsëri, siç thuhet në hadithin fisnik, besimtari jeton atje duke parë parajsën (xhenetin) në të cilën do të hyjë përjetësisht, kurse jobesimtari duke parë ferrin (xhehenemin) ku do të qëndrojë përgjithmonë. Atje profetët, të sinqertët, të drejtët dhe martirët bëjnë një jetë ndryshe nga të tjerët. Varri është një stacion shpirtëror i rrethuar nga vepra të mira ose të këqija. Në varr, ndëshkimi dhe shpërblimi janë të vërtetë.

Faza e pestë e udhëtimit është faza e ngritjes nga varret nëpërmjet fryrjes së surit, domethënë është faza e një lloji ngritjeje nga varret me borinë e ngritjes dhe mbledhja në mahsher për të dhënë llogari. Kjo është faza që ndodh pasi shpërthen apokalipsi dhe të gjitha gjallesat vdesin. Skena e apokalipsit përshkruhet në mënyrë të tmerrshme në Kuran. Kur të përfundojë faza e mahsherit në të cilin mblidhen të gjitha gjallesat, hapen regjistrat e veprave, vendosen peshoret, llogaritjet bëhen në mënyrën më të ndjeshme, disa fytyra do të buzëqeshin dhe disa të tjera do të nxihen nga zemërimi dhe trishtimi në poshtërim si rezultat i gjykatës së madhe dhe të gjithë do të shkojnë ose në xhenet, ose në xhehenem si shpërblim apo ndëshkim i veprave të tyre. Jobesimtarët do të shtyhen grupe-grupe në Xhehenem dhe, kur të arrijnë atje, do të hapen dyert e tij dhe rojtarët do t'u thonë atyre: ***“A nuk ju kanë ardhur të dërguar midis jush, të cilët ju lexonin shpalljen e Zotit tuaj e ju tërhiqnin vërejtjen për takimin e kësaj dite?!”*** Mohuesit do të thonë: ***“Po, është e vërtetë!”*** E kështu përmbushet fjala e Allahut për dënimin e mohuesve. ***Atyre u thuhet: “Hyni në portat e Xhehenemit, ku do të qëndroni gjithmonë!”*** Sa vend i shëmtuar që është ai për mendjemëdhenjtë! Ndërsa ata që i janë frikësuar Zotit të tyre, do të çohen grupe-grupe në Xhenet. Kur t'i afrohen atij, dyert e tij do të hapen e rojtarët e tij do t'u thonë atyre: ***“Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, andaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!”*** (Zumer, 70-73)

Mbërritja në xhenet dhe xhehenem do të bëhet përmes siratit. Ndërsa besimtarët do të kalojnë lehtësisht, jobesimtarët do të bien në zjarr dhe do të dënohen përgjithmonë në xhehenem. E gjithë çështja ka të bëjë me faktin nëse është vepruar apo jo sipas sirati mustakimit (rrugës së drejtë) përgjatë qëndrimit në këtë botë. Sepse kjo botë është shkaku, kurse ahireti është rezultati. Siç nuk është e mundur të vlerësohen bukuritë e jetës së xhenetit sipas standardeve të kësaj bote, po ashtu nuk është e mundur të përshkruhen tmerret e jetës së xhehenemit në këto dimensione.

Aventura e jetës, e cila fillon me krijimin e shpirt-rave, vazhdon me etapat e barkut të nënës, dynjanë, botën e varrit, apokalipsin dhe mahsherin, përfundon me xhenetin ose xhehenemin. Ky përfundim nuk do të thotë zhdukje, por nënkupton arritjen në stacionin e fundit.

Çdokush me mendje duhet ta dijë se është në një udhëtim që, ose do ta çojë në xhenet, ose do ta çojë në xhehenem. Andaj duhet t'i bëjë llogaritë dhe të përjetojë entuziazmin e shkuarjes në xhenet dhe pamjes së bukurisë së Allahut duke vepruar sipas Sirati Mustakimit (Rrugës së Drejtë). Ky është fitimi i vërtetë. Përndryshe, të gjitha përfitimet e kësaj bote do të humben dhe do të jenë shkak për pakënaqësi dhe katastrofë. Allahu na bëftë nga ata që ecin dhe arrijnë lumturinë e përjetshme nën drejtimin e profetëve, jo nën drejtimin e shejtanëve!

ÇDO RRUGË KA NJË FILLIM  
DHE NJË FUND. NJË PERSON QË NUK E DI  
DESTINACIONIN DHE DREJTIMIN E TIJ  
ËSHTË SI NJË ANIJE PA BUSULL  
QË SHKON NË TË PANJOHURËN. ATA QË NISEN  
PA NJË HARTË, BUSULL OSE UDHËZUES, NUK  
MUND TË ARRIJNË KURRË  
NË DESTINACIONIN E SYNUAR  
DHE E KALOJNË NJË JETË TË TËRË  
NË NJË GJENDJE TË HUMBUR  
DHE TË HUTUAR.



# Ejani të testojmë fuqinë e besimit tonë

— Doç. dr. Soner Duman —

**NDRYSHIMET NË BOTËN TONË SHPIRTËRORE KANË PATJETËR DISA SHENJA QË REFLEKTOHEN NË BOTËN E JASHTME. DUKE PARË ATO SHENJA, JU MUND TA KUPTONI SE ÇFARË NDRYSHIMESH KANË FILLUAR TË NDODHIN NË BOTËN E BRENDSHME TË NJË PERSONI. EDHE PSE BAZA E BESIMIT ËSHTË NË ZEMËR, NËSE DRITA E KËTIJ BESIMI ËSHTË E FORTË APO E DOBËT DUKET NGA VEPRIMET E REFLEKTUARA JASHTË.**

Tani do t'ju ofroj diçka interesante: A dëshironi të testoni forcën e besimit tuaj?

E dini, ekziston testi i alkoolit që bën policia e qarkullimit rrugor. Kur njeriu fryn në pajisjen matëse, bëhet e qartë nëse ai pi alkool apo jo, dhe nëse po, sa promilë alkool ka marrë. Ka edhe teste të inteligjencës. Kur e bëni atë, ju mësoni nivelin

e inteligjencës tuaj sipas rezultatit që merrni. Tani ejani të bëjmë një test besimi së bashku dhe të përpiqemi të përcaktojmë nëse besimi ynë është i fortë apo i dobët.

Mund të dalë dikush dhe të pyesë: «Profesor, besimi është diçka në zemër. Pastaj populli thotë: «Nuk dihet se kush ka para dhe besim. Si do ta



matim forcën e besimit?” Po, por gjithçka ka një shenjë. Për shembull, si e kuptoni se ushqimi ka filluar të priset? Mund ta dalloni nëse shija ka ndryshuar dhe nëse ka erë të keqe, apo jo? Si e kuptoni se do të bjerë shi? Mund ta kuptoni ose nga dhimbjet e reumatizmit tuaj, ose nga era e fortë, ose nga vranësirat, ose nga bubullimat në qiell. Faktin që uji është afër vlimit, mund ta kuptoni kur fillon të avullojë dhe të nxjerrë flluska të vogla.

Ndryshimet në botën tonë shpirtërore kanë patjetër disa shenja që reflektohen në botën e jashtme. Duke parë ato shenja, ju mund ta kuptoni se çfarë ndryshimesh kanë filluar të ndodhin në botën e brendshme të një personi. Edhe pse baza e besimit është në zemër, nëse drita e këtij besimi është e fortë apo e dobët duket nga veprimet e reflektuara jashtë.

Ne mund të kuptojmë nga sa vijon se drita e besimit në zemrën e një myslimani ka filluar të dobësohet dhe të venitet:

### 1. FJALA E ZOTIT NUK E PREK ATË

Kur emri i Allahut, Zotit të botëve, përmendet në praninë e një personi që ka një besim të shëndoshë, fillon një trazirë në botën e tij të brendshme. Kur i lexon dhe i dëgjon ajetet e Tij, fuqia e dritës së besimit në zemrën tij rritet. Leximi dhe dëgjimi i ajeteve është sikur të ndezësh zjarrin e besimit në zemrën e tij. Shikoni se çfarë thotë Zoti (xh. xh.): «*Besimtarët janë vetëm ata zemrat e të cilëve dridhen kur përmendet Allahu, të cilëve u shtohet besimi i tyre kur u lexohen ajetet e Allahut dhe që i besojnë e i mbështeten vetëm Zotit të tyre.*» (Enfal, 2) Për shembull, ju sapo e lexuat këtë ajet, edhe unë sapo e shkrova. Edhe unë, edhe ju duhet t'i hedhim një vështrim të shpejtë botës sonë shpirtërore. Vallë, a e forcoi ky ajet besimin tonë?

### 2. TË MOS NDIKOHESH NGA VDEKJA

Treguesi më i rëndësishëm që besimi i një personi ka filluar të dobësohet është se ai fillon ta shohë vdekjen si një ngjarje e zakonshme. Ndërkohë vdekja duhet të tronditë thellë çdo besimtar, sepse vdekja nënkupton përfundimin e sprovës. Askush prej nesh nuk e di se kur do të vdesim dhe si do të përfundojë provimi ynë. Asnjë prej nesh nuk është i garantuar se do të vdesë me besim. Ne kemi mendime të mira për Zotin (xh. xh.), por nuk kemi asnjë garanci prej Tij për këtë. Kurse pas vdekjes, ka një jetë të përjetshme. Nëse

një njeriu nuk i trazohet bota e tij e brendshme kur mendon për të, kjo do të thotë që besimi i tij është dobësuar.

### 3. NEGLIZHIMI I ADHURIMEVE, PËRTACIA PËRGJATË KRYERJES SË TYRE APO BRAKTISJA E TYRE

Një njeri me një besim të fortë nuk i neglizhon ibadetet e tij dhe nuk shfaq dembelizëm në lidhje me to. Braktisja e adhurimit është një punë që mund ta bëjnë ata që pasojnë nefsën dhe zhyten në epshet e tyre. Zoti (xh.xh.), e përshkruan devijimin nga rruga e pejgamberëve e brezave që vinin pas profetëve pas largimit të këtyre të fundit nga kjo botë siç vijon: “*Pas tyre erdhi një brez që e braktisi namazin dhe ndoqi dëshirat vetjake. Prandaj, ata do të ndëshkohen për çoroditjen e tyre në të ardhmen.*» (Merjem, 59)

Përtacia dhe plogështia në adhurim ishte diçka që e bënin hipokritët. Zoti (xh.xh.), e përshkruan gjendjen e tyre si më poshtë: “*Sigurisht, hipokritët përpiqen të bëjnë lojë me Allahun. Ndërkohë Allahu ua shemb mbi kokë ato lojëra. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, shfaqen para njerëzve dhe e përmendin pak Allahun.*» (Nisa, 142)

Nëse një njeri nuk i kryen fare ibadetet, nëse ka filluar t'i braktisë ato edhe pse i ka bërë më parë, nëse nuk ndjen pendim kur i neglizhon dhe nuk përpiqet t'i kompensojë ato, atëherë do të thotë se besimi i tij ka filluar të dobësohet.

Nëse një njeri e vonon detyrën e tij ndaj Zotit (xh.xh.), për shkak të përfitimeve të kësaj bote apo lojërave dhe argëtimit, atëherë do të thotë se aty ekziston një problem. Si i ka paralajmëruar Zoti, xh.le xhelaluhu, sahabët që e lanë namazin e së Premtes (Xhumanë) pasi ndoqën karvanin që kishte shkuar me lojëra dhe argëtim ditën e premte: “*Mirëpo, sa herë që ata shohin ndonjë tregti ose lojë, shkojnë tek ajo e të lënë ty në këmbë. Thuaj: “Ajo që është tek Allahu, është më e mirë nga argëtimi e nga tregtia.” Allahu është Dhuruesi më bujar.*» (Xhuma, 11)

### 4. INJORIMI I MËKATEVE, VONIMI I PENDIMIT

Nëse besimi i një njeriu është i fortë, ai pendohet menjëherë kur i shkel kufijtë e Zotit (xh.xh.), shqetësohet për këtë dhe e rregullon veten. Por nëse besimi i tij ka filluar të dobësohet, ai fillon të mos u japë më rëndësi mëkateve. Pendimin e vonon duke thënë: «Do të pendohem më vonë.» Kështu fillon ta shikojë vdekjen si të largët.

**NËSE NJË NJERI NUK I KRYEN FARE IBADETET, NËSE KA FILLUAR T'I BRAKTISË ATO EDHE PSE I KA BËRË MË PARË, NËSE NUK NDJEN PENDIM KUR I NEGLIZHON DHE NUK PËRPIQET T'I KOMPENSOJË ATO, ATËHERË DO TË THOTË SE BESIMI I TIJ KA FILLUAR TË DOBËSOHET.**



## **5. MOSSHFAQJA E NDJESHMËRISË NDAJ KUFIJVE HALLALL-HARAM**

Nëse besimi i një njeriu është i fortë, ai i përmbahet kufirit hallall-haram në të gjitha gjendjet dhe veprimet e tij. Ai i kushton vëmendje të madhe shmangies nga rënia në haram. Por kur besimi fillon të dobësohet, rënia në haram nuk përbën më problem për të. Atij nuk i intereson më nëse ajo që ha, vesh, shikon apo dëgjon është hallall.

## **6. NUK DO PËR HIR TË ALLAHUT DHE E BRAKTIS ZEMËRIMIN PËR HIR TË ALLAHUT.**

Një njeri me besim të fortë nuk e merr egon e tij si masë se kë, sa dhe si do ta dojë, por merr fjalën e Zotit të tij dhe sunetin e të Dërguarit të Allahut si udhëzues. Ai i do ata që Allahu dhe i Dërguari i Tij thonë «dua» dhe nuk i do ata që thonë «mos i dua». Por kur besimi të fillojë të dobësohet, njeriu fillon ta marrë si masë veten e tij në dashuri dhe urrejtje. Zoti (xh.xh.), thotë: «*Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Allahu ka skalitur besimin në zemrat e tyre dhe i ka fuqizuar ata me shpalljen e Vet.*» (Muxhadile, 22)

## **7. MOS SHFAQJA E INTERESIT DHE SHQETËSIMIT PËR NJERËZIT E DOBËT NË SHOQËRI**

Në shumë sure të shpallura në Mekë, Kurani krahas besimit, ka urdhëruar edhe interesimin dhe krijimin e marrëdhënieve me jetimët, njerëzit e mbetur në rrugë dhe me të dobët në shoqëri, dhe ka deklaruar se jobesimtarët nuk tregojnë ndonjë interes për këto grupe. Nëse nuk tregoni interes dhe shqetësim për njerëzit e pafuqishëm, do të thotë që besimi juaj ka filluar të dobësohet. Zoti (xh.xh.), thotë: «*A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë? Ky është ai që i dëbon ashpër*

*jetimët dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit.*» (Maun, 1-3)

«*Nuk është kështu! Por ju nuk silleni mirë me jetimët dhe nuk e nxitni njëri-tjetrin për t'i ushqyer të varfrit. Trashëgiminë (e të dobëtëve) e zhatni me lakmi të pangopur dhe e doni pasurinë me një dëshirë të pakufishme.*» (Fexhr, 17-20)

## **8. TË MOS QËNDROSH ME BESIMTARËT, POR ME JOBESIMTARËT DHE MËKATARËT**

Një njeri me besim të fortë nuk shoqërohet me njerëz të këqij. Ai veçanërisht nuk qëndron me ata që tallen me Kuranin dhe Islamin dhe ata që e mohojnë atë. Ai qëndron me njerëz të mirë. Zoti (xh.xh.), e shpalos këtë të vërtetë në Kuran si më poshtë: «*Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata* (njerëz që veprojnë kështu), *derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të bëheni si ata. Allahu do t'i tubojë në xhehenem të gjithë hipokritët dhe mohuesit.*» (Nisa, 140)

«*O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe qëndroni me ata që thonë të vërtetën* (që fjalët dhe veprat i kanë të njëjta).» (Teube, 119)

I Dërguari i Allahut (a.s.), është shprehur se shoqëria jote është shenjë e besimit tënd duke thënë: «*Njeriu është në fenë e shokut të tij. Pra, le të shohë secili prej jush se me kë është shok!*» (Ebu Davud, «Edeb», 19; Tirmidhi, «Zuhd», 45.)

Ka edhe shumë gjëra të tjera me të cilat mund ta testojmë besimin tonë, por le ta përfundojmë këtu këtë artikull që zaten zgjati shumë. Tani secili prej nesh ka në dorë masa me anë të të cilave mund ta provojë nëse besimi ynë është i fortë apo jo. Zoti na e forcoftë besimin, na e mundësoftë të bëjmë vepra të mira, na i faltë mëkatet dhe na i pranofte përpjekjet tona!

# Marrëdhëniet me të afërmit II

— Dr. Adem Ergyl —

Fakti që një person është i dashur, i respektuar dhe i kërkuar nga zemra në sytë e të afërmeve të tij më të afërt, larg nga pamja artificiale, tregon virtytin dhe cilësinë e personalitetit të tij. Sepse është e vështirë ta ruash dashurinë dhe respektin në marrëdhëniet dhe afrimetet afatgjata. Personalitetet e papjekura që nuk kanë marrë tezkije/pastrim shpirtëror dhe terbiye/trajnim fetar, shpesh janë të prirë t'i shohin njerëzit përreth tyre si skllëvër, pasi ata gjithmonë vënë kënaqësinë dhe interesat e tyre në qendër. Natyrisht, është e paimagjinueshme që njerëzit me moral të tillë të kenë marrëdhënie arbitrare afatgjata. Miqtë e Zotit në marrëdhëniet e tyre veprojnë me frymën e “ihlasit/sinqeritetit”, “ihsanit/mirësisë”, “ikra-

mit/nderimit” dhe madje “isarit/altruizmit”, që do të thotë t’u japësh përparësi të tjerëve ndaj vetes, ngaqë ata janë të çliruar nga papjekuria e nefsit të tyre. Si rezultat i kësaj, shfaqet një pamje madhështore e marrëdhënieve që u jep paqe zemrave. Si shembull, do të doja të citoja disa kujtime nga të afërmit e Sahibu’l-vefa Musa Efendiut rreth marrëdhënieve me të afërmit:

Vëllai i tij, zoti Abidini tregon:

“Vëllai im i madh, hoxha ynë Musa Efendi dhe unë jemi prej një babai; por nënat tona janë të ndryshme. Por për sa kohë që e kam njohur veten, e kam njohur Musain si baba. Sepse babai ynë ndërroi jetë kur unë isha tre vjeç. Megjithëse nuk jetonim me vëllain tim, Musain në një shtëpi, personi që ishte në pozitën e kryefamiljarit për mua ishte vëllai im, Musai. Kjo ishte kështu edhe





materialisht, edhe shpirtërisht. Kjo situatë vazhdoi kështu për vite të tëra. Vëllai im, Musai patjetër vinte çdo ditë në shtëpinë tonë. Nuk mbaj mend ndonjë ditë kur ai nuk ka ardhur në shtëpinë tonë. Pra, mendoni pak, jeni tre vjeç, jeni pesë vjeç, jeni dhjetë vjeç dhe kjo situatë akoma vazhdon kështu... Vëllai juaj i madh do të vijë në mbrëmje, ju e dini këtë... Me thënë të drejtën, edhe bashkëshortja e tij e ndërjer gjithmonë na mbështeti në këtë çështje. Më vonë, zoti Osman Topbashi dhe unë u rritëm duke e kaluar fëmijërinë së bashku. Unë isha një fëmijë më agresiv. Mes nesh ndodhnin grindje fëmijësh. Tani që e mendoj, ata nuk më fajësonin mua edhe pse isha tetëdhjetë, nëntëdhjetë përqind fajtor. Madje bashkëshortja e ndërjer e vëllait, thoshte, "Ky (Osmani) e ngacmon atë, prandaj ndodh kjo." - dhe qeshte. Ishte një jetë e tillë. Ai na shërbente si një baba çdo ditë përgjatë fëmijërisë dhe kurrë nuk bëri dallim mes meje dhe zoti Osman Topbashit. Të dyve na blinte njësoj, na ushqente njësoj dhe na vishte njësoj. Madje, ndonjëherë kur shkonim për të bërë fotografi, njerëzit mendonin se ishim binjakë ngaqë ishim të afërt në moshë. Dua të them, në çdo fazë të jetës ai më trajtoi në një mënyrë që asnjë baba nuk mund ta trajtojë sot fëmijën e tij.

Ky interesim i ngrohtë i tij vazhdoi deri në fund të jetës së tij. Ne e ndjemë atë gjithmonë pranë në ditët tona të lumtura dhe të trishtuara. Vëllai im i madh, Musai kishte një mënyrë tjetër të trajtimit të njerëzve. Pas vdekjes së djalit tim, Jusufit, ne dhe familja ime patëm një periudhë të vështirë. Ai na tha: "Unë do të vij të qëndroj në shtëpinë tuaj." Pas kësaj, u ngrit dhe erdhi në shtëpinë tonë. Në të vërtetë, ndërsa ishim të preokupuar me pritjen e vëllait tim, Musait, ndërsa bisedonim me të dhe ndërsa ndanim ditët tona me të, ai mori pjesën e rëndësishme të barrës, trishtimit dhe shqetësimit tonë. Pasi qëndroi për ca kohë te ne, na dërgoi në Medinetu'l-Munevvere. Ne shkua në Medine dhe u kthyem. U shëruam (lehtësuam) në një masë të madhe, elhamdulillah (falënderimi qoftë për Allahun).



**FAKTI QË NJË PERSON ËSHTË I DASHUR, I RESPEKTUAR DHE I KËRKUAR NGA ZEMRA NË SYTË E TË AFËRMVE TË TIJ MË TË AFËRT, LARG NGA PAMJA ARTIFICIALE, TREGON VIRTYTIN DHE CILËSINË E PERSONALITETIT TË TIJ. SEPSE ËSHTË E VËSHTIRË TA RUASH DASHURINË DHE RESPEKTIN NË MARRËDHËNIET DHE AFRIMITETET AFATGJATA.**

Kur vëllai vdiq, papritur e ndjeva veten si një fëmijë dhe u kaplova nga ndjenja e një fëmije që ka humbur babanë e tij. Unë papritmas shkova nga mosha gjashtëdhjetë vjeç në moshën gjashtë vjeç. Kur vëllai im ishte në jetë, energjia që na jepte na mbante gjallë. Pas vdekjes së tij, unë papritmas u bëra një njeri i zakonshëm. Krejt papritur mbeta vetëm si një fëmijë."<sup>1</sup>

Nipi i tij, Ahmed Topbashi, shpreh të njëjtat ndjenja si më poshtë:

"Nuk e di se kur fillon njeriu të njohë veten? Por më duket se e mbaj mend xhaxhain tim, Musain që kur isha dy vjeç. Babai dhe xhaxhai im ishin partnerë në biznes. Nëna ime dhe familja (bashkëshortja) e xhaxha Musait ishin gjithashtu motra. Domethënë se babai dhe xhaxhai im në të njëjtën kohë ishin edhe baxhanakë. Unë isha moshatar dhe në të njëjtën kohë shok i ngushtë me zoti Ebu Bekirin, djali i vogël i Musa Efendiut. Meqenëse shtëpitë tona ishin shumë pranë njëra-tjetrës, ne i kalonim ditët tona së bashku. Atë kohë, puna e babait tim ishte shumë e ngjeshur. Dilte nga shtëpia në 6.30 të mëngjesit dhe kthehej vonë në shtëpi. Kur xhaxhai im, Musai kujdesej për djalin e tij, zoti Ebu Bekirin, gjithashtu kujdesej edhe për mua. Nisur nga natyra e tij, ne takoheshim më shpesh me xhaxha Musain sesa me babanë. Nëse xhaxhai i blinte biçikletë zoti Ebu Bekirit, gjithashtu ma blinte edhe mua. Nëse e merrte për ta shëtitur, më merrte edhe mua. Me

pak fjalë, mund të them se u rrita në duart e xhaxhait tim, Musait. Zoti Ebu Bekirin dhe mua na dërgoi në xhaminë Saharaji Xhedid për të mësuar Kuranin. Ai kujdesej për vazhdimësinë tonë atje. Pastaj filluam shkollën. Pasi mbaroi shkolla fillore, na regjistroi në medrese. Ai na ndiqte vazhdimisht përgjatë jetës sonë shkollë. Elhamdulillah-lah ai nuk na la vetëm asnjëherë. Gjithmonë na thoshte të shërbenim. Ai na thoshte: "Ejani të shkojmë në Anadoll!", "Përgatiteni shtëpinë për ligjëratë fetare!"...

1. Një intervistë e bërë me zoti Abidin Topbashin, Revista Alltënolluk, numër: 185, fq. 22, korrik 2001.

Xhaxhai im, Musai ishte një person jashtëzakonisht programatik. Ai gjithmonë e planifikonte kohën që do t'i kushtonte punës, fqinjëve, familjes, të afërmeve dhe miqve të tij. Ai nuk neglizhonte asnjërin prej tyre. Të gjithë këtyre u bënte vizita në mënyrë periodike. Kur ishim të sapomartuar, ai vinte të na vizitonte të dielave dhe pinte kafen tonë dhe na bënte të ndiheshim se ishte shumë i interesuar për ne. Ai nuk na linte vetëm. Sigurisht, ky interesim i tij nuk ishte i kufizuar vetëm tek të afërmit e shkallës së parë si ne. Ai gjithashtu kujdesej shumë edhe për fëmijët e tyre. Interesohej për edukimin e të gjithëve, pavarësisht nëse ishin djem apo vajza. Ai kujdesej për të gjithë. Kujdesej edhe për personin më të largët. Ai mund të shihte gjithçka, sikur të kishte shumë sy. Zbulonte se si e kishin gjendjen banorët në lagje dhe u shtrinte dorën e ndihmës atyre që ishin në nevojë. Madje, gjatë një Ramazani kur isha 11-12 vjeç, ai më ngarkoi mua me detyrën për t'u çuar ushqime të iftarit tri zonjave që jetonin në Kazasker. Kështu edhe unë transportova ushqim me biçikletë çdo mbrëmje gjatë këtij Ramazani. Kjo ishte një detyrë që më dha. Me të tjerët përpiquej të plotësonte nevojat e nevojtarëve të tjerë.”<sup>2</sup>

Musa Efendiut interesohej gjithashtu për vajzat, nusët dhe gratë e tjera të familjes. Madje atyre u ndau një ditë të veçantë. Bashkëshortja e djalit të tij, zonja Meleku tregon:

“Marrëdhënia jonë me babanë nuk ishte një marrëdhënie vjehërr-nuse. Ishim pothuajse si babë e bijë. Në fakt, kishte raste kur e ndjeja më afër se babanë tim. Ai kujdesej për gjithçka tonën. Ai nuk i harronte as prindërit tanë kur u dërgonte dhurata të afërmeve të tij gjatë festave dhe netëve të mira. Në fakt, kur ata sëmureshin, ai kujdesej më shumë se ne për ta. Na këshillonte që të mos shfaqnim mangësi në shërbim ndaj nënave tona duke thënë: “Ah sikur të ishte gjallë nëna ime dhe t'i shërbeja.” Ndërmjet nesh u formua një dashuri e tillë sa që mund ta shihte në sytë tanë qoftë edhe shqetësimin më të vogël dhe na bënte për vete. Kur na fliste për gabimet tona, vepronte me një mirësjellje dhe hir të jashtëzakonshëm. Ai kujdesej shumë për fëmijët tanë, madje edhe për nipërit tanë. Gratë e familjes i pranonte në rezidencë çdo të hënë dhe u jepte sugjerime fetare, shpirtërore e morale. Ai donte t'i udhëzonte të gjithë në një kauzë të mirë. Ai ishte një i madh dashamirës dhe

i dashur i familjes për të gjithë ne, si dhe një udhëzues i përsosur që futi në zemrat tona dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.”

Ai shqetësohej për fëmijët e familjes dhe përpiquej të kujdesej për edukimin e tyre personalisht. Madje një ditë ftoi Abdullah Sertin dhe H. Kamil Jëllmazin dhe u tha: “Etërit e këtyre fëmijëve nuk mund të kujdesen për fëmijët e tyre, sepse janë të preokupuar me gjëra të tjera. Të paktën sikur të merreshim ne me këta fëmijë në vend të tyre, a nuk do të ishte më mirë? ” Kështu bëri një program për ta. Këtë program që e bëri e ndoqi me seriozitet. Madje herë pas here merrte pjesë personalisht në bisedat fetare dhe e maste interesin e fëmijëve duke u thënë: “Le të shohim se çfarë ka thënë hoxha juaj sot.”

Në sytë e Musa Efendiut nuk kishte ndonjë ndryshim të madh ndërmjet të vegjëlve dhe të rriturve për sa i përkiste aspektit të interesimit dhe vlerës. Kujtimi i mëposhtëm, i treguar nga një prej të afërmeve të tij, zonja Safije, është ndër shembujt më të mirë për sa i përket tregimit të vlerës që ai u jepte zemrave të reja:

“Vite më parë, dy nga fëmijët tanë morën linë e dhenve. Ishte dimër dhe moti ishte shumë i ftohtë. Shtëpitë nuk kishin kaloriferë. Për shkak të të ftohtit të madh, xhamat kishin zënë akull. Hoxha ynë i nderuar, i cili dëgjoji shqetësimin e fëmijëve, na informoi se do të vinte për vizitë. Edhe pse e falënderuam për interesimin duke i thënë: “Mos u mundoni, i nderuar!”, ngaqë kishim vetëm një dhomë të ngrohtë në shtëpi, ai nuk hoqi dorë nga vendimi i tij. Ditën që do të vinte vendosëm rezistenca elektrike në dhomat e tjera të shtëpisë, por akoma ishte ftohtë. Ai mbërriti në kohën kur pati njoftuar. Kur i thamë: “I nderuar, e morët mundimin për ne, faleminderit!”, ai na tha: “Kemi ardhur të përgatitur”. Ai ishte veshur trashë. U prehtë në paqe/dritë. Kur më kujtohet sesi ai mik i shtrenjtë i Allahut duroi kaq shumë vuajtje për ata dy fëmijët, unë emocionohem shumë dhe derdh lot.”<sup>3</sup>

Ne dëshirojmë të përfshijmë edhe më shumë tablo të tilla marramendëse në lidhje me marrëdhëniet e miqve të Zotit me të afërmit e tyre. Por të përfshijmë më shumë (tablo) në një artikull reviste do të ishte tejkalim i caktuar. Si kanë thënë? Njeriut të urtë i mjafton qoftë edhe një shenjë.

2. Shik. Një intervistë e bërë me zoti Ahmet Topbashin, Revista Alltëno-luk, numër: 209, fq. 10, Korrik 2003.

3. Prej shënimeve të veçanta të zonjës Safije Êzkullit.

# Pejgamberi dhe jeta jonë

— Ali Byjyçapar —

Ndriçimi me dije i errësirës së jetës, duhet të jetë misioni ynë primar. Dihet mirë se sa zgjat jeta jonë si individë, por ne duhet të kuptojmë se si njerëzim kemi me mijëra vjet në këtë botë.

Çfarë është bota?

Ne ekzistojmë në sajë të cilësisë së “jetës” që zotëron Allahu i Madhëruar. U krijuam si njerëz dhe para nesh u vu synimi për ta merituar këtë nder. Për këtë arsye, Islami u caktua si kriter i kësaj. A ka mendjelehtësi më të madhe se sa t’ia atribuosh rastësisë gjithçka që ndodh, ndërkohë që në këtë jetë nuk ka asnjë mundësi të jetohej kot e rastësisht?

Mendja dhe pjekuria janë dy vlera të mëdha, në të cilat njeriu gjen kuptimin e ekzistencës së vet. Prandaj, pikërisht këtu e ka vendosur edhe feja islame fushën e ekzistencës. Dhe duke e përdorur këtë si referencë, i ka dhënë drejtim jetës prej kësaj pike.

Edukimi i mendjes është një fazë, e cila mund të realizohet mbi njerëzit e pjekur. Në këtë aspekt, gjykimi “kush nuk ka mendje, nuk ka fe”, është shumë i rëndësishëm. Jeta sociale që bëjmë dhe ndodhitë në botën që zhvillohet vazhdimisht, shtynë gjithmonë e më shumë që mendja të lihet jashtë funksionit.

Po përse ndodh kështu?

Pikërisht këtu shfaqet edhe një nga të fshehtat e sprovës së kësaj jete. Pranë mendjes duhet të merret edhe dija dhe duke i gatuar të dyja në zjarrin e dashurisë, duhet t’i shndërrojmë në shpirt. Fakti se dijet dhe njohuritë që ndikojnë në jetën tonë dhe na çojnë në thellësi mund t’i përmendim edhe sot, është për shkak se ato na kanë ardhur prej njerëzve të mëdhenj.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet: **“O besimtarë! Binduni Allahut dhe të Dërguarit, kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyt midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mblidheni të gjithë!”** (Enfal, 24)

Këta njerëz, që i quajmë pejgamberë, resulë, të dërguar e nebi, janë njerëzit që Allahu i Madhëruar i ka ngarkuar me detyrën për t’i njoftuar njerëzit me urdhrat, ndalesat dhe këshillat e Tij. Kjo dhuatë është si një shkëndijë në errësirat e zemrave dhe një ujë jetëdhënës që rrjedh drejt thelbit të ekzistencës. Pa pejgamberë, shpirtat janë të shkretë dhe shpresat janë të pakuptimta.

Pejgamberët, tek të cilët janë mbledhur virtetet më të larta, janë si oaze jetëdhënëse.

Nëse shohim me vëmendje ato që kanë thënë pejgamberët, do të përballemi me një fushë dijeje, e cila përfshin gjithë jetën. Kjo derë e urtësisë, së cilës bota moderne ka dyqind vjet që i ka kthyer shpinën, vazhdon t’u falë jetë atyre që trokasin në të.

Ky botëkuptim, që i pajis besimtarët me fushën e besimit, adhurimit, moralit, drejtësisë, ekonomisë dhe estetikës, duke i mbajtur ata të gjallë në çdo aspekt të jetës, na thërret edhe neve pesë herë në ditë.

Të gjitha këto dije vijnë tek ne nëpërmjet Pejgamberit tonë (a.s.). Ai është resuli dhe nebiu i fundit i Allahut, i cili është dërguar për të gjithë njerëzimin. Pejgamberi ynë (a.s.), në të cilin ishin përmbledhur të gjitha virtetet e bukura, ishte përgëzues dhe paralajmërues. Ai posedonte moralin më të bukur.

Përpjekja që po bëhet sot për ta kuptuar Pejgamberin tonë (a.s.), me disa nocione të zbrazëta dhe të ngushtuara, na lëndon jashtë mase. Sa e hidhur është që Pejgamberi ynë (a.s.), të përmendet vetëm për “tolerancën”, ndërkohë që e gjithë jeta e tij ka qenë e përfshirë nga respekti, rregulli e disiplina!

Ne kemi shumë nevojë për fjalët e Pejgamberit tonë (a.s.), i cili ishte fjalëdrejtë, besnik, i pastër nga gjynahet dhe që i kumtoi njerëzimit të gjitha urdhrat dhe ndalesat që mori prej Allahut të Madhëruar.



# ATË E DUAM SHUMË

— Adem Saraç —

Para së gjithash, falënderimet qofshin për Allahun Teala, i cili na ka krijuar si myslimanë...

Salatet dhe selamet qofshin për të Dërguarin e Allahut (a.s.), ngaqë jemi umeti i tij dhe jemi nderuar me të...

Hixhri Rabi'u'l-evvel, muaji Prill i e.s., na përgëzon çdo vit me një pranverë të veçantë...

Rabi'u'l-evvel apo muaji Prill në të cilin ka lindur i Dërguari i Allahut, (a.s.), buzëqesh ndryshe çdo vit. Vjen si një festë e veçantë për çdo vit. Për këtë arsye, çdo Rabi'u'l-evvel apo çdo muaj Prill, e festojmë me emocionin e një feste të madhe.

Për çdo vit që e festojmë ditëlindjen e të Dërguarit të Allahut (a.s.), pothuajse lindim edhe një herë tjetër...

Atëherë, kjo javë e kremtimeve të ditëlindjes së Hz. Pejgamberit, apo i gjithë muaji Rabi'u'l-evvel ose muaji Prill, duhet të na shpjerë në një botë tjetër, duhet të na drejtojë nga mirësitë dhe të na bëjë njerëzit e mirë të botës së bukur. Vetëm mirësia nuk mjafton, andaj duhet të na çojë në një atmosferë mirësish mbi mirësi.

Java të cilën e quajmë “Java e Lindjes së Bekuar” dhe të cilën e kremtojmë me shumë emocione, është java në të cilën i Dërguari i Allahut (a.s.), e ka nderuar këtë botë me lindjen e tij.

Për këtë arsye, edhe ne si myslimanë përjetojmë një emocion të veçantë në çdo javë të tillë dhe pothuajse takohemi me Sulltanin e Pejgamberëve.

I Dërguari i Allahut (a.s.), i cili e nderoi këtë botë në një periudhë kur gjambat e kishin pushtuar çdo anë të saj, krahas gjithë atyre gjembave, e shndërroi mjedisin ku jetoi në një bahçe trëndafilash.

Ai e ndryshoi botën në një bahçe të tillë, saqë gjambat u shndërruan në trëndafila. Njerëzit e këqinj u bënë të mirë, ndërsa njerëzit e mirë u bënë edhe më të mirë. Ata kaluan nga grindjet në paqe dhe nga zemërimi në dashuri. Sepse tashmë kishte lindur dielli...

Me përpjekjet e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe sahabëve të nderuar, të cilët ishin shokët e tij, ajo periudhë u shndërrua në Epokën e Lumturisë...

Vallë, a ka lindur edhe për ne ajo dritë? A ka çelur dhe buzëqeshur për ne ai trëndafil? Çfarë ka ngelur te ne prej asaj drite vezulluese dhe atij trëndafili të mrekullueshëm?

A nuk ishte ai peygamberi i dashurisë? Sa ka nge-  
lur te ne prej dashurisë së tij? A i do Peygamberi i  
buzëqeshjes ata që i varin fytyrat? Ai nuk i do as  
ata që përçmojnë të tjerët, apo jo? Andaj nuk duhet  
të përçmojmë, nënvlerësojmë dhe shpërfillim asnjë,  
në mënyrë që edhe ai të na dojë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), duhet të reflektojë në  
moralin, sjelljet, gjendjet dhe veprat tona. Ai duhet  
të lindë si një diell në jetën tonë...

Te të gjithë ne, qoftë në mënyrë shoqërore apo  
qoftë në mënyrë individuale, duhet të ketë një formë  
sjelljeje të marrë nga ai. Ata që na shohin, duhet të  
gjejnë te ne gjurmë nga ai...

Të gjithë e dimë se ai ishte i pastër dhe i dëlirë në  
të gjitha aspektet. Prandaj edhe ne duhet të jemi të  
pastër. Ai ishte një monument morali, andaj edhe  
ne duhet të bëhemi të moralshëm. Për shkak se ai  
ishte i ndershëm dhe i besueshëm, të gjithë i tho-  
shin "Emin", që do të thotë "i besueshmi". Edhe  
ne duhet të bëhemi të besueshëm.

Ai ishte shumë punëtor, i rregullt dhe i disiplinuar...  
Edhe ne duhet të bëhemi punëtorë, të rregullt  
dhe të disiplinuar.

Vallë, a mund të themi se ai është jeta dhe çdo  
gjë e jona? A nuk duhet ta reflektojmë atë në çdo  
gjë tonën, në mënyrë që të arrijmë të themi kështu?  
Sa e reflektojmë atë në çdo gjë që kemi?

Sjelljet dhe veprat e bukura të atij ishin univer-  
sale, sepse, morali, mirësia, puna dhe ndershmëria  
nuk kanë një shekull, vit apo kohë të caktuar. Këto  
janë virtyte të përhershme dhe të vlefshme për-  
gjithmonë.

Atëherë, ejani të bëhemi edhe ne si ai! Le të punoj-  
më shumë! Le të lexojmë shumë! Le të bëjmë shumë  
mirësi! Le të bëhemi shumë të ndershëm!..

Le t'i respektojmë dhe t'u bindemi të mëdhenjve  
tanë, me në krye nënën dhe babain dhe t'i pranoj-  
më këshillat e tyre! Le t'i duam të vegjlit dhe t'i  
ndihmojmë ata, duke filluar që nga vëllezërit dhe  
motrat tona!

Le të lexojmë shumë libra, duke filluar me Kuranin  
Fisnik dhe Hadithet Fisnike!

Le t'i kryejmë në kohë dhe sa më bukur ibadetet,  
duke filluar nga falja e namazit!

Le ta duam më shumë se jetën tonë të Dërguarin e  
Allahut, (a.s.), i cili na do shumë dhe është shumë  
i dhënë pas nesh, sepse ai ka një pozitë dhe vlerë  
shumë të madhe tek Allahu Teala. Ai është robi dhe  
Peygamberi më i dashur i Allahut... Ai është robi  
shumë i veçantë i Allahut të Madhëruar...

Allahu Teala ka shfaqur interesim shumë të večan-  
të ndaj robit të Tij shumë të veçantë. Gjithashtu, ka  
kërkuar që edhe ne të shfaqim interesim shumë të  
veçantë ndaj atij. I Dërguari i Allahut, (a.s.), duhet  
të jetë shumë i veçantë edhe për ne...

A mund të mendojmë se çfarë do të thotë që  
Allahu dhe i Dërguari i Tij na duan shumë ne?

Për ta merituar këtë dashuri më të lartë, tash-  
më duhet të përpiqemi t'i bëjmë me një dashuri të  
madhe punët që i duan dhe prej të cilave janë të  
kënaqur Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe të qëndrojmë  
larg punëve që nuk i duan dhe nuk u pëlqejnë  
Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte një njeri me moral  
të lartë dhe shembullor në çdo çështje. Tashmë edhe  
ne, ngaqë e duam shumë atë, duhet të përpiqemi për  
ta marrë shembull në çdo gjë që duhet të bëjmë.

Në çdo kohë dhe në çdo vend do të bëhemi mys-  
limanë të moralshëm, të ndershëm, punëtorë, të  
drejtë, të sjellshëm, njerëz që i respektojnë të më-  
dhenjtë, njerëz që i duan e i ndihmojnë të vegjlit  
dhe njerëz shembullorë plot dashuri, inshallah.

Ne duhet të qëndrojmë larg çdo fjale, mendimi,  
sjelljeje dhe vepre të keqe. Gjithmonë duhet të për-  
piqemi për mirësi dhe t'ia hapim derën çdo lloj  
begatie.

Ai që e do shumë të Dërguarin e Allahut (a.s.),  
vazhdimisht bën ato që do dhe që ka këshilluar ai.  
Mbi të gjitha, ndjehet shumë i lumtur kur i bën. Në  
këtë mënyrë, fiton një personalitet plot dashuri.

Ai që e do të Dërguarin e Allahut (a.s.), nuk për-  
piqet vetëm për veten e tij, por bën ç'të mundet për  
të gjithë njerëzit. Më e pakta, është i vetëdijshëm  
dhe i përgjegjshëm për këtë.

Allahu i Madhëruar na përgëzon se Peygamberi  
na do shumë ne dhe është shumë i dhënë pas nesh.  
Gjithashtu na përgëzon se i Dërguari i Allahut (a.s.),  
na do shumë dhe se dëshiron të jetë bashkë me ne  
në xhenet...

A ka ndonjë përgëzim më të madh se ky për një  
mysliman?

Ne kemi një Peygamber që na do shumë dhe që  
dëshiron të jetë bashkë me ne edhe në xhenet.  
Atëherë, edhe ne duhet ta duam shumë atë dhe  
t'i bëjmë me një dashuri të madhe ato që na ka  
urdhëruar për t'i bërë.

Sepse ne e duam shumë atë...

Salallahu alejhi ve selem...



# TË JESH MIRËNJOHËS NDAJ MIRËSIVE

— B. Xahit Ēzdemir —

Që nga koha e Ademit, (a.s.), shpirti i Kabilit, i cili përfaqëson injorancën, ka ekzistuar gjithmonë dhe është shfaqur në grada të caktuara sipas kushteve. Civilizimi i famshëm i cili u përhap me ndihmën e fesë islame, e cila iu zbrit Hatemu'l-Enbija, (a.s.), i shqeu errësitat e injorancës në formën me influencuese dhe e shpiu këtë botë për shekuj me radhë te oqeani i drejtësisë dhe paqes.

Në shekujt e fundit, shpirti i Kabilit ka rifituar fuqi. Si rezultat i kësaj, shtetet kolonizuese e ndaluan perandorinë osmane, të cilën e shikonin si pengesë përpara ambicieve egoiste të tyre që nuk perceptohen dot nga asnjë logjikë, dhe pasi e detyruan të tërhiqej nga skena e historisë, u bënë sunduesit e ecurisë së kësaj bote. Kjo periudhë, në të cilën po vihen në praktikë planet më të pandërgjegjshme për hir të orekseve që s' dinë të ngopen, emërtohet si "injanca moderne" nga dijetari egjiptian Muhamed Kutub. Në këtë periudhë, e cila mund të cilësohet si "brutalitet i përgjithshëm", me mundësitë që ka sjellë edhe teknologjia, bota njerëzore bashkë me pasuritë e saj natyrore po pëson shkatërrimin më të madh.

Të urtët thonë: "Njeriu ha për të jetuar, nuk jeton për të ngrënë." Por njeriu "modern" i kohës sonë që e ka harruar ahiretin, bën çdo gjë me ambicien për ta ngopur neftin e tij si njerëzit e shthurur të Romës së vjetër. Shpërndarja e të ardhurave në botë është aq e çekuilibruar, sa që në vendet e prapambetura me miliona njerëz vdesin nga uria. Ndërsa të pasurit, ndërkohë që i shfrytëzojnë këta të varfrit duke i kolonizuar, po vdesin prej sëmundjeve që sjell

mbingopja. Në ajetin fisnik thuhet: "**Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë "të shijojnë" pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen** (në përmirësim)." (Rum, 41) Ekuilibri natyror është shkatërruar duke i shfrytëzuar në mënyrë barbare pasuritë natyrore, të cilat i kemi amanet, thjesht për të fituar sa më shumë. Shumë specie bimësh dhe kafshësh janë zhdukur. Për shkak se njeriu, i cili është krijesa më e bukur, e ka kthyer në gërmadhë këtë botë, e cila është më e bukura në gjithësi, njerëzia sot po ndeshet me tragjeditë natyrore. Në një hadith fisnik që ka lidhje me neftin e njeriut, e cila nuk di se çfarë është të mjaftuarit me atë që posedon, thuhet:

*"Sikur njeriu të kishte një luginë plot me florinj, do të dëshironte të kishte dy luginë plot me florinj. Sikur të kishte dy luginë plot me florinj, patjetër do të dëshironte të kishte edhe një luginë të tretë plot me florinj. Dëshirat e njeriut nuk kanë të mbaruar. Syrinx e tij e ngop vetëm dheu."* (Buhari, Muslim.)

Aliu (r.a.), ka thënë:

"Të varfrit ngelin të uritur aq sa të pasurit e shpërdorojnë pasurinë e tyre." Ndërkohë që ka shumë njerëz që përpëliten për shkak të skamllëkut, shpërdorimi i pasurisë nga njeriu dhe të qenët koprrac duke menduar vetëm për vete, është prej sjelljeve më të këqija që nuk përputhen me ndershmërinë e tij. Në Kuranin Fisnik thuhet:

*"O ju që keni besuar! Jepni nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita (e Gjykimit) në të cilën nuk ka shit-blerje, as miqësi, as ndër-*

***mjetësi! Jobsimtarët janë keqbërësit e vërtetë.***

(Bakara, 254) Përdorimi i mirësive, të cilat Allahu, xhelle xhelaluhu, ia ka dhuruar njeriut, me vetëdijen e të dhënit për hir të Allahut dhe altruizmit dhe në përputhje me pëlqimin e Atij, është lumturia më e madhe. Kjo është prej veprave që njeriut do t'i japë përgëzime në ahiret. Në lidhje me këtë çështje shënohet kështu një sjellje e shkëlqyer e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili është "shembulli më i mirë" nga çdo aspekt për të gjithë:

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e pyeti Aishen, radijallahu anha: "Çfarë ke bërë me delen që u ther në shtëpi?" Ajo iu përgjigj: "E kam ndarë të tërën përveç një kocke shpatulle." Pasi Hz. Pejgamberi mori një përgjigje të tillë, e shprehu kështu gëzimin e tij:

*"E gjitha qenka bërë e jona, përveç një kocke shpatulle."*

Edhe robërit e devotshëm, të cilët janë miq të Allahut Teala, janë përpjekur ta mbartin këtë ndjeshmëri profetike.

Njëra prej shenjave të disa sëmundjeve psikologjike është harxhimi i parave në mënyrë të pandërgjegjshme dhe në vende jo të duhura. Në kohën tonë, shumë prej njerëzve që nuk e kanë këtë ndjeshmëri sociale, janë shndërruar në maniakë që bëjnë shpenzime të pallogaritshme. Ndërkohë që shoqëria nuk i zgjat këmbët aq sa ka jorganin dhe po zhytet në batakun e borxhit, është mbushur plot me shembuj negativë duke mos toleruar nga pasionet e pamatura si ndryshimi i mobilieve të shtëpisë brenda disa viteve, zgjedhja e mobilieve më të shtrenjta me ambicien për të blerë gjëra prej markave të famshme, të ngrënët, të pirët dhe argëtimi i pakufishëm, etj... Faktor tjetër i rëndësishëm në lidhje me këtë çështje është shfrytëzimi i njerëzve në emër të "modës" për hir të fitimit të disa firmave të caktuara që e nxisin konsumin. Këtë mashtrim të tmerrshëm e shprehin me këtë gazmore:

"Moda është kaq e shëmtuar saqë ndryshohet një herë në gjashtë muaj ngaqë nuk pëlqehet edhe nga vetë stilistët e modës."

Imam Azami, Ebu Hanife (r.a.), thotë:

"Për ta kuptuar se nga ka ardhur një pasuri, duhet të shikojmë se ku shpenzohet." Kjo çështje është ana tjetër, nga aspekti i paqes shoqërore, e gjendjes së frikshme të cilën po e shtjellojmë dhe e cila shkakton disa tragjedi dhe fatkeqësi familjare.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë për atë që do të vuaj në ahiret, ndërkohë që u ka lënë pasardhësve të tij pasuri të madhe, por të fituar me haram:

*"Turp, turp për atë njeri që u lë familjarëve të tij pasuri, ndërkohë që vetë do të dalë në audiencën e Zotit (xh.sh.), me të keqen (barrën e llogarisë së pasurisë që ka fituar)." (Sujuti, Xhamiu's-Sagir, nr: 9693.)*

Allahu Teala i ka dhuruar njeriut, të cilin e ka bërë mëkëmbës të Tij në sipërfaqen e tokës, mirësi të pallogaritshme në përputhje me këtë fisnikëri që i ka falur, por sa ia di vlerën njeriu kësaj fisnikërie? Në Kuranin Fisnik thuhet:

***"Allahu e ka bërë natën që ju të pushoni, ndërsa ditën e ka bërë të ndritshme për të parë. Vërtet, Allahu është Dhurues i madh ndaj njerëzve, por shumica e tyre nuk janë mirënjohës."*** (Gafir, 61) Ndërkohë që shumë njerëz janë të privuar nga mirësia për ta falënderuar Allahun Teala për mirësitë që u ka dhënë, vlen të theksojmë edhe çështjen e mënyrave të respektimit të edukatës së falënderimit të atyre që e kryejnë këtë obligim. Njerëzit e devotshëm thonë:

"Njeriu duhet ta falënderojë Allahun e Lartësuar dy herë për çdo frymëmarrje. Një herë kur të marrë frymë dhe një herë tjetër kur ta japë atë."

Gjërat që sot hidhen në koshat e mbeturinave kanë përmasa aq të mëdha saqë nëse do të përdoreshin për bamirësi mund ta parandalonin problemin e mungesës së ushqimit në vendet e varfra. Pra, koshat e mbeturina janë të mbushur plot e përplot me mirësi të shpërdoruara. Tashmë kanë filluar të pakësohen ndjeshëm njerëzit që nuk e shkelin bukën që e shohin në tokë, por që e marrin me respekt dhe e vendosin në një vend. Kështu që po shtohen njerëzit që nuk e njohin mungesën e ushqimit dhe që e konsiderojnë si modë lënien e disa kafshatave ushqim në pjatë dhe lënien e një gishti pijeje në gotën e tyre.

Në hadithin fisnik thuhet:

*"Ditën e Kiametit, njeriu nuk do të largohet dot nga audienca e Zotit pa dhënë llogari se "si i ka përdorur mirësitë që i ishin dhënë amanet..." (Tirmidhi, Sifatu'l-Kijame, 1.)*

Ndërkohë që mund të lartësohemi në gradën e një robi të devotshëm me virtytin e falënderimit të Zotit (xh.sh.), për mirësitë që na ka dhënë, rruga që duhet të ndjekim për të mos u bërë fatkeq në të dy botëve me humbjen e mosmirënjohjes ndaj mirësive, është marrja për shembull e jetës së bekuar të Krenarisë së Gjithësisë, të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili përshkruhet si një "Kuran i gjallë" dhe "Shembulli më i shkëlqyer dhe Mëshirë për Botët".



# MESAZHI I KURANIT

— Abdullah Draz —

Kurani, për vetë rëndësinë e madhe që ka, duke qenë jo vetëm libër hyjnor, por edhe gur themeli mbi të cilin është ndërtuar qytetërimi, kultura dhe shoqëria islame, është bërë objekt studimi për shumë shkencëtarë, myslimanë dhe jomyslimanë. Shumë orientalistë janë përpjekur të hedhin dyshime mbi autorësinë e Tij hyjnore, duke ia mveshur atë Muhamedit (a.s.). Mbi mrekullitë shkencore të Kuranit, që vërtetojnë burimin e Tij hyjnor, janë shkruar shumë libra. Por ne këtu do të përqipemi të trajtojmë karakterin hyjnor dhe pamundësinë e Muhamedit (a.s.), për të qenë autor i Kuranit në një këndvështrim ndryshe.

Për myslimanët, Kurani është fjalë e Allahut, si nga përmbajtja edhe nga forma. Ai nuk mund të jetë kurrë një vepër njerëzore. Kurani është një kryevepër letrare dhe estetike. Për nga kë-

shillat, parimet morale, juridike dhe shoqërore që përmban, është një vepër madhështore. Ai po ashtu është një thesar dhe burim i pashtershëm. Për nga informacionet metafizike që jep, është një mrekulli më vete. Një mendimtari ose shkrimtari i mjafton të ketë autorësinë e vetëm një pjese të vogël të këtij libri, për t'u bërë i pavdekshëm në historinë e njerëzimit. Megjithatë, Pejgamberi (a.s.), nuk pretendon autorësinë e këtij libri, të cilin do ta dëshironte çdo shkrimtar. Ai jo vetëm që nuk e pretendon, por me zë të lartë predikon autorësinë e Tij hyjnore. Përballë refuzimit të autorësisë së këtij thesari, kur të tjerët do të sakrifikonin gjithçka për ta pasur, nuk mbetet gjë tjetër përveçse të pranohet siç është. Është për t'u habitur nga disa që kërkojnë argumente për të pranuar autorësinë hyjnore të këtij libri.



Një mendje djallëzore mund të thotë: Muhamedi (a.s.), ia ka atribuar autorësinë, Allahut për të fituar prestigj dhe autoritet. Por përsa i përket lidhjes dhe besimit të fortë të tij tek Allahu, e gjithë jeta e Tij është dëshmi për këtë. Po ashtu, të gjithë janë të një zëri, qofshin miq apo armiq të tij, përsa i përket besnikërisë dhe sinqeritetit të tij. Një njeri që thotë vetëm të vërtetën për njerëzit, nuk mund të mendohet se do të gënjejë për Allahun. Historia e Muhamedit (a.s.), na jep një profil të qartë të sinqeritetit dhe besnikërisë së tij. Në një rast kur një grup vajzash të vogla po thurinin vargje lëvduese për dëshmorët e luftës së Bedrit, një vajzë ndër të tjera thuri një varg të tillë: “Në mesin tonë ndodhet një Pejgamber që di të ardhmen.” Pejgamberi (a.s.), sapo e dëgjoi, ndërhyri duke e korrigjuar dhe e ndaloi të thoshte një gjë të tillë. Kurse në një rast tjetër, kur vdiq Osman ibn Maz, një grua tha: “Unë jam dëshmitare që Allahu të ka shpërblyer dhe vendosur në një pozitë të lartë.” Pejgamberi (a.s.), i tha: “Ku e di ti se Allahu e ka shpërblyer atë, unë jam i dërguari i Allahut dhe nuk e di përfundimin tim...” Kjo sjellje e tij është paralel me ajetin Kuranor: **Thuaju: “Unë nuk jam i pari i dërguar dhe nuk e di çfarë do të ndodhë me mua ose me ju. Unë ndjek vetëm atë që më është shpallur dhe kam për detyrë vetëm të jap paralajmërime të qarta.”** (Ahkaf, 9) Të mendojmë për një moment se Pejgamberi (a.s.), nuk gënjente, sepse kishte frikë se mbas një kohe mund t’i dilte gënjeshtra në shesh. Atëherë, çfarë e pengonte të gënjepte për çështje metafizike, ku mundësia për t’u zbuluar gënjeshtra nuk ekziston, përveç frikës nga Gjykatësi Suprem.

Vetë Muhamedi (a.s.), ka konfirmuar se fjalët e Tij për nga vlera juridike janë të barasvlefshme me dispozitat kuranore. Prandaj, për të përcaktuar ndalesën apo lejimin e diçkaje nuk është kusht konfirmimi kuranor. Mjafton gjykimi i hadithit për të përcaktuar dispozitën juridike të saj dhe vlefshmëria e kësaj dispozite është e njëjtë me një dispozitë të përcaktuar qartë nga Kurani. Megjithatë, Ai bënte një ndarje të qartë midis hadithit dhe Kuranit. Madje, për një kohë relativisht të gjatë, nga frika e përzierjes me njëri-tjetrin, e pati ndaluar shkri-

min e haditheve. Nga ana tjetër, një njeri që ka sadopak shije letrare e kupton shumë lehtë dallimin midis stilit kuranor dhe hadithit sepse kanë stile qartësisht të dallueshme midis tyre. Një kritik letrar, duke lexuar hadithet dhe jetën e Pejgamberit, mund të nxjerrë një profil të qartë në lidhje me mendimet, idetë, ndjenjat dhe botën shpirtërore të tij, gjë që nuk ndodh me Kuranin.

Autori i Kuranit nuk mund të gjendet as midis politeistëve, të krishterëve apo hebrejve. Sepse Kurani, megjithëse përfshin histori dhe ngjarje nga Bibla dhe Teurati, ai flet për detaje që nuk gjenden në to dhe vherë-herë bën korrigjimet e duhura. Një nxënës, që mëson dy gjëra nga një mësues, nuk mund të marrë guximin të sfidojë mësuesin. Është e pamundur për një person analfabet të japë informacione të tilla të detajuara historike. Detajet historike hasen edhe në numra, si në ajetin:

**“Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind vjet (diellorë), duke shtuar nëntë (për vitet hënore).”** (Kehf, 25.)

Nuk thotë 309 vjet, por treqind plus nëntë për të shprehur ndryshimin midis kalendarit diellor dhe hënor. Kjo është një matematikë shumë e hollë për një analfabet. Nëse të dhënat historike do të ishin produkte të intelektit të tij, patjetër që me kalimin e kohës do të përballej me gabime. Mendjes së shëndoshë i ka hije të pranojë revelatën hyjnore të Kuranit.

Kurani flet për fitoren dhe triumfin e myslimanëve qysh në periudhën e Mekës. Si mund të marrë guximin një njeri të pretendojë një gjë të tillë në ato kushte që ishin myslimanët, ku ishte në dyshim ekzistenca, jo më të bëhej fjalë për fitore dhe sundim mbi tokë. Si mundet një njeri të jetë kaq i sigurt për fitoren përveçse me ndihmën e një informacioni qiellor? Kush do ta siguronte atë pas vdekjes se feja e tij nuk do të zhdukej?

**“Në të vërtetë, jobsimtarët e shpenzojnë pasurinë e tyre për t’i penguar njerëzit nga rruga e Allahut. Ata do ta shpenzojnë atë, por në fund ajo do jetë vetëm dëshpërim për ta, sepse do të jenë të mundur.”** (Enfal, 36.)

**“Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfim dhe fenë e së Vërtetës,**

*për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët.”* (Saff, 9.)

Përveç disfatës së mushrikëve, Allahu flet edhe për përplasjet e myslimanëve me hebrejtë. *“Kudo që gjenden, ata janë të kapluar nga poshtërimi, vetëm nëse kanë ndonjë mbrojtje prej Allahut apo prej njerëzve. Ata merituan zemërimin e Allahut dhe do t’i kaplojë mjehrimin.”* (Al ‘Imran, 111.)

Historia është dëshmitare e poshtërimit të hebrejve dhe pamundësisë për të jetuar dhe siguruar ekzistencën e një shteti normal vetëm kur kanë qenë nën mbrojtjen e myslimanëve dhe kur janë mbështetur nga ndonjë fuqi tjetër botërore. Vetëm në këtë mënyrë kanë arritur ta sigurojnë ekzistencën e vet. Si mundet një njeri të japë informata kaq të përpikta dhe të

roje me turne për t’u ruajtur nga sulmet, Kurani i lajmëronte për sundim planetar. *“Allahu u ka premtuar atyre që besuan prej jush dhe bëjnë vepra të mira se do t’i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu siç kanë bërë ata para tyre dhe do t’ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe frikën do t’ua shndërrojë në siguri.”* (Nur, 55.)

Përmes këtij ajeti, Allahu u premtonte besimtarëve brenda një kohe të shkurtër sundim botëror. Ky sundim nuk u premtohet vetëm besimtarëve të pranishëm në atë kohë, por të gjithë besimtarëve që do të bëjnë vepra të mira.

Një tjetër anë që tregon burimin hyjnor të Kuranit është mungesa e diturisë dhe informacionit të Pejgamberit (a.s.), në lidhje me

THUAJU: “UNË NUK JAM I PARI I DËRGUAR DHE NUK E DI ÇFARË DO TË NDODHË ME MUA OSE ME JU. UNË NDJEK VETËM ATË QË MË ËSHTË SHPALLUR DHE KAM PËR DETYRË VETËM TË JAP PARALAJMËRIME TË QARTA.” (AHKAF, 9)



sakta për të ardhmen dhe të kaluarën. Vetëm Krijuesi i gjithësisë mund të japë një verdikt kaq të prerë për një popull të tërë.

Ku e gjente sigurinë se nuk do të vdiste pa e përmbushur misionin? Kjo është një siguri që nuk mund ta pretendojnë as njerëzit më të fuqishëm të botës, sepse vdekja mund t’i vijë në çdo moment njeriut. Një siguri të tillë mund ta japë vetëm Ai që jep dhe merr jetën. *“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë.”* (Maide, 67.)

Kur besimtarët emigruan në Medine, menduan se gjetën qetësinë, mirëpo atje u përballën me luftë, armiqësi dhe rrezik për shfarosje. Në një gjendje të tillë frike dhe pasigurie, ku myslimanët flinin me armë te koka dhe bënin

disa detaje, përfundime dhe kuptimin e ajeteve. Nëse Kurani do të ishte vepër e Tij, është e pashpjegueshme thurja e vargjeve pa u ditur kuptimin. Për më tepër, kur kjo gjendje i trondiste atij autoritetin dhe shpesh e vendoste në një pozitë shumë qesharake. Një person nuk mund t’i urdhërojë as vetes e as të tjerëve urdhëresa që nuk ua di kuptimin dhe urtësinë. Kjo tregon që Ai ishte thjesht një transmetues i mesazhit.

Në vitin e gjashtë të hixhretit Pejgamberi (a.s.), së bashku me 1500 sahabë niset nga Medina për në Mekë, për të vizituar vendin e shenjtë, Qaben, sepse kishin vite që nuk e vizitonin dot për shkak të idhujtarëve kurejshë. Nga ana tjetër, myslimanët ishin fuqizuar shumë gjatë kësaj kohe, kurse kurejshët ishin dobësuar nga ana ekonomike dhe ushtarake. Nëse do të donte Pejgamberi (a.s.), mund ta



merrte me forcë Mekën që atëherë, por nuk e bëri një gjë të tillë, sepse qëllimi ishte vetëm vizita. Kur arriti në vendin e quajtur Hudejbije, deveja e tij ndaloi së ecuri. Me gjithë përpjekjet, nuk e bënë dot të ecte. Përballë kësaj, Pejgamberi (a.s.), tha: *“E ndaloi Ai, i Cili ndaloi edhe elefantin”*. Kjo nënkuptonte që Allahu, ashtu si nuk lejoi Ebrehenë të pushtonte Qaben me luftë, nuk do të lejonte as myslimanët të merrnin Mekën me luftë. Pejgamberi (a.s.), pa e kuptuar urtësinë iu bind shenjës hyjnore dhe fushoi në Hudjebije, duke e ndaluar kështu përparimin drejt Mekës. Kërkesës së myslimanëve për të vizituar Qaben kurejshët iu përgjigjën negativisht, megjithëse myslimanët ishin të veshur me ihram dhe kishin marrë me vete kafshët për kurban. Pra ishin përgatitur me gjithë zemër për të vizituar Qaben. Megjithëse nuk kishte forcë që mund t’i ndalonte të hynin në Mekë, kurejshët vendosën kushte shumë të rënda për myslimanët. Pejgamberi (a.s.), e pranoi marrëveshjen me gjithë kushtet e rënda që përmbante. Ngaqë nuk mundën të vizitonin Qaben, Pejgamberi (a.s.), i urdhëroi të dilnin nga Ihrami dhe të bënin kurbanet aty ku ishin. Me gjithë bindjen absolute ndaj Pejgamberit, sahabët hezituan në zbatimin e urdhrit të Tij. Omeri (r.a.), si përfaqësues i grupit të pakënaqur me kushtet e marrëveshjes, i thotë Pejgamberit (a.s.): “Përse po e nënçojmë kështu fenë tonë?” Pejgamberi (a.s.), megjithë rrezikun për t’u përballur me kundërshtimin e të gjithë sahabëve, i përgjigjet: *“Unë jam i Dërguari i Allahut dhe nuk mund t’i dal kundër Atij, Ai është ndihmësi im.”* Me këtë donte të thoshte se edhe ai ishte një njeri si ata dhe marrja e këtij vendimi nuk ishte në kompe-

tencën e Tij. Si përfundim, Pejgamberi (a.s.), së bashku me sahabët u kthyen mbrapsht pa e kuptuar urtësinë e kësaj marrëveshjeje, në pamje të parë krejtësisht në disfavor të myslimanëve. Urtësia e kësaj marrëveshjeje mbeti enigmë, deri sa Allahu e zbuloi në suren Fet’h. Kur u realizuan shtatë ditët e Kuranit, e kuptuan që marrëveshja, në dukje kundër tyre, kishte qenë një fitore e madhe për ta. Çfarë vlere kanë masat që merr njeriu përballë masave që merr kaderi?! Dijetari i famshëm Zuhri bën një evidentim shumë interesant në lidhje me marrëveshjen e Hudejbijes: *“Asnjë fitore përpara Hudejbijes nuk ka qenë më e madhe se ajo, sepse më parë, sapo myslimanët përballëshin me idhujtarët, fillonte grindja dhe luftimi. Por me nënshkrimin e marrëveshjes, gjendja u qetësua, gjakrat u ulën, kjo solli reflektimin e palës kundërshtare dhe gjatë kësaj kohe u kthyen në myslimanë, armiq të përjetuar të Islamit, si: Halid ibn Velidi, Amr ibn Asi e shumë figura të tjera të shquara të kurejshëve. Numri i njerëzve që pranuan Islam gjatë kësaj periudhe, e kaloi numrin e myslimanëve të konvertuar gjatë 19 të viteve të kaluara.”*

Një nga kushtet e marrëveshjes ishte që myslimanët të vizitonin Qaben vitin tjetër dhe përveç shpatës që mbahet vazhdimisht me vete të mos merrnin asnjë armë tjetër. Si mund t’u besonin myslimanët kurejshëve, kur ata ishin të gatshëm të bënin gjithçka për të vlarë Pejgamberin (a.s.)? Si mund të ishin të sigurt se ata nuk dëshironin shfarosjen e të gjithëve? Mirëpo Allahu u siguroi atyre kryerjen e ritit dhe kthimin e sigurt. ***“Allahu e vërtetoi saktësinë e ëndrrës së të Dërguarit të Tij, Me siguri,***

*ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë Allahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike. Ai e dinte atë që nuk e dinit ju dhe, veç kësaj, ju dhuroi një fitore të afërt.”* (Fet’h, 27.)

Shpallja shpesh vinte në kundërshtim me mendimin e Tij për një çështje të caktuar, madje në disa raste kishte ngjyra të forta kritike.

*“Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin këta edhe të afërmit e tyre, pasi u është bërë e qartë se ata janë banorë të Xhehenemit.”* (Teube, 113)

*Sa për atë që është i pasur, ti atij po i kush-ton vëmendje, megjithëse nuk ke përgjegjësi, nëse ai nuk dëshiron të pastrohet. Sa për atë që të vjen duke nxituar dhe ndjen frikë (nga Allahu), ti atij nuk po ia vë veshin. Mos veopro ashtu! Në të vërtetë, ky (Kuran) është këshillë, pra, kush të dojë, le të marrë këshillë!* (Abese, 5-12.)

*“Asnjë profet s’ka të drejtë të ketë rob për vete, derisa të arrijë fitore të plotë në Tokë. Ju dëshironi të mirat kalimtare të kësaj bote, kurse Allahu dëshiron botën tjetër. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë. Sikur të mos ishin urdhërimet e mëparshme të Allahut (për lejimin e plaçkës së luftës), do t’ju godiste një dënim i madh për atë që keni marrë.”* (Enfal, 67-68.)

Nëse Muhamedi (a.s.), do të ishte autor i Kuranit, vënia në dukje e gabimeve të veta do ishte jashtë arsyes, i parrokshëm për mendjen e njeriut.

Megjithëse profetët janë njerëzit më inteligjentë dhe të urtë në botë, ata përsëri kanë rënë në gabime. Për ilustrim po japim rastin e Jakubit (a.s.), kur i akuzoi fëmijët për sjelljen e dëshmisë së rreme në lidhje me gjakun, duke u thënë: *“Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka.”* (Jusuf, 18.) dhe në lidhje me vjedhjen në sarajet e Faraonit, kur i thanë se në trastën e Benjaminit u gjet një send i vjedhur. Ai edhe në rastin e dytë tha të njëjtën gjë: *“Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka.”* (Jusuf, 83.) Jakubi (a.s.), në rastin e parë qëllloi, kurse në

të dytin gaboi, sepse ata thanë të vërtetën.

Vetë Pejgamberi (a.s.), ka mbrojtur fajtorin duke e gjykuar si të pafajshëm, deri sa i ka ardhur zbulesa hyjnore. *“Vërtet, Ne (o Muham-med) ta kemi zbritur Kuranin me të drejtën, në mënyrë që ti të gjykosh ndërmjet njerëzve sipas asaj që të ka shpallur Allahu. Dhe mos u bëj mbrojtës i tradhtarëve!”* (Nisa, 105.)

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti ishte gjykimi i gabuar që dha Pejgamberi (a.s.), në lidhje me një vjedhje. Myslimani Tuame ibn Ubejrik i kishte vjedhur parzmoren fqinjët të tij Katade ibn Numanit. Kur Numanit filloi kërkimet për gjetjen e parzmoreve, Ibn Ubejriku nga frika e zbulimit e fshehu parzmoren në oborrin e një hebreu. Kur Numanit e gjeti parzmoren në shtëpinë e hebreut, çështjen ia çoi Pejgamberit (a.s.), për gjykim. Kur Pejgamberi (a.s.), e mori në gjykim çështjen, hebreu pohoi se parzmoren e kishte lënë ibn Ubejriku tek ai. Ibn Ubejriku së bashku me një grup burrash nga fisi i tij e mohuan fjalën e hebreut dhe të gjithë dëshmuuan se vjedhjen e kishte kryer hebreu. Kur Pejgamberi (a.s.), duke u nisur nga provat dhe dëshmitë po mendonte të jepte gjykim kundër hebreut, zbriti ajeti i mësipërm, i cili e shpallte të pafajshëm hebreun, në këtë mënyrë Allahu zbardhi të vërtetën duke dhënë një gjykim të kundërt me të Pejgamberit (a.s.).

Si mundet një njeri të nxjerrë me anë të mendjes dhe logjikës përfundime të vërteta në lidhje me të ardhmen dhe të shkuarën, kur nuk mund të gjejë të vërtetën midis dy njerëzve në konflikt. Arsyeja dhe intelijenca humbasin vlerën për sa i përket identifikimit të ngjarjeve që kanë lidhje me të ardhmen dhe botën metafizike. Një njeri që gjykon në këtë sistem, njëherë qëllon dhe shumë herë të tjera gabon. Nëse do të ishte kështu, ajeti Kuranor: *“A nuk përsiatin ata mbi Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”* (Nisa, 82.) do të ishte një sfidë e pakalueshme.



## PARALAJMËRIME PËR NJË MËSIM TË SAKTË TË KURANIT TË BËHESH KURAN I GJALLË

— Dr. Kerim Bulladë —

Edukimi i fëmijëve e i të rinjve dhe përgatitja e tyre për jetën, është ideali më i rëndësishëm i çdo populli. Fëmijët dhe të rinjtë janë faktorët më kryesorë të së ardhmes dhe të pavarësisë. Ata janë burimi më i rëndësishëm i fuqisë së një familjeje, shoqërie dhe shteti. Për këtë arsye, popujt që e edukojnë rininë e tyre me kualitet duke marrë parasysh kushtet e kohës, kanë korrur shumë produktivitet.

Çështja më jetike për t'i përgatitur për jetën fëmijët dhe të rinjtë nga aspekti i myslimanëve, është edukimi i tyre duke u qëndruar besnikë fesë, atdheut, traditës dhe zakoneve të tyre. Nëse nuk do të kenë edukim fetar, ata do ta kenë shumë të vështirë të ruajnë identitetin e tyre dhe të mësojnë historinë e të kaluarën e tyre. Edukimi fetar është ai që mund t'i bëjë ata të formojnë lidhje me këto vlera.

Vlerësimi në këtë çështje që ka bërë psikiatri i njohur Ord. Prof. Dr. Maz'har Osman Uzmani, i cili flet për rëndësinë e edukimit fetar, është shumë i rëndësishëm:

“...Edukimi më themelor për shoqërinë në botë

është feja. Frymëzimet e mëvonshme që u bëhen shoqërive, të cilat nuk mbështeten në përsheptshmëri dhe që nuk kanë edukim fetar, nuk janë ndikuese, edhe nëse janë të forta. Çdo individ është i lidhur ndaj traditës fetare në mënyrë trashëguese dhe nga natyrshmëria e tij. Në edukimin familjar, që formohet mbi fenë, ka baza edhe më serioze. Sigurisht se edhe edukimi shkollor është një edukim i fuqishëm, që duhet të respektohet, por nëse bazën e kësaj e formojmë që në fillim, ka më shumë produktivitet.

Edukimi fetar e mbron njeriun nga të këqijat dhe ligësitë që mund t'i bëjë vetes, familjes, atdheut, popullit dhe të gjithë botës. Në këtë periudhë është kuptuar se faktori i vështirësive që konsiderohen më materiale në jetë, është shpirtëror dhe psikologjik. Sëmundjet dhe hidhërimet më të rënda, qetësohen dhe shuhet me ngushëllime fetare dhe me lartësim të shpirtit. Të rinjtë që janë të lidhur me fenë, moralin e traditën dhe janë të edukuar në këtë mënyrë, bëhen njerëzit më fatlumë, sidomos nëse u jepet edhe edukimi kulturor e civil. Kudo që të shkoni nëpër botë, do të shikoni se edhe njerëzit



GJALLËRIMI I BREZAVE, LUMTURIA E TYRE NË KËTË BOTË E NË BOTËN TJETËR, JANË TË LIDHURA ME KUPTIMIN DHE ZBATIMIN E PARIMEVE QË U JEP JETË KURANI. ATA DO TA NJOHIN ZOTIN, VETEN E TYRE DHE NJERËZIT ME PARIMET UNIVERSALE TË KURANIT FISNIK. KRENARINË E NJERËZIMIT, DO TA PËRJETOJNË ME PARIMET GJALLËRUESE TË KURANIT.

me kulturën më të lartë, janë të lidhur ndaj fesë, popullit, familjes, nderit dhe traditës. Një njeri që nuk di të respektojë fenë dhe moralin, e ka shumë të vështirë të respektojë ligjin.”<sup>1</sup>

Çështjen bazë të edukimit fetar e formon mësimi i Kuranit. Kurani Fisnik e mbron, e zhvillon dhe e forcon natyrshmërinë e pastër e të dëlirë të fëmijëve dhe të rinjve, që akoma nuk kanë bërë mëkate. Myslimanët e dinë këtë të vërtetë dhe për këtë arsye, e kanë pranuar si detyrë themelore mësimin e Kuranit fëmijëve të tyre që në moshë të vogël dhe janë përqendruar në këtë aspekt.

Kurani është një libër jete. Ky është parimi i parë që duhet t’ua bëjmë të qartë dhe t’ua theksojmë fëmijëve dhe të rinjve kur t’ua mësojmë Kurantin. I Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe shokët e tij të zgjedhur, u kapën fort pas Kuranit, duke e pranuar atë si një libër jete dhe zbatimin e urdhrave të tij e kishin parim themelor.

Aisheja e pyeti kështu një sahabi, i cili dëshironte të mësonte moralin e Pejgamberit, alejhisselam,

1. *Uyusturucu Kültürü ve Tedbirler Raporu*, Stamboll, 1992, fq. 181 (Revista e botuar nga Yesilay Cemiyeti Genel Merkezi).

nga ajo: “Ti e lexon Kurantin, apo jo?” Sahabiu iu përgjigj: “Po, e lexoj.” Pastaj Aisheja, radijallahu anha, i tha: “Ja, morali i të Dërguarit të Allahut (a.s.), ishte Kurani.”<sup>2</sup>

Siç shprehet qartë edhe në hadithin fisnik, morali i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ishte vetë Kurani Fisnik. Ai ishte dëshmitari i gjallë i Kuranit. Te Ai gjendeshin të gjitha atributet etike, për të cilat bëhet fjalë në Kuran. Ai, (a.s.), ka zbatuar çdo gjë që ka urdhëruar Kurani dhe është larguar nga të gjitha të këqijat e mëkatet që i ka ndaluar ai. I Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk është ndarë kurrë nga rruga e drejtë që ka përkufizuar urdhri hyjnor:

**“Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar”<sup>3</sup>**

Madje, Pejgamberi u ndikua aq shumë nga ky ajet, saqë tha: “*Mua më ka plakur surja Hud.*”<sup>4</sup> Në këtë mënyrë, tregoi thellësinë dhe madhështinë e mesazhit që përfshin ajeti.<sup>5</sup> Pejgamberi ishte një Kuran i gjallë. Edhe sahabët e nderuar u bënë shembull për të gjithë umetin, duke ndjekur të njëjtën rrugë.

Ibn Mes’udi dhe Ubeji, radijallahu anhuma, transmetojnë se i Dërguari i Allahut, (a.s.), u mësonte atyre nga dhjetë ajete. Ata nuk kalonin te dhjetë ajetet e tjera pa i zbatuar dispozitat që gjendeshin në dhjetë ajetet e para. Pejgamberi ua mësonte atyre Kurantin dhe të punuarit me Kurantin. Abdurrahman es-Sulemi tregon: “Kur mësonim dhjetë ajete nga Kurani, nuk mësonim ajete të tjera pa i mësuar mirë urdhrat, ndalesat, hallallin dhe haramin që përfshinin ato dhjetë ajete.”

Imam Maliku transmeton se Ibn Amri e ka mësuar suren Bakara për dymbëdhjetë vjet. Kur e kishte përfunduar, kishte prerë një deve. Ndërsa Abdullah bin Mes’udi ka thënë: “Ne e kishim të vështirë të mësonim përmendsh Kurantin. Por e kishim të lehtë të punonim me të. Ndërsa, ata që vijnë pas nesh, e kanë të lehtë për ta mësuar Kurantin përmendsh, por e kanë të vështirë për të punuar me të.” Thuhet se edhe Umer bin Hattabi, radijallahu anh, e ka mësuar suren Bakara për dhjetë vjet dhe kur e ka përfunduar, ka prerë një deve për të falënderuar Allahun Teala.<sup>6</sup>

Ne duhet ta gdhendim në vetëdijen e fëmijëve

2. Muslim, *Musafirun*, 139; Tirmidhi, *Birr*, 69; Ibn Maxhe, *Ahkam*, 14; *Abdullah bin Hanbel*, IV, 54, 91.

3. *Surja Hud*, 11/112.

4. Tirmidhi, *Tefsir*, *Surja* 57/6.

5. Kerim Bulladë, *Pejgamber Gibi Yasamak*, Stamboll, 2007, fq. 10.

6. Kurtubi, Ebu Abdillahu Muhammed b. Ahmed, *Xhamiu li Ahkami'l-Kur'an*, Bejrut, 1993, I, 44-45.

se Kurani është një libër jete dhe se nuk është dërguar vetëm për ta lexuar e mësuar përmendsh. Po ashtu, duhet ta theksojmë seriozisht se parimet e dispozitave të tij, duhet të zbatohen në jetë. Kurani i urdhëron kështu të gjithë besimtarët në lidhje me këtë çështje:

***“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyt midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mbliidheni të gjithë!”***<sup>7</sup>

Gjërat që u japin jetë besimtarëve janë urdhrat dhe ndalesat e Allahut Teala dhe të të Dërguarit të tij, (a.s.). Pa dyshim se në çdo urdhër të Allahut Teala, ka urtësi dhe jetë. Çdo urdhër që vjen nga Allahu (xh.xh.), duhet të pranohet dhe të zbatohet. Kur t’u mësojmë Kuranin fëmijëve dhe të rinjve, vetëdijen e nënshtrimit ndaj Allahut Teala që shprehet në ajetin e mëposhtëm, duhet t’ua japim me përkujdesjen më të madhe. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

***“I Dërguari beson në atë (Kuranin) që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij (duke thënë): ‘Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij’. Ata thonë: ‘Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti ynë dhe te Ti do të kthehemi!’”***<sup>8</sup> Mësimi, leximi dhe mësimi përmendsh i Kuranit Fisnik, domosdoshmërisht duhet të formohet mbi bazën e ajetit të mësipërm dhe kjo duhet të shpjegohet me insistim.

I ndjeri Alija Izetbegoviçi, që myslimanët e Bosnjës e quajnë “Mbreti i ditur”, thotë se myslimanët e sotëm i kanë dhënë më shumë rëndësi zbukurimit të Kuranit se sa përmbajtjes së tij dhe duke u shprehur se edhe fëmijët edukohen brenda kësaj kornize, në lidhje me këtë çështje bën këtë koment të rëndësishëm:

“Gjendja e Kuranit në botë po shfaq një situatë shumë tragjike. Në çdo shtëpi, do ta gjeni atë në një vend të veçantë dhe të lartë. Ai pranohet si dhurata më e bukur, për këtë arsye, përdoret letra më cilësore në botimin e tij. Madje, njerëzit sot po garojnë për të përdorur kaligrafinë më të mirë dhe për ta zbukuruar kopertinën e faqet e tij në mënyrën më fantastike. Gjëja e parë që lexon dhe mëson fëmija është Kurani, por krahas kësaj, pjesa dërmuese e këtyre fëmijëve, do të rriten dhe

plaken pa e mësuar përmbajtjen dhe rëndësinë e vërtetë të Kuranit Fisnik. Kurani është një simbol i padiskutueshëm, por e ka humbur të qenët ligj. Ndërkohë që duhet të ndodhë e kundërta.

Vini re, në vend që njerëzit të lexojnë Kuranin, ata e zbukurojnë me zë të bukur dhe e komentojnë. As arabët dhe as joarabët, tashmë nuk mund ta kuptojnë Kuranin. Për shkak të melodisë së pasqorë të tij, askush nuk po i njeh më ligjet e tij në formë urdhri të prerë dhe absolut, nganjëherë paralajmërues të ëmbël dhe ftues e nganjëherë kërcënues dhe që kërkojnë që jeta e njeriut të ndryshojë e tëra.”<sup>9</sup>

Çështja më kryesore, të cilën duhet ta shtjellojmë kur t’i takojmë e prezantojmë fëmijët dhe të rinjtë me Kuranin, është kjo: “Përse është dërguar Kurani dhe shpjegimi i faktit se ai është një libër që e orienton jetën dhe se ndërhyt në të. Synimi bazë që duhet t’u mësojmë fëmijëve, është se Kurani është zbritur për t’i udhëzuar njerëzit dhe për t’ua ndryshuar jetën atyre.

Ta respektohet Kuranin, të mos e krahasosh me librat e tjerë, ta mbash lart mbi kraharor e të mos e vendosësh në tokë dhe të mos vendosësh mbi të libra apo ndonjë gjë tjetër, sigurisht se janë gjëra të rëndësishme, por të mos u bëhet e qartë fëmijëve përmbajtja dhe qëllimi i dërgimit të Kuranit dhe t’u paraqitet Kurani vetëm si një simbol i padiskutueshëm, kur u mësohen parimet që thamë më lart, nuk përputhet me synimin e dërgimit të Librit të Lartë, i cili është zbritur nga Zoti i botëve.

Gjëja më e domosdoshme që duhet të bëjmë sot, është kapërcimi i mentalitetit që fëmijët ta lexojnë Kuranin vetëm si fjalë, të bëhen hafizë, të bëjnë hatme dhe ta lexojnë atë për shpirtin e prindërve apo të njerëzve në të kaluarën. Krahas leximit dhe mësimi përmendsh të Kuranit, vazhdimi i aktivitetit të kuptimit, shpjegimit dhe përjetimit serioz të tij, do t’ua hapë horizontin fëmijëve e të rinjve tanë, do t’ua forcojë besimin dhe do t’ua mbrojë e zhvillojë natyrshmërinë e tyre.

Gjallërimi i brezave, lumturia e tyre në këtë botë e në botën tjetër, janë të lidhura me kuptimin dhe zbatimin e parimeve që u jep jetë Kurani. Ata do ta njohin Zotin, veten e tyre dhe njerëzit me parimet universale të Kuranit fisnik. Krenarinë e njerëzimit, do ta përjetojnë me parimet gjallëruese të Kuranit.

7. Surja Enfal, 8/24.

8. Surja Bakara, 2/285.

9. Alija Izetbegovic, *Islami Yeniden Dogusun Sorunlari ve Islam De - larasyonu*, Përkth, Rahman Ademi, Stamboll, 2007, fq. 71.



“O besimtarë, bëhuni ndihmësit e Allahut, ashtu siç u tha dishepujve Isai, i biri i Merjemes: «Kush janë ndihmësit e mi për çështjen e Allahut?» Dishepujt u përgjigjën: «Ne jemi ndihmësit e Allahut!»...”

(Saff, 14)

## PËRGJEGJËSIA E DAVETIT

Të gjithë kanë një synim pas të cilit rendin dhe i japin rëndësi sipas interesave personale. Dikush ka synim egon, veten e tij. Këta janë njerëz që nuk kalojnë përtej interesave personale, pra nuk e tejkalojnë dot vetveten. Për rrjedhojë, këta e konsumojnë jetën e tyre pas dëshirave të egos dhe pasioneve egoiste. Ka disa të tjerë që në dukje janë njerëz idealistë dhe në këtë rrugë bëjnë disa sakrifica. Mirëpo, e gjithë llogaria e tyre, është interesi personal. Kush e sheh nga jashtë, pandeh se ky përpjeket në rrugën e drejtë. Por qëllimi i vetëm i të gjitha përpjekjeve të tij, është ardhmëria e tij personale. Ai nuk ka asnjë ideal të lartë në emër të paqes dhe harmonisë së njerëzimit.

Sa u përket njerëzve me ideale të vërteta, këta janë persona me shpirt të lartë. Synimet e tyre janë drejt përjetësisë. Ata nuk shkojnë pas llogarive të vogla, por pas dëshirave që kalojnë përtej vdekjes. Ata janë të mbushur me dashurinë për të vërtetën dhe drejtësinë dhe nuk shqetësohen për para dhe pozitë. Këta njerëz nuk jetojnë për veten por për popullin dhe njerëzimin. Këta gjenden në majë të sinqeritet të idealeve të tyre dhe, nëse është nevoja ata nuk ngurojnë të sakrifikojnë edhe jetën e tyre në atë rrugë. Ata që dëshironin të binin dëshmorë në betejën e Bedrit dhe ata që prisnin radhën për të rënë dëshmorë në çlirim të Stambollit, janë vetëm disa prej këtyre therorëve.

Idealistët e vërtetë, gëzohen me gëzimin e njerëzve dhe hidhërohet me hidhërimin e tyre. Ata janë përfaqësuesit e ndërgjegjes sociale. Ata besojnë se jeta ka kuptim vetëm nëse bëjnë sakrifica për njerëzit dhe e ndajnë veten përgjegjës ndaj njerëzimit. Ata nuk kthejnë shpinën duke thënë “ç’më duhet mua”. Padrejtësitë ua trazojnë shpirtin. Zhytja e

njerëzve në gjynahe ua prish gjumin dhe s’mund ta përtpin dot as kafshatën e bukës.


Fetë ngrihen në supet e njerëzve idealistë. Nëse një fe është e vërtetë, por nuk ka pjesëtarë që përpriqen me vetëmohim për të, do të thotë se është jetime, sepse ajo e ka humbur energjinë e forcës dhe fuqinë e shtytjes. Në këtë aspekt, çdo mysliman është përgjegjës. Mirëpo, ka edhe prej atyre që ndodhen në pozitën e përfaqësimit të kësaj feje, gjë e cila është edhe detyra e tyre kryesore. Ata duhet të jenë vazhdimisht në kërkim të së vërtetës dhe duhet ta ngrenë atë, sepse njerëzit dëshirojnë t’i shohin këta në krye në aspektin e besimit dhe jetës. Por nëse ata e kanë humbur shpirtin idealist, kjo është një situatë e hidhur për Islamin dhe myslimanët.

Kuani i thërret njerëzit të largohen prej egoizmit dhe të solidarizohen me njerëzit e tjerë. Po ashtu, ai i thërret të braktisin idealet shterpë dhe të lidhen pas një ideali të lartë. Kurani i ndan nga njëri-tjetri ata që kanë për synim ngritjen e emrit të vet dhe ata që dëshirojnë të ngrenë lartë emrin e Allahut të Madhëruar. Ai na njofton se të shpëtuar nuk janë ata që jetojnë për interesat e tyre personale, por ata që jetojnë për idealet e larta njerëzore.

Përçimi i kauzës së teuhidit që prej njeriut të parë deri në ditën tona, është realizuar në sajë të njerëzve vetëmohues, të cilët janë përpjekur pa prituri asnjë shpërblim, sepse ata kishin moral profetik. Lidhur me këtë çështje Nuhu (a.s.), shprehet: **“O populli im! Unë për këtë nuk kërkoj nga ju kurrfarë pasurie. Mua më shpërblen vetëm Allahu!..”** (Hud, 29)

Këta njerëz me ideale, nuk kanë rendur kurrë pas interesave të kësaj bote. Ata gjithmonë i kanë mbaj-





tur lartë synimet e tyre. Ëndrrat dhe dëshirat e tyre kanë qenë gjithmonë përtej kësaj bote. Nëse nuk do të ishin përpjekjet e tyre, do të ishte e pamundur që flamuri Islam të arrinte në kontinentet e tjera pas shumë shekujsh. Ata braktisën shtëpitë, familjet dhe atdheun e tyre në këtë rrugë vetëm e vetëm për të përçar tek njerëzit pishtarin e teuhidit.

Kuptimin e vërtetë të idealit, na e kanë mësuar profetët. Përpjekja legjendare e Nuhut (a.s.), është një shembull i paharrueshëm për të gjithë ftuesit Islamë që i shërbejnë fesë së Allahut të Madhëruar. Lidhur me përpjekjen e tij të pamposhtur, flitet gjerë e gjatë në hyrje të sures përkatëse. Një nga përgjërimet e Nuhut (a.s.), që kalon në këtë sure është edhe kjo: **“O Zoti im, unë e thirra vërtet popullin tim natë e ditë.”** (Nuh, 5) Nuhu (a.s.), ka treguar një përpjekje të jashtëzakonshme, sa mund të thuhet “ja kështu bëhet ftesa në fe!”. (shih. Nuh. 2-10.) Përpjekja e tij madhështore, ka qenë gjithmonë burim frymëzimi për ne.

Në ditët tona kur pothuajse është harruar përgjegjësia e davetit Islam dhe ka humbur entuziazmi i kësaj kauze, kemi shumë nevojë të pajisemi me shpirtin e Nuhut (a.s.). Gjithashtu, Kurani na flet edhe për dishepujt e Isait (a.s.). Jeta e tyre, është bërë shembull legjendar i shërbimit me vetëmohim në fenë e Allahut. Profeti Isa (a.s.), i thirri ata ta ndihmonin në fenë që ai po sillte prej Zotit dhe ata pranuan të bëhen “ensarullah”, pra ndihmës të Allahut. (shih. Saff, 14.) A mos kishte Zoti nevojë për ndihmën e tyre? Kurrsesi! Mirëpo kuptimi i ajetit, është se ata u thirrën si “ensaruddin”, pra ndihmës të fesë së Allahut. Për rrjedhojë, Allahu i pranoi këta njerëz si ndihmës të Tij.

Nisur nga kjo, mund të themi se ftuesi në fe, ka

një afërsi të veçantë me Allahun. Në një farë kuptimi, mund të quhet edhe “njeri i Allahut”, gjë e cila duhet të jetë edhe një nga sihariqet më të mëdha për një ftues Islam. Ky ajet, i fton ftuesit Islam të çdo periudhe të marrin shembull nga ky grup njerëzish. Në fakt, ata që ndihmojnë Allahun, patjetër do të kenë edhe ndihmën e Tij. Kjo, vërtetohet në këtë ajet fisnik: **“Sigurisht, Ne do t’i ndihmojmë të dërguarit Tanë dhe besimtarët, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në Ditën, kur do të sillen dëshmitarët.”** (Mu’min, 51)

Në lidhje me përgjegjësinë ndaj kauzës, ka shumë gjëra që duhet t’i marrim prej Profetit tonë (a.s.). Nuk është aspak e drejtë nëse përpiqemi t’i lajmë duart nga kjo çështje duke e lidhur me faktin se ai ishte profet, sepse ai iu dërgua njerëzve me qëllim që të merret shembull. Jeta e tij na ofron një shembull të pashoq në lidhje me moralin e kauzës. Për rrjedhojë, në ajetin e tretë të sures Shuara, tregohet se Profeti ynë (a.s.), ishte hidhëruar jashtë mase për shkak të mosbesimit që shfaqnin idhujtarët. Shprehja “bahiu’n-nefs”, që përdoret në këtë ajet, do të thotë “ai që vret veten”. Kjo shprehje, tregon qartë se sa shumë e ka hidhëruar Profetin (a.s.), këmbëngulja në mohim e atyre njerëzve. I Dërguari i Allahut (a.s.), fajëson veten e tij që ata nuk po besojnë, duke përjetuar kështu një lloj psikologjie faji, sepse ai e dinte shumë mirë përfundimin e hidhur që do të shkaktonte mosdorëzimi ndaj urdhrave të Allahut. Kur mendonte gjendjen e njerëzve në botën tjetër, gjoksi i tij ngushtohej dhe pothuajse brente vetveten nga brenda. Në fund të këtij shkrimi, i lutemi Allahut të madhëruar, të na pajisë edhe ne me një ndjenjë kaq të lartë përgjegjësie ndaj fesë së Tij. Amin!



# RAMAZANI DHE BAJRAMI

Dy festat e bajrameve janë vendosur jo sipas ndonjë kohe të zakonshme në kalendar, por janë vendosur në dy pika të rëndësishme.

E para;

Festa e Bajramit të Ramazanit si një nderim të një muaji në të cilin shtohet ibadeti, pra, në nderim të muajit të Ramazanit...

E dyta;

Festa e Bajramit të Kurbanit në ditën e dhjetë të Dhulhixhes në të cilin myslimanët bëjnë sakrificën e tyre duke therë kurbane për Zotin dhe që pastaj ua japin ato të varfërve...

## RAMAZANI FISNIK: MEJTEPI I DEVOTSHMËRISË

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), është një rregull real, një shembull për t'u ndjekur, shembulli më i bukur dhe shembulli më i shkëlqyer për ne në adhurimin dhe nënshtrimin ndaj Allahut Teala...

I Nderuari ynë na ka mësuar që ta adhurojmë Allahun (xh.xh.), sipas fesë së drejtë përgjatë gjithë jetës. Ndërsa për kohët e bekuara siç është muaji i madhërisëm i Ramazanit, na ka mësuar që t'i konsiderojmë si pasuri dhe mundësi të vjera.

Ramazani fisnik na vjen për çdo vit si një nderim sublim i Allahut Teala.

Ndaj cilat gjëra bënin kujdes Pejgamberi (a.s.) dhe sahabët e nderuar në muajin e madhërisëm të Ramazanit? Çfarë këshillash na kanë dhënë?

Ne duhet t'i mësojmë dhe t'i praktikojmë ato.

Ibn Abbasi (r.a.), tregon siç vijon se çfarë bënte Pejgamberi ynë i Nderuar në muajin e Ramazanit:

“Resulullahu (a.s.), ishte njeriu më bujar. Ndërsa koha kur ishte më bujar, ishte koha kur Xhebraili takohej me të në Ramazan.

Xhebraili (a.s.), takohej çdo natë të Ramazanit me të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe i këndonin Kuran njëri-tjetrit. Për këtë arsye, kur Resulullahu (a.s.), takohej me Xhebrailin (a.s.), ishte më bujar se një erë e begatë që fryn pa u ndaluar nga asnjë gjë.” (Buhari, Bed'u'l-Vahj, 5; Muslim, Fedail, 48.)

Edhe sahabët e nderuar me mallëngjimin për ta pasuar atë, bëheshin më bujarë. Kështu që shtroheshin sofrat e iftarit dhe fillonte gara për shërbim ndaj “robërve të Allahut” (njerëzve).

Edhe në ditët e sotme elhamdulillah-jepen iftare, por duhet të shfaqet kujdes ndaj disa çështjeve:

Iftari nuk duhet të jepet në lokale ku serviret alko-ol, sepse era e mëkateve dhe gjynaheve influencon nëpër zemrat e njerëzve.

Në vend të këtyre, iftaret duhet të jepen në mje-





dise të pastra dhe hallall. Në sofrat e iftareve duhet të ftohen veçanërisht të varfrit dhe nevojtarët. Ushqimi i iftareve duhet të begatohet me të varfrit dhe nevojtarët.

“I Nderuari ynë na ka mësuar që ta adhurojmë Allahun (xh.xh.), sipas fesë së drejtë përgjatë gjithë jetës. Ndërsa për kohët e bekuara siç është muaji i madhërishtëm i Ramazanit, na ka mësuar që t’i konsiderojmë si pasuri dhe mundësi të vjera.”

Një justifikim i atyre që bëjnë gabime si këto është shkujdesja shpirtërore në formën: “I nderuar, do të vijë protokoll!” Aty ku është e rëndësishme kënaqësia e Allahut nuk mund të ketë rëndësi diçka tjetër.

“A është më i rëndësishëm protokoll, apo kënaqësia e Allahut”? Këtë duhet ta mendojmë mirë.

Sevapeve që presin ata që japin gosti në iftare, dasma dhe mjedise luksoze vetëm për protokollet, ndoshta do të jetë kjo përgjigje që do t’u jepet:

“Shko dhe merr shpërblimin prej atyre që u je shtirur! Ndërsa sevapin që e prisje prej sofrave luksoze dhe plot shkujdesje shpirtërore në të cilat nuk i ftove të varfrit, merre prej atyre njerëzve që i quaje protokoll!

“Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), është

një rregull real, një shembull për t’u ndjekur, shembulli më i bukur dhe shembulli më i shkëlqyer për ne në adhurimin dhe nënshtrimin ndaj Allahut Teala...”

Sofrat shpirtërore me të cilat kërkohet afrimetit ndaj Zotit (xh.xh.) dhe në të cilat shfaqet kënaqësia hyjnore, janë vetëm sofrat e dhembshurisë dhe mëshirës në të cilat ushqehen veçanërisht të varfrit dhe nevojtarët.

Sa shembull i bukur është ky tregim historik për moralin e të qëndruarit bashkë me të varfrit:

Sulltan Murati III në një Ramazan kishte shkuar për iftar në konakun e Shejhulislam Mehmet Emin Efendit. Përgjatë fjalës së tij tha:

“Mehmet Emin Efendi! Te ju dëshiroj të vij herë pas here, por konaku juaj është shumë larg.”

Mehmet Emin Efendi bëri një shpjegim në mënyrë indirekte me mirësjellje dhe modesti:

“Madhëri! Falë jush mund të sigurojmë një shtëpi në ndonjë vend të afërt, por në asnjërin prej shtëpive të këtij vendi që patë nuk ka kuzhinë.”

Për shkak se ky shpjegim indirekt nuk u kuptua qartë, Padishahu pyeti i habitur:

“E çuditshme! A nuk gatujmë ushqim në këto shtëpi?”

Nisur nga kjo, Mehmet Emin Efendi me modesti dhe mirësjellje i dha sulltanit këtë përgjigje që reflektonte ndjeshmërinë e botës shpirtërore të tij:

“Madhëri! Ushqimi i mëngjesit dhe mbrëmjes të gjithëve u shkon nga konaku ynë modest. Për këtë arsye nuk dëshiroj të largohem prej këtu.” (Syhejl Ynver, Bir Ramazan Bin Bir Istanbul, fq. 64.)

Ramazani fisnik është periudha e shtimit të ibadeteve.

Nëna jonë, Aishja (r.anha), tregon:

“Kur hynte dhjetë ditshi i fundit i muajit të Ramazanit, Resulullahu (a.s.), i kalonte netët me adhurim. Gjithashtu i zgjonte edhe pjesëtarët e familjes (për të bërë adhurim natën). Ai i ndërpriste marrëdhëniet me bashkëshortet për të shtuar ibadetet.” (Buhari, Lejletu'l-Kadr, 5; Muslim, I'tikaf, 7.)

Sahabët e nderuar e ndiqnin të Dërguari i Allahut (a.s.), në namazet që i falte natën. Por i Nderuari ynë nuk e fali me xhamet namazin e taravisë me fri-



kën që të mos i bëhej farz umetit. Ndërsa në kohën e Hazreti Omerit, ngaqë ishte hequr mundësia për t'u bërë farz, namazi i taravisë filloi të falej me xhemat sipas konsensusit të të gjithëve. Një çështje ndaj të cilës duhet të tregohet ndjeshmëri në namazin e taravisë është se ky namaz duhet të falet me tadil-erkan (duke ia dhënë hakun të gjitha rregullave të tij) dhe duke u thelluar në meditim.

“Ibn Abbasi (r.a.): “Resulullahu (a.s.), ishte njeriu më bujar. Ndërsa koha kur ishte më bujar, ishte koha kur Xhebraili takohej me të në Ramazan.”

Kuranit Fisnik i kushtohet një rëndësi krejt tjetër në muajin e Ramazanit. Zemrat jetonin në gjendje devotshmërie.

Muaji i Ramazanit është periudha kur duhet të preokupohemi më shumë se çdo herë tjetër me Kuranin, sepse Kurani Fisnik është zbritur nga Allahu i Lartësuar si shërim dhe mëshirë.

Si nderim dhe mirësi të kësaj jete të devotshme është dhuruar Nata e Kadrit në dhjetë netët e fundit të Ramazanit. Allahu i Madhëruar shfaq një bujari të atillë në Natën e Kadrit saqë thotë:

“Një natë më e mirë se një mijë muaj!..”

Kjo është një shprehje e pafundme e emrave “Rahman dhe Rahim” të Allahut Teala.

Andaj duhet të mendojmë se;

Me çfarë lavdërimi dhe falënderimi duhet t'ia kthejmë ne kësaj bujarie madhështore të Atij!

Domethënë;

Nata e Kadrit ka dy aspekte:

- Bujaria e pafundme e Allahut të Madhëruar,
- Dashuria që (Ai) ka për Hazreti Pejgamberin.

“Xhebraili (a.s.), takohej çdo natë të Ramazanit me të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe i këndonin Kuran njëri-tjetrit. Për këtë arsye, kur Resulullahu (a.s.), takohej me Xhebrailin (a.s.), ishte më bujar se një erë e begatë që fryn pa u ndaluar nga asnjë gjë.” (Buhari, Bed'u'l-Vahj, 5; Muslim, Fedail, 48.)”

Vallë sa e do Allahu i Lartësuar Pejgamberin e Tij që, Nata e Kadrit u bë një mirësi që i përket vetëm atij? Po ashtu, falë tij kjo natë iu dhurua edhe umetit.

Atëherë edhe ne le të marrim nga gjendja e Resulullahut, alejhi's-selam, në mënyrë që të jemi bashkë me të në ditën e kiametit. Le ta bëjmë fytyrën e tij të buzëqeshë në ditën e kiametit. Le të marrim ndërmjetësimin e tij, të hyjmë në xhenet dhe të shohim bukurinë e Allahut (xh.xh.).

Kurani Fisnik është ai që ia jep këtë vlerë dhe

shenjtëri Natës së Kadrit. Atëherë sa duhet ta shtojmë interesimin me Kuranin i cili është mesazhi i Allahut Teala për ne?

Njëra prej gjërave ndaj të cilave duhet të kemi më së shumti kujdes përgjatë muajit të Ramazanit është bërja hallall ndaj njëri-tjetrit. Pejgamberi ynë i Nderuar (a.s.), ka thënë:

“O njerëz! Kushdo që të ketë ndonjë hak të dikujt, le ta paguajë atë menjëherë dhe të mos thotë se poshtërohem në këtë botë! Dijeni se poshtërimi në këtë botë është shumë i lehtë në krahasim me poshtërimin në ahiret.” (Shik. Ibn Sa'd, II, 255; Taberiu, Tarih, III, 191.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), nuk ia falte namazin e xhenazes atij që kishte borxhe. Nëse borxhet e atij i merrte përsipër dikush nga sahabët, atëherë ia falte namazin. Kur kishte mundësi, ato borxhe i merrte vetë përsipër.

Domethënë se përgjatë muajit të madhërishtë të Ramazanit duhet të shfaqim përpikëri për t'i paguar dhe kompensuar edhe borxhet që mund t'i kemi ndaj njerëzve, edhe borxhet që i kemi ndaj Allahut (xh.xh.). Ata që kanë namaze që u kanë mbetur kaza, duhet të përpiqen t'i kryejnë. Ata që kanë për të dhënë zekatin, duhet t'ua japin këtë të drejtë pa ua vonuar atyre që e meritojnë.

“Iftari nuk duhet të jepet në lokale ku serviret alkool, sepse era e mëkateve dhe gjynaheve influencën nëpër zemrat e njerëzve.”

Urdhri hyjnor:

“**Në pasuritë e tyre (besimtarëve) ka pjesë për lypësit** (që mund ta shfaqin gjendjen e tyre) **dhe nevojtaret** (që nuk e shfaqin dot gjendjen e tyre).” (Dharijat, 19)

Domethënë se çështja nuk mbaron duke u dhënë vetëm atyre që mund ta shfaqin gjendjen e tyre. Ne duhet t'i kërkojmë e t'i gjejmë edhe ata që nuk e shprehin dot gjendjen e tyre dhe të harxhojmë kohë për këtë. Madje urdhërohem që të posedojmë një botë shpirtërore deri në atë gradë saqë t'ua qajmë hallin besimtarëve dhe të arrijmë t'i njohim nga fytyra ata që e fshehin veten për shkak të nderit dhe dinjitetit që kanë. Në ajetin fisnik thuhet:

“**Ti i njeht ata nga fytyra...**” (Bekare, 273)

“Iftaret duhet të jepen në mjedise të pastra dhe hallall. Në sofrat e iftareve duhet të ftohen veçanërisht të varfrit dhe nevojtaret. Ushqimi i iftareve duhet të begatohet me të varfrit dhe nevojtaret.”

Kur ta japim zekatin, lëmoshën, infakun dhe kur të bëjmë mirësi të tjera, ato duhet t'ia shfaqim jo

një të përkohshmi, por Allahut Teala. Kjo është një edukatë hyjnore, sepse njeriut që i janë dhënë, është vetëm një hije. Ai që i merr në të vërtetë është Zoti (xh.xh.).

Allahu i Lartësuar thotë:

**“Unë i marr! Lëmoshat i marr Unë!”** (Shik. Teube, 104)

Nisur nga ky këndvështrim;

Ai që jep, duhet ta falënderojë atë që merr, sepse personi që merr bëhet shkak që njeriu i cili jep të afrohet te Allahu (xh.xh.). Siç ka nevojë i varfri për ndihmën e të pasurit në këtë botë, edhe i pasuri do të ketë nevojë për lutjen e të varfrit në botën tjetër.

Agjërimi në muajin e Ramazanit na mëson peh-rizin. Qëndrimi larg grykësisë dhe shpërdorimit përgjatë iftarit dhe syfyrit në Ramazan është veprimi më i përshtatshëm me shpirtin e këtij muaji të bekuar. Mbajtja e kësaj gjendjeje edhe pas Ramazanit, është fitimi më i madh i Ramazanit.

Privimi që na bën agjërimi na jep mundësinë që të mendojmë për gjendjen e të varfërve, nevojtarëve dhe jetimëve që janë të privuar. Andaj muajin e Ramazanit duhet ta konsiderojmë si mundësi për të shtuar mëshirën tonë me këtë ndjesi. Sa shpërdorim i tmerrshëm do të ishte nëse nuk do të vepronim kështu dhe do t'i çonim dëm netët e Ramazanit duke bërë iftare e duke u argëtuar nëpër vende luksoze.

Ndërsa gjendja e të parëve tanë të devotshëm që e mësuam Ramazanin nga i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte kështu:

Mual-la ibn Fadli (r.a.), thotë:

“Selefët e devotshëm i luteshin Allahut Teala gjashtë muaj që t’ua mundësonte për të arritur Ramazanin. Ndërsa përgjatë gjashtë muajve të mbetur, i luteshin që t’ua pranonte Ramazanin.” (Kivamu’s-Sunne, et-Tergib ve’t-Terhib, II, 354.)

### NA MËSOI BAJRAMIN E VËRTETË

Në ajetin fisnik shprehet si më poshtë dashuria dhe mëshira që Pejgamberi ynë i Nderuar kishte për umetin:

**“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkonit rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.”** (Teube, 128)

“Iftaret po jepen nëpër vende jo të përshtatshme dhe me një shkujdesje shpirtërore të formës: “I nderuar, do të vijë protokollit!” “Kush është më i rëndësishëm protokollit apo kënaqësia e Allahut?” Këtë duhet ta mendojmë mirë.”

Mëshira që kishte Hazreti Pejgamberi (a.s.), ndaj umetit ishte në një gradë shumë më të lartë sesa mëshira e një nëne dhe babai ndaj fëmijës së tyre. Nisur nga ky këndvështrim, ai dëshironte dhe mendohej shumë për lumturinë dhe mirëqenien

e umetit. Në veçanti synonte që umeti të gëzohej dhe të mos përjetonte vështirësi as në “botën e përtejme, e cila është jeta e vërtetë” dhe gjithmonë e dëshironte këtë. Pejgamberi (a.s.), na dhuroi dy bajramet të cilat janë nderim nga Zoti për ne. Po ashtu na tregoi edhe recetat më efikase të lumturisë, në mënyrë që të arrijmë festat e përhershme.

Cila është festa e vërtetë të cilën ai (a.s.), na ka bërë ta përjetojmë?

“Festa e vërtetë është një gëzim i përbashkët dhe i përhershëm, është shpëtim nga fatkeqësitë dhe vuajtjet. Është sukses, është arritje, është fitim. Është diploma e arritjes së kënaqësisë së Allahut.”

“Sofrat shpirtërore në të cilat kërkohet afrimi te Zoti dhe shfaqja e kënaqësisë hyjnore janë vetëm softrat e dhembshurisë dhe mëshirës në të cilat veçanërisht ushqehen të varfrit dhe nevojtarët.”

Dy festat e bajrameve janë vendosur jo sipas ndonjë kohe të zakonshme në kalendar, por janë vendosur në dy pika të rëndësishme. E para;

- Festa e Bajramit të Ramazanit si një nderim një muaji në të cilin shtohet ibadeti, pra, në nderim të muajit të Ramazanit...

Ndërsa e dyta;

- Festa e Bajramit të Kurbanit në ditën e dhjetë të Dhulhixhes në të cilin myslimanët bëjnë sakrificën



e tyre duke therë kurbane për Zotin dhe që pastaj ua japin ato të varfërve...

Njëra është përkushtim në adhurim, tjetra është në sakrificë...

Domethënë se;

Vetëm atyre që e përfundojnë edukimin shpirtëror u jepet leje për të bërë bajram. Vetëm atyre që shfaqin sakrificë u jepet diploma e bajramit...

Allahu i Lartësuar i lavdëron dhe vlerëson këto sakrificat të Hazreti Ibrahimit dhe Hazreti Ismailit. Në ajet thuhet:

**“...O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën.”**  
**Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë punë-mirë!** *Kjo, me të vërtetë ka qenë një provë shumë e qartë! Ne e zëvendësuam atë* (Ismailin) *me një kurban të madh dhe i lamë atij* (Ibrahimit) *kujtim të mirë në brezat e mëvonshëm.* **“Paqja qoftë mbi Ibrahimin!”** *Ja, kështu, Ne i shpërblejmë punëmirë. Ai ka qenë vërtet një nga robërit Tanë besimtarë.” (Saffat, 104-111)*

Sa nderim dhe madhështi e madhe për sakrificën që bëhet me gjithë zemër!

Përveç të tjerash, i gjithë umeti i Muhamedit (a.s.), i dërgon salavate sherife Ibrahimit (a.s.), deri në kiamet.

Bazuar në këto që thamë më sipër, Pejgamberi ynë i Nderuar përgjatë gjithë jetës së tij;

1) Na ka mësuar festën e frymës së fundit.

Të gjitha veprat tona të mira apo të këqija janë përgatitje për frymën e fundit.

Bajrami është një diplomë sipas Ramazanit të kaluar!.. Nëse edhe jetën e ngjasojmë me Ramazanin fisnik, atëherë fryma e fundit do të jetë një diplomë që do të formohet sipas të vërtetës se si është kaluar jeta.

“Mual-la ibn Fadli (r.a.), thotë: “Selefët e devotshëm i luteshin Allahut Teala gjashtë muaj që t’ua mundësonte për të arritur Ramazanin. Ndërsa përgjatë gjashtë muajve të mbetur, i luteshin që t’ua pranonte Ramazanin.” (Kivamu’s-Sunne, et-Tergib ve’t-Terhib, II, 354.)”

Pejgamberi ynë i Nderuar e ka bërë predikimin ajet për ajet:

**“Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt** (para vdekjes) **e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.”** (Fussilet, 30)

Komentuesit e Kuranit kanë dhënë tri pika në lidhje me çështjen se kur dhe në çfarë gjendjesh realizohet (vjen) kjo ndihmë e engjëjve:

1. Në momentin e vdekjes, domethënë në frymën e fundit.

2. Në varr përgjatë momentin kur bëjnë pyetje “Munkerit dhe Nekirit”.

3. Në momentet e tmerrshme dhe të vështira të kiametit.

Ja pra, festa e vërtetë është shpëtimi nga frika dhe pikëllimi përgjatë këtyre gjendjeve të tmerrshme.

“Nëna jonë, Aishja (r.anha), thotë: “Kur hynte dhjetë ditshi i fundit i muajit të Ramazanit, Resulullahu (a.s.), i kalonte netët me adhurim. Gjithash-tu i zgjonte edhe pjesëtarët e familjes (për të bërë adhurim natën). Ai i ndërpriste marrëdhëniet me bashkëshortet për të shtuar ibadetet.” (Buhari, Lejletu’l-Kadr, 5; Muslim, I’tikaf, 7.)”

I Nderuari ynë (a.s.), në veçanti na mësoi;

2) Metodën për të qenë të sigurt në ditët e kiametit.

Kiameti është i mbushur plot me gjendje të tmerrshme. Ajo do të jetë një ditë e frikshme, e tmerrshme dhe e ashpër në të cilën njeriu do të ikë prej fëmijëve, bashkëshortit, bashkëshortes, nënës dhe babait... Një ditë në të cilën do t’u thinjen flokët qoftë edhe të rinjve... Një ditë aq e frikshme saqë nënat do t’i harrojnë fëmijët e tyre...

A ka ndonjë festë si shpëtimi nga frika dhe pikëllimi në një ditë të tillë? Në ajetin fisnik tregohet si më poshtë ata që do ta arrijnë këtë festë:

**“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.”** (Junus, 62)

**“Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt** (para vdekjes) **e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.”**

(Fussilet, 30)

Andaj është e domosdoshme që të bëhemi një besimtar i përsosur deri në atë masë sa që të mos frikësohemi dhe të mos pikëllohemi atë ditë. Dome- thënë duhet të bëhemi miq të Allahut...

Në hadithin fisnik thuhet:

*“Në ditën e kiametit kur nuk do të ketë asnjë hije (përveç hijes së Arshit), Allahu Teala do të fusë në hijen e Arshit shtatë (lloj) njerëzish:*

- *Kryetarin e drejtë të shtetit;*
  - *Të riun që është rritur në një jetë të pastër duke e adhuruar Zotin;*
  - *Myslimanin që e ka zemrën të lidhur me xhaminë;*
  - *Dy njerëz që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut dhe që takohen e largohen prej njëri-tjetrit për hir të Allahut;*
  - *Burrin që nuk e pranon kërkesën për marrëdhënie (seksuale) të një gruaje të bukur e me pozitë duke i thënë: “Unë kam frikë Allahun!”;*
  - *Njeriun që jep lëmoshë aq fshehurazi sa që dora e majtë nuk e di se çfarë ka dhënë dora e djathtë.*
  - *Njeriun që e përkujton Allahun në vetmi dhe derdh lot.”* (Buhari, Rikak, 24; Muslim, Zekat, 91.)
- “Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëllo- ni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.”*** (Fussilet, 30)

Nëse të gjitha pikat e mësipërme i përmbledhim në një shprehje, atëherë themi: “Ata që arrijnë mi- qësinë me Allahun Teala...”

Një emër tjetër i ditës së Mahsherit (tubimit të madh) është;

## DITA E NDARJES

Sepse atë ditë do të thuhet:

***“Ndahuni në një anë sot, o mëkatarë!”*** (Jasin, 59)

Ne jemi njoftuar se përgjatë sprovës së kësaj bote shejtani përpiqet që të bëhet ortak në pasuritë dhe fëmijët tanë. (Shik. Isra, 64.) Në periudhën tonë e cila është koha e fundit, po shohim shembuj shumë të dhimbshëm të kësaj.

“Ndhima e engjëjve vjen në këto situata:

1. Në momentin e vdekjes, domethënë në frymën e fundit.
2. Në varr përgjatë momentin kur bëjnë pyetje “Munkeri dhe Nekiri”.
3. Në momentet e tmerrshme dhe të vështira të kiametit.”

Mënyra për t’i mbrojtur fëmijët tanë nga sulmet e shejtanit është të edukuarit e tyre me karakterin dhe personalitetin e Islamit. Nëse arrijmë t’i edukojmë dhe t’i rrisim fëmijët tanë me frymën e Kuranit dhe Sunetit, në këtë botë do të përjetojmë prehjen shpirtërore dhe lumturinë që i shohim ata në rrugë të drejtë dhe në botën tjetër do të përjetojmë këna- qësinë e të qenët bashkë në xhenetet madhështore. Nëse mund t’ua lëmë trashëgimi fëmijëve tanë per- sonalitetin e Islamit, ata bëhen sadakatun xharije (lëmoshë e vazhdueshme) për ne.

Atë ditë, e cila është dita e ndarjes për mëkatar- rët;

Besimtarët, të devotshmit dhe të mirët do të bëjnë festë me përgëzimet nga Zoti (xh.xh.). Në ajetin fisnik thuhet:

***“Paqe! (shpëtim, prehje dhe lumturi e pafundme) do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë*** (për banorët e xhenetit).” (Jasin, 58)

Njeriun e presin shumë situata të tmerrshme në ditën e kiametit dhe në mejdanin e mahsherit. Ka- limi i këtyre situatave është festë.

• Merrja e librit të veprave nga e djathta është festë e vërtetë.

Sepse në vendin e mahsherit çdo robi (njeriu) do t’i thuhet:

***“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!”*** (Isra, 14) Shënimet e mbajtura deri në detajin më të vogël të jetës sonë, do të na shfaqen për t’i parë. Sytë, lëkura dhe gjymtyrët do të dëshmojnë për çdo vepër që kanë bërë.

Ja pra, kalimi me sukses i kësaj situatë është festë e vërtetë.

Gëzimin e festës që do ta përjetojnë ata që mund ta marrin nga ana e djathtë librin e veprave, do- methënë diplomën e jetës, domethënë ata që do të shpëtojnë, Zoti (xh.xh.), e shpreh kështu në ajetin fisnik:

***“Ai, të cilit do t’i jepet libri i veprave të tij nga ana e djathtë, (do të gëzohet aq shumë sa që) do t’u thotë (njerëzve të tij): “Ja, lexoni librin tim! Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llo- gari.”*** (Hakka, 19-20)

“Mëshira që kishte Pejgamberi ynë i Nderuar për umetin, ishte në një gradë shumë më të lartë se mëshira që ka një nënë dhe baba për fëmijën e tyre.”

Ky moment është një festë aq madhështore dhe ky gëzim është një lumturi aq e madhe sa që Allahu i Lartësuar na njofton në lidhje me të në Kurantin Fisnik.

• Gëzimi kur të peshojnë rëndë veprat e mira në peshoren e ditës së gjykimit është festë e vërtetë.

• Kalimi i urës së Siratit është festë e vërtetë.

Përfundimisht, të gjitha gëzimet në këtë botë janë të përkohshme. Festa e vërtetë është shpëtimi nga xhehenemi dhe hyrja në xhenet.

Nisur nga këto që thamë më lart, Resulullahu, alejhi's-selam;

3) Na ka mësuar mëshirën hyjnore, festën e shefaatit (ndërmjetësimit të Hz. Pejgamberit) dhe metodat e arritjes së këtyre:

Për ta arritur ndërmjetësimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), duhet të pasojmë gjurmët e tij dhe të bëjmë një jetë duke ndjekur Sunetin e tij.

“E gjithë dëshira dhe përpjekja e të Nderuarit tonë ishte për lumturinë dhe mirëqenien e umetit. Veçanërisht synonte që umeti të gëzohej dhe të mos binte në vështirësi në “jetën e përtejme e cila është jeta e vërtetë”. Ai gjithmonë këtë dëshiroi.”

Pak kohë para se të ndërronte jetë, Resulullahu (a.s.), bashkë me sahabët shkoi te varrezat dhe tha:

*“Paqja e Allahut qoftë mbi ju, o banorët e vendit të besimtarëve! Inshallah një ditë edhe ne do të bashkohemi me ju.*

*Do të dëshiroja shumë t’i shikoja vëllezërit e mi. Sa shumë që më ka marrë malli për ta!”*

Sahabët e nderuar i thanë:

“A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguari i Allahut?”

I Nderuari ynë iu përgjigj kështu:

*“Ju jeni sahabët e mi. Ndërsa vëllezërit tanë janë ata që nuk kanë ardhur akoma.”*

Nisur nga kjo përgjigje, sahabët e nderuar e pyetën:

“Si do t’i njohësh ata që nuk kanë ardhur akoma prej umetit tënd, o i Dërguari i Allahut?”

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), iu përgjigj atyre duke u parashtruar këtë pyetje:

*“Mendoni një burrë që ka një kalë i cili i ka ballin dhe këmbët e bardha. A nuk mund ta njohë ky burrë këtë kalë ndërmjet një kopeje kuajsh të zinj?”* Sahabët i thanë:

“Po, e njeh, o i Dërguari i Allahut!” Nisur nga kjo, Resulullahu, alejhi's-selam, vazhdoi:

*“Ja pra, edhe ata do të vijnë me fytyra të ndritura dhe me duar e këmbë që u shkëlqejnë për shkak të*

*abdestit. Unë do të shkoj para dhe do t’i pres në krye të burimit tim (Keutherit) për t’u dhënë ujë nga ai.*

*Kini kujdes! Disa njerëz do t’i largojnë nga burimi im siç largohet deveja e huaj nga kopeja. Unë do t’u thërras atyre: “Ejani këtu!”, por mua do të më thuhet:*

*“Ata e ndërruan gjendjen pas teje. (Nuk e kanë ndjekur sunetin tënd dhe kanë devijuar në rrugë të tjera.)” Për këtë arsye, edhe unë do të them:*

*“Le të rrinë larg, le të rrinë larg!..”* (Muslim, Taharet, 39, Fedail, 26.)

“Festa e vërtetë është një gëzim i përbashkët dhe i përhershëm, është shpëtim nga fatkeqësitë dhe vuajtjet. Është sukses, është arritje, është fitim. Është diploma e arritjes së kënaqësisë së Allahut.”

Domethënë se;

Afrimiteti me të Dërguarin e Allahut në ahiret do të jetë në raport me afrimitetin që kemi me të në këtë botë, sepse çdo gjendje e të dashuruarit ndikon te i dashuri në raport me dashurinë në zemër.

Një festë më e madhe se festa e xhenetit është festa e të qenët aty bashkë me Resulullahun (a.s.), sepse ai ka thënë:

*“Njeriu do të jetë bashkë me atë që do.”* (Buhari, Edeb, 96.)

Së fundi i Nderuari ynë, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të;

4) Na ka mësuar festën e Ru’jetull-llah (shikimit të Allahut).

“Marrja e librit të veprave nga e djathta është festë e vërtetë. Gëzimi kur veprat të vijnë rëndë në peshore është një festë e vërtetë. Kalimi i Siratit është një festë e vërtetë.”

Mirësia e Allahu të Lartësuar është e pafundme. Ai u ka përgatitur shpërblime madhështore aq sa nuk mund të imagjinohen atyre që arrijnë të bëhen miq me Të duke qenë të devotshëm. Kulmi i këtyre mirësive është shikimi i Bukurisë së Zotit.

Në ajetin fisnik thuhet:

**“Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë dhe Zotin e tyre do të shohin.”** (Kijame, 22-23)

Në një ajet tjetër fisnik thuhet:

**“Ata që (besojnë dhe) bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër (shikimin e bukurisë së Allahut)!”** (Junus, 26)

Po ashtu, në një ajet tjetër fisnik thuhet:



**“Për ata që i frikësohen paraqitjes para Zotit të vet (kështu që bëjnë një jetë me devotshmëri), do të ketë dy xhenete!”** (Rahman, 46)

Në njërin prej komentimeve të këtij ajeti në Te’vilati Nexhmijje, thuhet:

I pari është xheneti në të cilin do të hyjmë. Ndërsa i dyti është mirësia e shikimit të Allahut (xh.xh.). (Bursevi, Ruhul-Bejan, Botimet Erkam, XX, 420.) Allahu e di më mirë.

Andaj duhet të mendojmë se;

Sa gëzohemi përgjatë festave disa ditore në këtë botë? Për këto festa blejmë rroba të reja, përgatisim gosti dhe bëjmë programe.

Atëherë si duhet të përgatitemi për t’i arritur këto festa të përhershme?

- Duhet të përgatitemi me mirësi...
- Duhet të përgatitemi me gosti për hir të Allahut...
- Duhet të përgatitemi me namaze dhe ibadete plot përkushtim ndaj Zotit...
- Duhet të përgatitemi me lexim të Kuranit Fisnik, me zbatimin e tij në jetë dhe me thirrjen e njerëzve të tjerë për ta zbatuar atë në jetë...
- Duhet të përgatitemi duke e lidhur zemrën ndaj institucioneve që i shërbejnë fesë së Allahut (xh.xh.)...

Duhet të përgatitemi jo vetëm me ibadete formale, por edhe me farzet e padukshme (si morali i lartë, modestia, etj.)...

Për përgatitjen ndaj ahiretit nuk duhet të mjaftohemi vetëm me largim nga haramet formale, por edhe duke qëndruar larg haremeve të padukshme (si përgojimi, mashtrimi, etj.)...

“Për festat e përhershme duhet të përgatitemi me mirësi... Duhet të përgatitemi me gosti për hir të Allahut... Duhet të përgatitemi me namaze dhe ibadete plot përkushtim ndaj Zotit... Duhet të përgatitemi me lexim të Kuranit Fisnik, me zbatimin

e tij në jetë dhe me thirrjen e njerëzve të tjerë për ta zbatuar atë në jetë... Duhet të përgatitemi duke e lidhur zemrën ndaj institucioneve që i shërbejnë fesë së Allahut (xh.xh.)...”

Myslimani ndjen neveri nga haramet e dukshme. Për shembull, ai e urren mishin e derrit. Ndërsa njerëzit e shkujdesur që nuk e kanë edukuar zemrën kundrejt mëkateve të padukshme, nuk ndjejnë neveri kundrejt gjynaheve si përgojimi, mashtrimi, mendjemadhësia, etj. Ndërkohë këto janë mëkate po aq të ulëta dhe të shëmtuara sa mishi i derrit.

Për këtë arsye;

Siç përpiqemi për të qëndruar larg ushqimit e pijes dhe bëjmë peh-riz përgjatë muajit të madhë-rishëm të Ramazanit, duhet të përpiqemi shumë për të qëndruar edhe larg çdo lloj mëkati të shëmtuar si mendje-madhësia, egoizmi, koprracia, përgojimi, thashethemet dhe smira. Sepse këto gjynahe janë vepra të shëmtuara që i djegin dhe i bëjnë hi veprat tona të mira.

“Afrimiteti me të Dërguarin e Allahut (a.s.), në ahiret do të jetë në raport me afrimitetin që kemi me të në këtë botë, sepse çdo gjendje e të dashuruarit ndikon te i dashuri në raport me dashurinë në zemër. Një festë më e madhe se festa e xhenetit është festa e të qenët aty bashkë me Resulullahun (a.s.), sepse ai ka thënë: “Njeriu do të jetë bashkë me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96.)”

Edhe pas muajit të Ramazanit duhet të vazhdojmë të përpiqemi për ta ruajtur shkallën që kemi arritur në atë muaj të bekuar, sepse shenja më e rëndësishme që tregon pranimin e Ramazanit te Zoti është vazhdimi i të njëjtës gjendje edhe pas Ramazanit.

Zoti (xh.xh.), na bëftë prej atyre që i perceptojnë ato festa të përhershme, që përgatiten për to dhe që i arrijnë ato!

Amin!..

**“Festa e vërtetë është një gëzim i përbashkët dhe i përhershëm, është shpëtim nga fatkeqësitë dhe vuajtjet. Është sukses, është arritje, është fitim. Është diploma e arritjes së kënaqësisë së Allahut.”**



# KY ËSHTË NJË SHEMBULL PËR TË GJITHË

— Xhafer Durmush —

Po. Ky shembull është për të gjithë, sepse ky është tregimi i një mashtrimi. Ky është lajmi në lidhje me Bel'am bin Bauran... Sipas transmetimeve që jepen në literaturën e tefsirit, Bel'ami kishte jetuar në kohën e Musait, alejhi's-selam dhe ishte prej dijetarëve të Beni Israilëve. Ai kishte dije të gjerë rreth shpalljes së Allahut Teala dhe ishte njeri i hakikatit, por i besonte dijes më shumë se çdo gjëje dhe pandehte se ajo e mbronte nga gabimet. Ndërkohë që ishte njeri i dashur te Allahu dhe i pranohej lutja, në një çështje e kundërshtoi pejgamberin e Tij. U mashtrua prej disa dredhive dhe u lut keq për të. Ai këmbënguli në këtë gabim dhe e teproi. Allahu Teala thotë:

*“...Shembuj të tillë Ne ua japim njerëzve, që ata të meditojnë.”* (Hashr, 21.) Ndërsa në surel el-A'raf, Mëshiruesi flet për shembullin e Bel' amit, duke e shfaqur me një përngjasim spikatës:

*“Tregoju atyre (hebrenjve) për njeriun, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por u largua prej tyre. Kështu, djalli e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit.”* (A'raf, 175.)

*“Sikur të donim, do ta ngrinim atë (me shpalljet Tona), por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas dëshirave të veta. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, ai përsëri të nxjerr gjuhën. Ky është shembull i njerëzve, që*

***mohojnë shpalljet Tona. Tregojua atyre këto ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë.***” (A’raf, 176.)

Kur lexojmë këto ajete, tabloja që përshkruan pikat kryesore të mësipërme, pothuajse vjen para syve tanë: Mendojmë një njeri që i besoi Allahut Teala. Si rezultat, i Plotfuqishmi ia lehtësoi atij pasimin e Pejgamberit. Të gjitha veprat që bëhen për hir të fesë, janë nga një nder më vete. Këtij personi iu dha mundësia të bënte veprat më të mira. Atij iu dha dija dhe urtësia. Iu dha mundësia për të qenë pranë profetit të kohës së tij. Por ai nuk ua diti vlerën gjithë këtyre. Gjërat që ia dha Allahu Teala, filloi t’i shndërronte në gjëra të pavlefshme. Ai iu bind shejtanit, edhe pse e dinte të vërtetën dhe të gabuarën. U dha pas pasioneve dhe u bë prej të devijuarve...

I ndjeri Hamdi Jazëri, e komenton kështu fjalinë në krye të historisë: “Njoftoi ata për historinë e këtij njeriu të poshtër. Atij i patëm dhënë argumentet tona. Ai pati dije dhe ndershmëri, por i la të gjitha këto. Shejtani e bëri t’i nënshtrohej dhe ai devijoi nga rruga e drejtë...”

Kur mendojmë: “Si mund ta bëjë këtë ai që i beson Allahut dhe ahiretit? Si mund të mashtrohet pas dëshirave të përkohshme, edhe pse e di të vërtetën?” Përsëri në ndihmë na vjen shpjegimi i të ndjerit Elmallëllë: “Domethënë, vullneti hyjnor nuk desh i që ai të qëndronte i fortë në të vërtetën, kështu që u la në gjendjen e tij dhe u bë prej atyre që i binden shejtanit.”

Ja, pikërisht atëherë i luteni Allahut përsëri dhe i thoni: “O Zot! Mos na lër të mbështetemi te vetja jonë, qoftë edhe sa hap e mbyll sytë!”

Dashuria ndaj Kuranit rritet përsëri në zemrat tuaja dhe thoni: “Ja, kjo ishte.” Kjo duhet të jetë mënyra koncize e Librit të Lartë që qetëson zemrat e besimtarëve... Atyre nuk u jep detajet e ngjarjes, por esencën e saj. I trondit me shembullin më spikatës, i inkurajon që të pyesin veten dhe i mëson të kuptojnë gjërat që ndodhin rreth e rrotull tyre.

Mendon: Gjendja e atij që i ndërron virtytet fetare me interesat e kësaj bote, përngjasohet me gjendjen më të keqe të qenit...

Nga shpjegimi i mësipërm mësojmë se synimi i kësaj historie nuk është përkufizimi i personit, i cili përbën temën e saj, por përshkrimi i gjendjes së tij dhe informimi i të gjithë njerëzve, në mënyrë që të marrin mësim nga ai shembull. Themi shembull për të gjithë njerëzit, sepse Kurani Fisnik, e shëmbëllen gjendjen e këtij njeriu të tillë me një gjendje të pështirë, e cila nuk gjendet te asnjë kafshë tjetër në tokë përveçse te qeni...

***“Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, ai përsëri të nxjerr gjuhën.”***

Grada e atij njeriu, që u jep përparësi dëshirave të tij ndaj vlerave të larta të fesë së Allahut, është grada më e ulët e poshtërimit, sepse nuk ka gjë më të keqe sesa të shkëmbesh me këtë botë dijet e vërteta fetare pasi i ke mësuar ato. Ja pra, gjendja e atij apo e atyre që i përgënjeshtrojnë argumentet e Zotit, i ngjan asaj që thamë më sipër. Fundi i tyre është i keq, po ashtu edhe çdo aspekt i jetës së tyre, që i ka mbartur ata te ai fund... Sepse ata përpëliten në detin e një pasioni që ua merr frymën...

Mistikët e kanë shfaqur gjendjen e Bel’am bin Bauras, që jepet si shembull në ajet, si modelin më të qartë të atyre që devijojnë për shkak të mendjemadhësisë dhe dëshirave të kësaj bote. Për sa i përket përngjasimit me “qenin”, kanë thënë se ai përfaqëson nefsul-emma. Sepse qeni këtu përfaqëson dhënien pas pasioneve dhe epsheve, për të cilat bëhet fjalë. Po ashtu, përfaqëson edhe pasionet e shpresat që nuk kanë fund.

Lajkatimi i qenit, pandershmëria e tij dhe shkuarja pas një cope kocke të pavlerë, tregojnë poshtërsinë, apo me fjalë të tjera, gradën më të fundit të poshtërsisë...

Shpjegimi i ajeteve të mësipërme në Ruhul-Bejan është kështu: “Besimtari i vërtetë, edhe nëse arrin gradat më të larta, përsëri nuk mund të jetë i sigurt nga sprovat e Allahut. Asnjëherë nuk mund t’ia mbyllë vetes rrugët e përpjekjes dhe nuk neglizhon për të kundërshtuar veten e dëshirat e tij.” Kështu ishte edhe gjendja e hulefai rrashidinëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.), e sahabëve, e selefu’s-salihin, e imamëve dhe e shehlerëve të vërtetë.



# A MENDONI SE MALET QËNDROJNË NË VEND?

— Dr. Ilyas Kandemir —

Në ditët e sotme, shkenca dhe teknologjia po përparojnë me një ritëm të paparë. Aq sa, falë zhvillimeve në optikë dhe elektronikë, tani mund ta shikojmë botën dhe universin me pajisje më të ndjeshme dhe me sy të ndryshëm. Në objektet që shikojmë dhe ekzaminojmë shohim risi që nuk i kemi parë ose ndjerë më parë. Kjo është e vërtetë për teleskopët që zmadhojnë galaktikat e largëta, si dhe për mikroskopët që na lejojnë të vëzhgojmë materien në nivelin atomik. Këto zhvillime shkencore kanë sjellë edhe zhvillime terminologjike. Me fjalë të tjera, zhvillimet shkencore dhe teknologjike kërkojnë zhvillimin e termave të përshtatshëm shkencorë, dhe kështu gjuha pasurohet. Kjo është arsyeja pse dhjetëra mijëra fjalë shkencore janë krijuar në 70 vitet e fundit.

Sigurisht, nuk mund të pritët që veprat dhe tekstet me përmbajtje shkencore që datojnë prej shekujsh të përfshihen në thesarin njerëzor dhe të pasqyrojnë

drejtpërdrejt terminologjinë shkencore që përdorim sot. Pavarësisht kësaj, është e mundur të përdoren fjalë të përshtatshme që i referohen të njëjtave fakte shkencore, në mënyrë që shoqëritë e atëhershme dhe të ardhshme të nxjerrin rezultate. Nuk është rastësi që një metodë e tillë u zgjodh në librat hyjnorë. Kur shqyrtohet Kurani, i cili ka arritur tek ne si një libër autentik, shihet se ndërsa përmenden këto lloje faktesh shkencore, bëhet një përzgjedhje shumë e përpiktë e fjalëve në aspektin e terminologjisë. Për më tepër, në Kuran, pas shumë referencash të tilla shkencore, theksohet duke u shprehur se njerëzit që mendojnë mund ta kuptojnë këtë. Mrekulli të tilla, të ndërthurura në librin tonë të shenjtë, i cili është një mrekulli më vete, ngjallin kuriozitet dhe rinovojnë besimin e besimtarëve kur arrihet në një nivel që u jep kuptim atyre. Për 1500 vjet, këto vargje shembullore, të cilat duken si fjali që flasin për ajrin dhe ujin për shumë njerëz, kanë marrë jetë dhe kuptim me shkencën në zhvillim.


Le t'i shtjellojmë ajetet 15, 16, 17 të sures Nahl si ajete mësimdhënëse që flasin për ajrin dhe ujin: ***“Ai ka vendosur male të palëvizshme në Tokë, që ajo të mos tundet bashkë me ju, dhe ka krijuar lumenj e rrugë për të arritur aty ku synoni. Ai ka vënë edhe shenja të tjera, si dhe yjet, nëpërmjet të cilave njerëzit orientohen. Atëherë, a është njësoj si Ai që krijon, si ai që nuk krijon?! A nuk po merrni vesh?”*** Fakti që malet janë të qëndrueshëm dhe parandalojnë lëkundjen nuk përmendet vetëm këtu. Për shembull, në ajetin e 31-të të sures Enbija thuhet: ***“Ne vendosëm nëpër Tokë male të patundura, që ajo të mos lëkundet bashkë me njerëzit dhe bëmë lugina dhe rrugë për të udhëtuar në to.”*** Sot, rëndësia e strukturave të rënda malore në strukturën e qëndrueshme të botës sonë kuptohet më mirë.

Nën koren e ngurtë të tokës dhe oqeanëve është një shtresë e quajtur mantel. Kjo shtresë përbën 82% të vëllimit të tokës sonë. Pandehet se pjesët e sipërme të kësaj shtrese janë më shumë statike dhe pjesët e poshtme janë më shumë të lëngshme. Falë lëvizjes rrotulluese të tokës, shtresa e shkrirë është vazhdimisht në lëvizje, duke u rrotulluar në një formë komplekse. Kjo strukturë gjigante në lëvizje pritet të shkaktojë disa lëvizje në koren e tokës. Manteli fillon në një thellësi prej 5 km nga fundi i oqeanit dhe në një thellësi prej 70 km nga vargjet e mëdha malore. Në fakt, vargjet malore, si ajsbergët në oqeanë, shtrihen shumë më thellë nën tokë sesa ngrihen në qiell sipër saj. Sot, lëvizshmëria brenda kësaj shtrese fleksibël manteli konsiderohet të jetë duke u zvogëluar dhe duke u bërë më e qëndrueshme falë pranisë së maleve në shtresën e sipërme. Ajeti i 15-të i sures Nahl dhe ajeti i 31-të i sures Enbija shprehin me terminologjinë e 1500 viteve më parë këtë fakt, të cilin ne mund ta kuptojmë vetëm me teknologjinë e sotme. Përveç të

tjerash, nuk duhet të harrohet roli i vullkaneve në evakuimin e energjisë së grumbulluar nën koren e tokës.

Në ajetin e 15-të të sures Nahl, përmendet gjithashtu se shenjat u krijuan për të gjetur rrugën. Shenja këtu mund të mendohet si një shënues që mund të përdoret për të gjetur një rrugë duke qenë ndryshe nga rrethina e saj. Dallimet në format e tokës përdoren si shenja në këtë kuptim. Në ajetin e 16-të që vijon, thuhet se edhe përdorimi i yjeve është një shenjë për gjetjen e rrugës. Lundrimi duke parë yjet është një metodë e përdorur jo vetëm në tokë dhe det, por edhe në udhëtimet në hapësirë. Pozicioni i një ylli në hapësirë ndryshon pak me rrjedhën e kohës së shkurtër në perceptimin tonë të përkohshëm. Sot, pozicionet dhe lëvizjet e yjeve në qiell mund të vëzhgohen dhe studiohen shumë më saktë se më parë. Sigurisht, edhe rrotullimi i tokës përfshihet në këto llogaritje.

Nëse toka nuk do të rrotullohej, yjet që ndihmojnë në lundrim nuk do të ngriheshin dhe perëndonin si dielli dhe hëna, do të qëndronin pothuajse të palëvizshëm në qiell dhe nuk do të kishte lëvizje në shtresën e mantelit dhe lëvizjet shkatërruese të kores që janë të lidhura me të. Edhe pse këto efekte, të cilat do të ndodhnin në një botë që nuk rrotullohet, duket se janë të dobishme për njerëzit në shikim të parë, realiteti i çështjes nuk është kështu. Sepse po të mos ishte lëvizja rrotulluese e metaleve në thellësi të tokës, planeti ynë nuk do të ishte në gjendje të formonte një mburojë elektromagnetike kundër efekteve të dëmshme të diellit dhe ne do ta humbim atmosferën tonë ashtu siç e ka humbur Marsi. Kështu do të mbeteshim pa ajër dhe të pambrojtur kundër meteorëve. Përveç të tjerash, bussullat tona nuk do të funksiononin si duhet. Madje, edhe rrezet e dëmshme të diellit do të ndikonin negativisht në jetën tonë. Duke treguar këtë, në ajetin e 31-të të sures Enbija, thuhet:





*“Ne e bëmë qiellin një tavan të mbrojtur. Kurse ata ua kthejnë shpinën argumenteve atje.”* Tani mendojmë se mund t'i kuptojmë më mirë këto argumente. Krahas të gjitha këtyre diskutimeve, nëse toka nuk do të rrotullohej, para së gjithash, nata dhe dita nuk do të kishin ndodhur. Në ajetin e 164-t të sures Bekare ceket kjo e vërtetë: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t'u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt.”**

Lëvizjet e erërave dhe reve të përmendura në fund të këtij ajeti duhet të shtjellohen në veçanti dhe në detaje. Këtë e bën të nevojshme edhe fakti që erërat dhe retë shpesh citohen si argumente në Kuran Fisnik. Sepse, siç u shpjegua më lart, ne jemi të informuar se ekziston një ngjashmëri midis maleve të fiksuara të tokës dhe reve në ajetin e 88-të të sures Neml: **“Ti i shikon malet e mendon se janë të palëvizshme, por ato lëvizin si retë. E tillë është fuqia e Allahut, i Cili ka përsosur çdo gjë. Ai di mirë çdo gjë që bëni ju.”** Për këtë ajet janë dhënë përpjekje që të tregohet nga shumë mohues si dëshmi se ka një kundërshtim në Kuran. Megjithatë, me përparimin e shkencës, ne tani e kuptojmë shumë mirë se ky ajet, larg nga të qenit kontradiktor, sipas mendimit tonë, plotëson faktet shkencore të përshkruara në Kuran. Në mekanikën

e lëngjeve, është shumë e rëndësishme që të përfaqësohen me saktësi dy madhësitë themelore pa dimension (numrat Reynolds dhe Mach) të përdorur në analizën dhe projektimin e shumë strukturave aerodinamike nga avionët deri te automobilat. Kjo do të thotë, modelimi i saktë i këtyre dy madhësive, të cilat përdoren në modelimin e rrjedhës së një objekti ose lëvizjen e objektit në lëng, siguron që rezultatet e analizës të jenë aq afër realitetit. Ndërsa numri Reynolds është afërsisht proporcional me madhësinë dhe shpejtësinë e objektit, numri Mach është gjithashtu drejtpërdrejt proporcional me shpejtësinë. Në vetëm dy ngjarje të rrjedhës në botë, lëvizjet e reve dhe maleve, numri i Reynolds është shumë i madh, ndërsa numri Mach është shumë i vogël, me fjalë të tjera, objekti është shumë i madh, por shpejtësia është e vogël. Lëvizja e erës rreth malit, rrjedha e magmës rreth pjesës nëntokësore të malit dhe lëvizja e reve përfshijnë madhësi të mëdha dhe shpejtësi të ulëta. Për një vëzhgues që shikon nga toka, malet duken sikur janë të ngrira, ndërsa malet në të vërtetë kalojnë nëpër lëngun rreth tyre, ashtu si retë... Retë që lëvizin në ajër, me shpejtësi të tyre të ulëta, por dimensionet gjigante të matura në kilometra, krijojnë një lëvizje të rrjedhës që shfaq Reynolds shumë të lartë dhe numra të ulët Mach. Analogjia shkencore e këtyre dy ngjarjeve të rrjedhës, të cilat janë unike për retë dhe malet dhe nuk kanë shembull tjetër në botë, është deklaruar qartë në Kuran, dhe, për më tepër, nga pikëpamja relative e vëzhguesit, në mënyrën më të përshtatshme me gjuhën e asaj periudhe.



# DHIKRI

— Salih Zeki Meriç —

Dashuria ndaj Allahut Teala është një ndjenjë që përbën kulmin e besimit të besimtarit. Besimi shtohet dhe thellohet me këtë dashuri. Nëse dashuria kalon nga gjuha në zemër dhe reflekton nga zemra në vepra, bëhet sublime. Siç duhet që besimi të pranohet me zemër edhe dashuria e vërtetë është ajo që vjen nga zemra. Ato që zemra ndjen në qendrën e saj, e lartësojnë shpirtin. Kjo ndodh me funksionimin e një mekanizmi në botën e brendshme, që mund t'i ndryshojë ndjenjat dhe perceptimet e besimtarit. Ky mekanizëm i botës së brendshme është dhikri, që fillon nga gjuha, zbrit në zemër dhe nga aty, përhapet në të gjithë trupin. Dhikri është një shfaqje e dashurisë së vazhdueshme. Kur robi bën dhikër, e percepton nënshtrimin e tij ndaj Zotit dhe e reflekton në pasqyrën e zemrës admirimin që ka ndaj Tij. Dhikri është dëshira për të qëndruar me Allahun Teala në çdo kohë.

Dhikri që robi bën për Zotin, është falënderim për mirësitë, durim kundrejt sprovave dhe nënshtrim ndaj urdhrave. Është një rregull jete për të mos u ndarë nga orientimi që na ka treguar Zoti (xh.sh.). Një tjetër synim i dhikrit, është edhe pastrimi i nijetit dhe zhvillimi i robit nga ana e Zotit, do të thotë se Zoti është i kënaqur me të, e ka marrë nën mbrojtje, e ka udhëzuar, i ka dhënë largpamësi, i ka dhënë vetëdijen e nënshtrimit dhe ato që ia ka premtuar në jetën e kësaj bote dhe të Ahiretit. Në suren el-Maide, Allahu Teala shprehet se dashuria është e dyanshme: **“O ju që keni besuar! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan, të përlulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit, që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur.”** (Maide, 54) Po ashtu, ka edhe prej robërve që ia kthejnë shpinën dhikrit të Allahut Teala. Kjo është fatkeqësia më e madhe për robin. Kthimi i shpinës ndaj dhikrit të Allahut (xh.sh.), është neglizhencë ndaj Allahut, duke qenë në detin e mëshirës së Allahut. Për këtë arsye, udhëzimi është mirësia më e madhe që Allahu i lartësuar u ka dhënë robërve të Tij. Udhëzimi është si port për një besimtar. Në fillim të çdo lutjeje të besimtarit, duhet të jetë kërkimi i udhëzimit prej Allahut Teala, siç është edhe në suren el-Fatiha, që e lexojmë dyzet herë në ditë: **“Na udhëzo në rrugë të drejtë!”** (Fatiha, 6)

Privimi nga dhikri, nga meditimi në lidhje me kriji-

min e Allahut Teala dhe nga ibadeti, është privimi më i dhimbshëm. Shndërrimi i dynjasë dhe i interesave të saj në synim të vetëm duke u humbur në pasionet mashtruese të saj, është pengesë për zbritjen e mirësive hyjnore. Kjo gjë ia shkëput lidhjet njeriut me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Në këtë mënyrë, nuk e percepton mesazhin që i vjen dhe nuk shqetësohet për gjendjen në të cilën gjendet. Allahu Teala na njofton se ata që e harrojnë, do t'i ndëshkojë me vështirësi në këtë jetë dhe do t'i tubojë të verbër në Ahiret. Këto ajete në suren Taha, e tmerrojnë njeriun:

**“Kushdo që i kthen shpinën këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.”** (Taha, 124)

**“Ai do të thotë: ‘O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë shikoja më parë?’** (Taha, 125.)

(Allahu) **do t'i thotë: “Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e po kështu sot do të jesh i harruar.”** (Taha, 126)

**“Kështu e ndëshkojmë Ne atë që e tepron (me gjynahe) dhe nuk beson shenjat e Zotit të tij. Ndërsa dënimi në jetën tjetër, në të vërtetë, është më i ashpër dhe më i qëndrueshëm.”** (Taha, 127)

Allahu (xh.sh.), na tregon për fundin e keq të atyre që e harrojnë Atë. Po ashtu, na ka njoftuar se njeriu ka një zemër (Ahzab, 4). Në zemër ka formuar një ekuilibër fizik. Në zemër duhet të ketë vetëm një dashuri. Allahu i Madhëruar nuk dëshiron që robi të ketë ndonjë dashuri më të madhe se ajo që ka për Të. Në suren ez-Zumer, thotë: **“A është njëlloj si ai që Allahu ia ka hapur kraharorin për të pranuar Islamin, duke qenë kështu në dritën e Zotit të vet, (ashtu edhe ai që e ka zemrën të mbyllur ndaj besimit!?) Prandaj, mjerë ata që e kanë zemrën të pandjeshme, kur përmendet Allahu! Njerëz të tillë janë në humbje të qartë!”** (Ahzab, 22) Siç shihet edhe në ajetin fisnik, zemra e mbushur me dashurinë ndaj Allahut Teala, zotëron dritë hyjnore.

Zoti, (xh.sh.), thotë në suren el-Bejjine se është i kënaqur prej atyre që besojnë dhe bëjnë punë të mira dhe i cilëson ata si robër të kënaqur nga Ai: **“Shpërblimi i tyre është te Zoti: Kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet.”** (Bejjine, 8)

# Macja ka të drejtë kjo është mendja e kafshëve

— Ekrem Bektash —

Të dashur lexues!

Ju kujtohet macja e fqinjit nga muaji i kaluar. Nëse e lini macen tuaj të uritur, ajo do të vjedhë dhe do të rrëmbejë gjithçka që gjen në kuzhinën e fqinjit.

Macja ka të drejtë, kjo është mendja e kafshëve ...

Përsëri, një ditë, vura re se macja e fqinjit kishte hyrë në kuzhinë... Më saktësisht, macja më vuri re mua:

- Para se të më jepej mundësia për t'i thënë pist, ajo kërceu papritur, u hodh mbi mur dhe u lehtësua kur hyri në shtëpinë e saj.

- Mjafton! - thashë.

I thirra fqinjit:

- Fqinj! - i thashë: Macja juaj është e uritur, ju lutem mbushjani barkun.

Mendova se një grua do të përgjigjej, ngaqë ana tjetër e murit nuk ishte e dukshme.

Një zë i trashë mashkullor erdhi:

Ai tha: Çfarë ke me të, macja jonë ushqehet kudo.

Burri kishte të drejtë... Nuk kishte shtëpi ku nuk hynte macja e tyre. Nuk doja ta zgjasja bisedën. Një herë e zgjata dhe dëgjova gjëra që nuk doja t'i dëgjoja.

Isha gati të kthehesha në shtëpi kur erdhi zëri kërcitës i asaj gruas:

- Fqinj! A keni pleshta në shtëpinë tuaj?

- Pleshta? Jo!

- Po, ka!.. Sa herë që macja jonë hyn në shtëpinë tuaj, kthehet me pleshtat.

- Ashtu!..

- Ashtu, ashtu!

-Atëherë dërgojini pleshtat mbrapa që të paktën t'i shpëtojmë. - i thashë.

Burri e kuptoi se po tallesha. Ai murmuriti, por unë nuk e kuptova se çfarë po thoshte. U futa menjëherë në shtëpi dhe e mbylla portën e bahçes.

\* \* \*

Sa për fqinjin e bahçes në anën tjetër... Ka një mur bahçeje midis nesh dhe atij. Ai nuk ka mace, por ka lule. Çdo verë i rreshton lulet në mur:





- Mirë, por cili është dëmi i tyre?  
- Po, ka... Do t'jua them kur të jetë koha e duhur.

Tani është radha e fqinjit të katit të katërt ...

Ne themi se «kemi një bahçe», por nuk mund të qëndrojmë aty me kënaqësi. Dera e bahçes sonë është në anën e fqinjit me lule... Vazot e luleve <lëkundën' në filladin më të vogël. Muri është mjaft i lartë. Nëse Vazot na bien mbi kokë nga ajo lartësi, nuk e di nëse mund të arrijmë në spital?

I thirra në një ditë me erë dhe i thashë:

- Fqinj! Ato lulet nuk qëndrojnë mirë në mur.

Nuk kishte asnjë pamje, përveç zërit:

- Mirë, mirë... Luleve u ka pëlqyer shumë ai vend.

- Luleve u ka pëlqyer, por mua jo.

- Nëse nuk të pëlqen, mos dil për t'u ulur aty...

Fqinji bëri shaka dhe pastaj qeshi:

-Hahaha, hahaha, hahaha!

Gjithsesi... Nuk i kushtoj shumë rëndësi... Le të flasim për fqinjin në katin e katërt. Ai nuk ka marrëdhënie me ne. Ngjitet me ashensor, zbrit me ashensor. Ne nuk kemi asnjë punë me ashensorin, sepse ashensori nuk ka shërbim në katin e bahçes.

Nëse ashensori prishet, koston e riparimit e ndajnë në shtatë dhe neve na kërkojnë pjesën e parë:

- Ne nuk e përdorim ashensorin, u themi.

Ata menjëherë përgjigjen duke na thënë:

- Përdoren zotëri dhe bëni një shëtitje në katet e sipërme herë pas here.

Fqinjët kanë të drejtë, por qoftë edhe një herë të vetme nuk më ka shkuar në mendje të hip në ashensor dhe të shkoj vërdallë me të. Ne ulemi në bahçen tonë bashkë me gruan. Nganjëherë pimë çaj, nganjëherë kafe.

Një ditë, ndërsa isha ulur në bahçe, një ose dy pika më ranë në fytyrë. Bashkëshortes i thashë:

-Mendoj se do të bjerë shi, një ose dy pika më ranë në fytyrë.

- A bie shi në këtë mot me diell, ty të është dukur ashtu...

Bashkëshortja sapo e kishte përfunduar fjalën e saj kur dy ose tri pika i ranë edhe asaj. Kështu që e ndryshoi fjalën duke më thënë:

-Me sa duket ke të drejtë.

Ajo i ktheu sytë drejt qiellit, më kapi për krahu

dhe më tërhoqi duke më thënë:

-Eja këtej, sepse djali në katin e katërt po urinon.

Bërtitëm me të madhe. Nëna e fëmijës erdhi dhe na tha:

- Ai sapo mëson se si të urinojë...

Çfarëdo që i thamë, ajo as falje që kërkoi dhe tha:

- Po ju keni lindur të mësuar nga nëna?

Gruaja kishte të drejtë, sepse të gjithë e kemi mësuar gjithçka më vonë:

Ne i thamë: Është fëmijë, andaj s'ka problem për të tilla gjërash.

Por nëse ky fëmijë së shpejti do të fillojë të mësojë për të bërë «jashtëqitjen», mendoni se çfarë do të na ndodhë ...

Por sidoqoftë akoma konsiderohemi me fat, sepse, nëse era do të kishte fryrë nga drejtimi i kundërt, nuk do të kishim shpëtuar vetëm me disa pika, por do të ishim bërë qull.

\* \* \*

Tani le të vijmë te fqinji i dashuruar me lulet... Burri është më kurioz se gruaja e tij. Kur u takuam në rrugë, i thashë:

-Një ditë ato vazot me lule do të na bien mbi kokë.

-Vendos një helmetë në kokë kur të dalësh në bahçe. - më tha ai.

Do t'ia thosha atë që meritonte, por burri është më i moshuar se unë. Andaj ula kokën dhe i thashë:

- Do të ishte super, sepse e kam mirë me trimërinë.

Të dashur lexues!

Një ditë ndodhi ajo që ndodhi. Kur macja e 'fqinjit me mace' po kthehej nga lufta e uzurpimit të gjërave të huaja, rrëzoi njëren prej vazove. Pjesa më e fortë e vazos ra pikërisht në mes të kokës sime. Në kokë nuk mbaja helmetë, por mbaja atë tenxheren e vjetër prej alumini të mbetur nga prika e bashkëshortes. Ajo tenxhere, e cila nuk ishte shtypur në asnjëren anë prej vitesh, u shtyp këtë herë.

Shpëtova pa dëm, ngaqë ia dëgjova fjalën fqinjit. Si kemi thënë:

«Gjithmonë dëgjojani fjalën fqinjit. Nëse fqinji nuk ju përshtatet, përshtatjuni ju fqinjit!»

Mirë mbetshi!



# Mos thuaj thjeshtë STOMAK

— Doç. dr. Fërat Erdoan —

Revolucioni industrial ka arritur një fazë të re në zhvillimin e tij shekullor dhe po përgatitet ta transferojë punën në inteligjencën artificiale, pa përdorur arsytimin njerëzor në objektet që ka pajisur me makina duke zvogëluar forcën e krahut. Inteligjenca artificiale do të perceptojë hyrje të caktuara, do të përdorë opsionet e duhura dhe do të prodhojë produktin ideal më shpejt dhe me më pak gabime.

Ajo që kuptoj është; Për shembull, pesë lloje të ndryshme druri dhe disa pëlhura do të lihen në kopshtin e përpamë të fabrikës, dhe dhoma e ndënes më e bukur, e stilit barok, e gdhendur dhe e zbukuruar do të dalë gati në derën e pasme.

Këshilla jonë për ata që thonë jo, që nuk është e mundur në këtë botë, është të shikojnë objektin e integruar të quajtur «Sistemi tretës», i cili ka punuar vazhdimisht që nga dita e lindjes së tyre. Marrëdhënia e tyre është si më poshtë;

Grupet kryesore të ushqimit që hyjnë në gojën tonë janë:

Proteina, yndyra, karbohidrate, vitamina, ujë dhe të tjera...

Ju nuk i merrni asnjë nga këto thjeshtë (pa i shoqëruar me diçka).

Le të mos flasim për një jahni të mrekullueshme që përmban 3-5 lloje perimesh, mish, gjalpë. Më e thjeshta, le të përpiqemi të analizojmë pilafin e orizit.

Orizi është një burim shumë i pasur i karbohidrateve, jep energji shumë të mirë. Ai është gjithashtu një burim i mirë i vitaminave B, të cilat kanë shumë funksione vitale.

Gjalpi... Karakteristika më e rëndësishme e yndyrave është se ato japin shumë energji për gram. Por kjo nuk është e gjitha, është një element jetësor ndërtimor në shumë vende, madje edhe në strukturat më komplekse që janë qelizat nervore.

Peta e shtuar në të përmban një nga drithërat me vitaminat më të pasura.

Nëse themi supë me thjerrëza që do të hahet para tij, mish ose qiçra që duhet vënë sipër, dhe të shoqëruar me ajran, e gjithë revista do të mbushet, por këtë e dimë të gjithë; ajo për të cilën po flasim i referohet një darke modeste në vendin tonë.

Përveç këtyre, merrni parasysh supën e trahanasë me të paktën 10 lloje ushqimesh, ose ëmbëlsirën ashure nga vendi juaj.

Ushqimet bazë janë 4-5 llojesh. Vitaminat; 20 të emëruara. Minerale nuk përfundojnë me numërimin e elementëve.

Ju hani, ndërkohë ushqime të ndryshme që inteligjenca artificiale as që mund t > i imagjinojë, njihen në aparatit tretës, ndahen, treten, bëhen gati për përdorim, ngarkohen në transportues dhe dërgohen në organin përkatës.

Ai që shfaqet me një shumëllojshmëri të tillë të


lëndëve të para, nuk është një divan i vendosur për dhomën tuaj të ndejës, por personi që prodhon botën me fizikun, shpirtin, inteligjencën, mendimin dhe fuqinë e muskujve të tij...

Stomaku është hallka më e thjeshtë në këtë zinxhir kur shikohet nga jashtë. Ai ka një mekanizëm të shkëlqyer valvulash (kapaku) në hyrje dhe një nyje shumëfunktionale në dalje. Të dyja janë planifikuar në mënyrë që ta lejojnë kalimin dhe të mos e lejojnë kthimin. Nëse e keni menduar stomakun si një qese që mbushet/zbrazet midis këtyre dy barrierave perfekte, e keni shumë gabim. Me strukturën e murit të mbështetur nga muskujt që ka, stomaku përziën fizikisht ushqimet e mëparshme dhe i përgatit ato për tretje. Ndërkohë, vendos se kush do të qëndrojë në stomak dhe për sa kohë me matjet që bën vazhdimisht, për shembull, ushqimet yndyrore përpunohen për një kohë më të gjatë. Nëse mekanizmi i valvulave në hyrje bëhet i pamjaftueshëm si rezultat i abuzimit, stomaku e nxjerr lart atë që ka brenda. Ne po flasim për refluksin (kthimin mbrapa) që shihet që te të sapolindurit.

Mirë, por çfarë ndodh nëse një pjesë e përmbajtjes së stomakut futet në ezofag?

Tek një foshnjë 1 javëshe shfaqen të vjella, pa aftësi për të fituar peshë për muaj të tërë dhe kollë që nuk largohet. Nëse të moshuarit diagnostikohen vonë ose nuk trajtohen në mënyrë adekuate, për fat të keq, hapet një rrugë drejt kancerit. Pjesa muskulorë prej 2 cm, ana e poshtme e së cilës formon valvulin hyrës të stomakut, nuk funksionoi. Nyja në dalje është gjithashtu nganjëherë më e ngushtë seç duhet te të sapolindurit. Kjo kërkon operacion urgjent brenda javëve. Por më e zakonshme është lirimi i këtij vendi si rezultat i dietës së papërshtatshme. Kalimi i ushqimit të papërpunuar në stomak çon në ulcerë duodenale.

Ndërkohë tretja kimike është më komplekse sesa këto funksione fizike. Vlera e pH (aciditeti) i lëngut të stomakut është afërsisht 1.5. Në këtë mjedis me acid shumë të fortë, limoni (pH: 2,5) mbetet një lëng shumë i thjeshtë. Le të themi se acidi i stomakut mund të ndryshojë ngjyrën e banakut të kuzhinës prej mermeri si rezultat i gërryerjes.



Çfarë ndodh kur një strukturë e thjeshtë e muskujve që ju e quani stomak ndeshet me këtë acid? Nuk mjafton të thuhet se shkrihet apo shpohet, pothuajse zhduket. Ju hani pa ndërprerje për gjithë jetën, acidi i lëshuar shkrin gjithçka dhe e bën gati për tretje, por nuk dëmton vetveten.

Për shkak se është aq i zgjuar sa që disa qeliza dërgojnë acid në ushqimin në stomak dhe e djegin atë, qelizat sipërfaqësore të mukozës sekretojnë mukus dhe bikarbonat dhe e mbrojnë stomakun.

Cili, kur dhe sa acid ose karbonat do të sekretojë? Kjo është nën kontrollin e hormonit

gastrin të sekretuar nga pjesa e stomakut e quajtur antrum. Çfarëdo që nevojitet dhe sado që nevojitet... Epo, kush do ta vendosë këtë? Qelizat pa inteligjencë të cilat kapin shifrën rreth një trilion në trup. Sipas çfarë? Sipas situatës. Aciditeti i saktë do të sigurohet me matje të menjëhershme, kështu që as ushqimi nuk do të mbahet në pritje dhe i kalbur, as stomaku nuk do të digjet aksidentalisht.

Kur njeriu ndërhyr me sasi të tepërta të çajit të nxehtë, ilaçeve kundër dhimbjeve, cigareve, etj. i gjithë sistemi priset. Qarkullimi i gjakut priset, aciditeti rritet dhe bikarbonati zvogëlohet. Përfundimi negativ shkon deri në shpimin e stomakut.

Ekziston edhe enzima pepsin; «një substancë e ngjashme me proteinën që tret proteinat». Ajo që ju e quani proteinë, për shembull, është 1000 kilodalton (mos pyesni se sa e sata e gramit është), ajo përmban dhjetë mijë aminoacide. Kjo «gjë» e mrekullueshme e quajtur pepsinë shkon dhe i ndan ato një nga një dhe i përgatit për tretje. Aminoacidet e mbledhura me kombinime të panumërta përbëjnë proteinat, kurse këto formojnë pothuajse «gjithçka». Muskujt tuaj, qelizat e trurit, enzimat dhe hormonet e lumturisë përbëhen nga këto aminoacide.

Shpresoj që në numrat e ardhshëm, do ta marrim si bazë këtë pjesë të thjeshtë (!) të sistemit tretës dhe do të vazhdojmë me struktura më komplekse, inshallah. Ne e dimë se nuk mund ta zgjidhim «enigmën e quajtur njeri», por shpresojmë që përpjekja për ta zgjidhur atë dhe meditimi mbi këtë temë, do të jetë një formë mirënjohjeje për Artistin (Zotin).

# Mbulesa

— Rukije Gënyly —

Të mbulolesh, të fshihesh, të kalosh pra-pa dikujt ose diçkaje... Sipas jurisprudencës islame mbulesa (vendosja e shamisë) është: mbulimi i pjesëve të domosdoshme të trupit tek gratë. Pjesët e trupit të cilat duhen mbuluar dhe që është e ndaluar të shikohen nga njerëzit e tjerë quhen: 'pjesë të aurretit'. Përsa u përket çështjeve të aurretit ekzistojnë disa mendime. Mendimi më i fortë (që ka mbështetje më të madhe nga burimet e fesë sonë) na thotë që njeriu duhet t'i mbulojë pjesët e aurretit edhe kur është vetëm. Duke u bazuar në këtë gjë themi se në momentin kur kemi mundësi të gjejmë një veshje të pastër nuk është e lejuar që të falemi pa rroba edhe në qoftë se jemi vetëm në një dhomë të errët. (Ibn Abidin, Reddul-Muhtar, Misir, I, 375.)

Përveç kohës kur bëhet dush apo kryhen nevojat personale, mbulimi i pjesëve të aurretit

është farz; dëshmi për këtë janë Kurani dhe Suneti.

## NEVOJA E NJERIUT PËR T'U MBULUAR

Nevoja e njeriut për t'u mbuluar e ka zanafillën që me njerëzit e parë, me Ademin dhe Havanë. Ja se si e shpjegon ajeti Kuranor se sa gjë e shëmtuar është lakuriqësia:

***“O bijtë e Ademit, le të mos ju mashtrtojë kursesi djalli, ashtu si i nxori prindërit tuaj nga Xheneti, duke ua zhveshur rrobat për t'u dukur vendet e turpshme! Ai dhe shpura e tij ju sheh, prej nga ju nuk i shihni ata. Ne i kemi bërë djajtë roje të atyre që nuk besojnë.”*** (Araf, 27)

Allahu ka krijuar shumë kushte për të ndihmuar veshjen e njerëzve, edhe leshi i kafshëve është një nga këto.

***“Ai ka vendosur male të palëvizshme në Tokë, që ajo të mos tundet bashkë me ju, dhe ka krijuar lumenj e rrugë për të arritur aty ku synoni.”*** (Nahl, 15)

Gjëja më e mirë për njerëzit është veshja me rroba të përshtatshme për fenë tonë.

***“O bijtë e Ademit, Ne ju dërguam rroba që të mbuloni vendet e turpshme, si edhe për zbukurim; por, petku i devotshmërisë është më i miri. Këto janë disa shenja të Allahut, që ju të merrni këshillë.”*** (Araf, 26)

Ne duhet të jemi të kujdeshëm kur shkojmë në një mesxhid apo diku tjetër ku bëhen adhurime dhe të mundohemi që të vishemi me rroba të bukura. Në qoftë se nuk e bëjmë dot këtë gjë, të paktën duhet të kemi kujdes për të mos veshur rroba që mund t'i shqetësojnë njerëzit e tjerë:



**“O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e tepronë.”** (Araf, 31)

### **PËRPPJEKJA PËR T’U MBULUAR (VESHUR)**

Njeriu vishet për t’u mbrojtur nga i ftohti ose nga i nxehti. Ai vishet për të mbuluar defektet e veta dhe për të treguar pjesët e bukura. Për një besimtar, arsyeja kryesore e veshjes (mbulesës) duhet të jetë ruajtja nga shikimet e njerëzve të huaj dhe mbrojtja e trupit dhe shpirtit nga të gjitha llojet e sulmeve.

Në Kuran urdhërohen si burrat ashtu edhe gratë që të ruajnë sytë dhe trupin nga shikimet haram:

**“Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)! Kjo është më mirë për ta!”** (Nur, 30)

**“Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme. Le t’i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre (të kokës) dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre ose baballarëve të tyre, ose vjehërrve të tyre, ose bijve të tyre ose djemve të bashkëshortëve të tyre, ose vëllezërve apo djemve të vëllezërve të tyre, ose djemve të motrave a grave të tyre, ose atyre që i kanë nën zotërim (si skllave), ose shërbëtorëve që nuk kanë epsh ndaj femrave apo fëmijëve që nuk i dinë ngacmimet e femrave. Dhe të mos i rrahin këmbët (për tokë), në mënyrë që të mos duken stolitë**

**e tyre të fshehta. Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin!”** (Nur, 31)

Gratë kur dalin nga shtëpia (ose kur janë përpara burrave të huaj) duhet që sipër veshjes që mbajnë në shtëpi të hedhin një veshje tjetër më të trashë. Ajeti kuranor thotë:

**“O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”** (Ahzab, 59)

Nga ana tjetër, për sa i përket grave të moshuara të cilat nuk presin të martohen dhe të cilave u ka humbur tërheqja që mund të kenë ndaj burrave, u janë dhënë disa lehtësira.

**“Gratë e vjetra, që nuk shpresojnë më të martohen, nuk është gjynah ta heqin mbulesën e jashtme, por jo duke i treguar stolitë e tyre. E, nëse përmbahen, është edhe më mirë për ato. Allahu i dëgjon dhe i di të gjitha.”** (Nur, 60)

Në një ajet tjetër mësojmë se gratë dhe burrat të cilët i mbulojnë dhe i mbrojnë vendet e turpshme do të kenë një shpërblim shumë të madh. (shiko: Ahzab, 35)

### **NË PERIUdhËN E INJORANCËS**

Në kohën e injorancës njerëzit e bënin tavafin e Qabes të zhveshur. Si ditën ashtu dhe natën gratë dhe burrat bënin tavaf të zhveshur dhe për të justifikuar këtë veprim thoshin:

**“Nuk mund të bëjmë tavaf duke mbajtur rrobat me të cilat bëjmë gjynahe!”**



*Aishja tha: ‘Sigurisht që ka disa gjëra në të cilat gratë kurejshe janë më lart se ne, por unë betohem në Allah se nuk ka gra që i besojnë dhe veprojnë më shumë sipas Kuranit se sa gratë ensare. Kur u zbrit ajeti i sures Nur: “**Le t’i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre (të kokës)**” burrat e tyre lexuan këto ajete dhe u kthyen në shtëpi. Këta burra ua lexuan ajetet grave, vajzave dhe motrave. Secila nga këto gra bëri shami nga rrobat që kishte në shtëpi, në mënyrë që të zbatonin ajetet e Librit të Allahut. Mëngjesin pasardhës ato shkuan me shami në kokë për faljen e namazit të sabahut.*



Islami e ka hequr këtë zakon dhe ka këshilluar që si në tavaf ashtu dhe në të gjitha vendet e tjera ku bëhen adhurime të vishen rrobat më të bukura të mundshme.

*“O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.” (A’raf, 31)*

Në Islam, falja e namazit me veshje të pastër dhe të bukur është sunet. Njerëzit, edhe në jetën e ahiretit do të veshin rroba të bukura. Në Kuranin Kerim, kur përmendet shpërblimi i njerëzve që bëjnë punë të mira, përdoren këto fjali:

*“Pikërisht atyre u përket Xheneti i Adnit, nëpër të cilin rrjedhin lumenj. Ata do të stolisen atje me byzylykë ari dhe do të vishen me rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë dhe armaçi, duke ndenjtur të mbështetur në shtretër të lartë. Sa shpërblim i mrekullueshëm dhe sa vendbanim i bukur!” (Kehf, 31)*

*“S’ka dyshim se ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu i fut në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ata do të stolisen me byzylykë të artë dhe inxhi e rrobat e tyre do të jenë prej mëndafshi.” (Haxh, 23)*

*“Aty do t’u shërbehet me enë të argjendta dhe kupa kristali.” (Insan, 15)*

*“Ata do të jenë të veshur me petka të holla mëndafshi të gjelbër dhe me armaç mëndafshi të trashë, të stolisur me byzylykë të argjend-të.” (Insan, 15)*

### **MËNYRA E VESHJES PËR GRUAN**

Pas zbritjes së ajeteve të tridhjetë dhe tridhjetë e një të sures Nur (ajete të cilat i kemi përmendur më sipër), Resulullahu e ka treguar në praktikë mënyrën e zbatimit të atyre ajeteve.

Sipas transmetimit të Aishes, një ditë vajza e Ebu Bekrit; pra motra e vetë Aishes, Esmë kishte hyrë në një dhomë ku ndodhej Resulullahu me një veshje të hollë. Resulullahu salahu alejhi ve selem, e kishte hequr shikimin nga ajo dhe kishte thënë:

*“O Esmë! Femrës që arrin moshën e pjekurisë, nuk duhet që t’i dallohet asgjë përveç këtyre dhe këtyre.” Resulullahu, kur ka thënë fjalët: ‘Këto dhe këto’ ka treguar me shenja: fytyrën dhe pëllëmbët e duarve.” (Ebu Davud, Libas, 31.)*

Për gratë, të gjitha pjesët e trupit përveç duarve dhe fytyrës, janë auret. Sipas një pikëpam-

jeje të fortë, as këmbët nuk janë auret, sepse me këmbë ne ecim dhe njerëzit e varfër mund ta kenë të vështirë që t'i mbulojnë ato.

Përsëri, sipas një mendimi bindës, gratë e lira duhet të mbulojnë edhe krahet edhe veshët. **“...dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme.”** (Nur, 31)

Në hadith thuhet:

*“Pjesa e trupit që duhet mbuluar nga gruaja është auret. Kur ajo del jashtë, shejtani ia ngul sytë asaj.”* (Tirmidhiu, Rada, 18.)

Sipas transmetimit të Aishes radiallahu anha: *“Allahu Teala nuk e pranon namazin e falur nga vajza pa mbulesë.”* (Ibn Maxhe, Tahare, 132; Tirmidhi, Salat, 160; Ahmed b. Hanbel, IV, 151, 218.) Në këtë hadith përfshihen edhe flokët.

Ja se si e shpjegon Aishja herën e parë të vendosjes së shamisë:

*“Allahu i mëshiroftë gratë muhaxhire; kur zbriti ajeti: **“Le t’i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre (të kokës)”** (Nur, 31) ato pre-në copë nga fundi i tyre dhe nga ajo copë bënë shami (për kokën).”*

Safije binti Shejbe tregon.

*“Unë isha bashkë me Aishen. Po flsinim për gratë e fisit Kurejsh dhe për veshjet e tyre. Aishja tha: ‘Sigurisht që ka disa gjëra në të cilat gratë kurejshe janë më lart se ne, por unë betohem në Allah se nuk ka gra që i besojnë dhe veprojnë më shumë sipas Kuranit se sa gratë ensare. Kur u zbrit ajeti i sures Nur: **“Le t’i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre (të kokës)”** burrat e tyre lexuan këto ajete dhe u kthyen në shtëpi. Këta burra ua lexuan ajetet grave, vajzave dhe motrave. Secila nga këto gra bëri shami nga rrobat që kishte në shtëpi, në mënyrë që të zbatonin ajetet e Librit të Allahut. Mëngjesin pasardhës ato shkuan me shami në kokë për faljen e namazit të sabahut.”* (Buhari, Tefsiru Sure, 29/12)

## AURETI I BURRAVE

Tek burrat, pjesa e trupit që duhet mbuluar është pjesa nga kërthiza deri tek gjunjët. Sipas një mendimi të fuqishëm edhe gjunjët quhen auret. Dëshmia për këtë çështje është hadithi i Pejgamberit tonë:

*“Aureti i burrave është nga kërthiza deri tek gjunjët.”* (Ahmed b. Hanbel, II, 187.)

*“Gjunjët janë pjesë e aurretit.”* (Zejlai, Nasbur Raje, I, 297)

## VEÇORITË E SHAMISË

Shamia duhet të ketë një trashësi të tillë që të mos e tregojë atë çfarë mbulon. Mbulesa me një copë që ka ngjyrën e mishit nuk quhet e tillë. Një rrobë e cila e tregon ngjyrën e trupit nuk mund të vishet në namaz dhe nuk mund të përdoret për t’u mbuluar. Në qoftë se veshja është e trashë por lejon që të dallohen format e trupit, namazi është i pranueshëm por kjo nuk është diçka e pëlqyeshme dhe e mira është një veshje e tillë të evitohet.

## MËNYRA E MBULESËS

1- Një grua myslimane para burrave të huaj ose grave jo myslimane duhet të mbulojë të gjithë trupin përveç duarve dhe fytyrës. Mbulimi i këtyre pjesëve të trupit si në namaz edhe jashtë tij është farz. Për sa i përket këmbëve ka disa mendime, por sipas mendimit më të pranueshëm, këmbët mund të rrinë të zbuluara.

2- Gratë mund t’i zbulojnë disa nga pjesët e trupit si: dorën, këmbën, flokët etj.; para burrave me të cilët e kanë të ndaluar që të martohen. (Nur, 31-32)

3- Pjesa e aurretit mes grave me njëra-tjetrën është pjesa nga kërthiza deri tek gjunjët. Përveç kësaj pjesë të trupit gratë e kanë të lejuar që t’i zbulojnë pjesët e tjera. (El- Mavsili, El- Ihtijar, I, 45.) Kur flasim për aurretin mes grave e kemi fjalën për gratë myslimane, sepse një grua myslimane nuk mund të rrijë pranë një gruaje jobesimtare me veshjen që qëndron pranë një gruaje besimtare. Kjo ndalesë është bërë me qëllimin që të mbrohen gratë myslimane nga përkrahimet që mund t’i bëhen tek burrat e huaj. Omer në një letër që i ka shkruar Ebu Ubejde (r.a.), i ka thënë: “Më ka ardhur lajmi që gratë myslimane kanë shkuar në hamam me gratë politeiste. Ky është një zakon që ka mbetur nga e kaluara. Një grua e cila beson Allahun dhe Ahiretin nuk e ka të lejuar që t’i tregojë vendet e aurretit një gruaje që nuk është e fesë së saj.” (Ibn Kesir, Muhtasarut- Tefsir, II, 600, 601.)

4- Në rastet e kurimit, është e lejuar që doktori, mamia, infermierja apo persona me profesione të ngjashme të shikojnë pjesët e aurretit. Është e preferuar që gratë të zgjedhin gra për t’i kuruar. Në rastet kur diçka e tillë nuk është e mundur ndjekim rregullin: “Domosdoshmëria i bën të lejuara gjërat e pakëndshme.”



# Besa e myslimanit

— Ferit Piku —

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin famëlartë: “...**dhe mbajeni besën e Zotit, kur ia jepni Atij, e mos e thyeni premtimin tuaj, pasi keni bërë ndërmjetës Allahun (xh.xh)**”. (Nahl: 91).

Flitet gjithmonë për moralat dhe sjelljet e muslimanit e ata janë shumë. Ata nuk mund të përmeniden në hytbe, ata nuk mund t’i përfshijnë librat. Gjithë jeta jonë është sjellje e moral.

Po mundohemi të flasim për ato morale, që sot po dobësohen e po veniten, por të paktën të përpiqemi që këto morale t’i ruajmë në zemrat e besimtarëve, sepse janë moralat e besimit. Përderisa ka besim në zemrën e besimtarit, duhet të ekzistojnë edhe ato morale.

Morali për të cilin do të flasim këtu, është **mbajtja e besës**. Flasim për këtë moral, sepse sot shumë pak njerëz e mbajnë besën.

Sot njerëzit e drejtë dhe të sinqertë po befashohen nga mosmbajtja e besës. Prindërit që martojnë vajzat e tyre, befashohen kur dëgjojnë pas një farë kohe, se vajza e tyre është në rrugët e Italisë, se burri që i dha asaj vajze nuk e mbajti besën, por e tradhëtoi.

Po dëgjojmë deputetin, që i jep besën elektoratit të tij e sapo hipën në pushtet, e harron besën e dhënë. Po dëgjojmë presidentë, që vënë dorën mbi kushtetutë e betohen për mbajtjen e besës, por edhe ata e harrojnë besën e tyre.

Po dëgjojmë për mosmbajtjen e besës edhe në mes shokëve. Kjo pra është kriza e mbajtjes së besës, por me sa duket jetojmë në atë kohë kur thonë:

“Po të mbash besën, nuk mund të jetosh”. Është ajo kohë kur njerëzit thonë: “Duhet të jesh i shkathët, duhet të dish edhe të mashtrosh, nëse të vjen situata në dorë”.

Besimtari nuk është i tillë, sepse ai beson në ahiret, beson tek Allahu (xh.sh). Besimtari nuk është i tillë, sepse profeti Muhammed (a.s) thotë: “**Nuk ka fe, nuk ka besim ai njeri që nuk ka besë**”<sup>1</sup>.

Ai njeri që nuk mban besën, le ta dijë se nuk ka besim. Besa është mes teje dhe Allahut (xh.xh), prandaj kur të mendosh ta thyesh atë, dije se sipër kokës tënde ke Allahun (xh.xh), të Cilit i ke dhënë besën.

Njerëzit e ngushtojnë shumë konceptin e besës, por në fakt ajo ka kuptim shumë të gjerë. Besa është në radhë të parë lidhje me Allahun (xh.xh), me Zotin e gjithësisë, me Krijuesin tënd. Të gjithë ne i kemi dhënë besën Allahut (xh.xh) para se të vijmë në këtë jetë. Kur Zoti i gjithësisë i krijoi shpirtrat në botën e shpirtrave, u tha: “**A nuk jam unë Zoti juaj?**”? Ata i thanë: “**Posi o Zot, ti je Zoti ynë**”. Atëherë Allahu (xh.xh) tha: “**Kujdes! Mos e thyeni besën tuaj kur të shkoni në dynja, mos e harroni këtë zotim**”. (A`raf: 172). Ne duhet ta mbajmë këtë besë, që i kemi dhënë Allahut (xh.xh). Cilësia e parë e besimtarit musliman, është që e mban besën me Zotin e tij, e të mbash besën me Allahun (xh.xh) do të thotë, të mos i afrosh asaj, që ka ndaluar Zoti i gjithësisë. Kjo do të thotë, që Allahu të të shohë

1. Transmeton Ahmedi dhe Ebu Daudi me varg të pranuar.



aty ku të ka urdhëruar. Kjo është mbajtja e besës me Allahun (xh.xh).

Allahu (xh.xh) u flet të gjithë njerëzve duke iu thënë: **“A nuk më kenë dhënë besën Mua o njerëz, që nuk do të adhuronit shejtanin, nuk do të shkoni pas tij. Ai me të vërtetë është armik i hapur për ju”**. (Jasin: 60). Teorikisht ne ia kemi dhënë besën Allahut (xh.sh), por faktikisht nganjëherë e thyejmë këtë besë, duke shkuar pas dëshirave tona e duke bërë gjynahe. Kështu biem në gradat më të ulta.

Mbajtja e besës më Allahun (xh.xh) është cilësi e besimtarëve, është burrëri, është me të vërtetë tipar, që besimtari nuk duhet ta humbë kurrë. Madje edhe nëse bën gabime, ai duhet t'i rikthehet Allahut (xh.sh), sepse i ka dhënë besën Atij dhe do të pyetet për atë besë.

Ne duhet ta mbajmë besën me Zotin tonë, sepse jemi muslimanë, jemi ndjekës të Profetit Muhammed (a.s) e nuk jemi çifutë, sepse mosmbajtja e besës me Zotin është cilësi e çifutëve. Ata i jepnin besën Zotit dhe pastaj e harronin besën e dhënë. Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin famëlartë: **“...dhe kujtoni të mirat që ju dhashë juve dhe mbajeni mend premtimin tuaj, që Unë të mbaj zotimin Tim ndaj jush”**. (Maideh: 7).

E kemi të nevojshme të dëgjojmë sesi e mbajtën besën e tyre ata besimtarë muslimanë, të cilët nuk patën mundësi ekonomike, por patën besim në zemra. Tregohet për një besimtar plak, i kaluar shumë në moshë, i quajtur Enes Ibn Nadr (r.a). Ky njeri nuk pati mundësi të marrë pjesë me Profetin Muhammed (a.s) në betejën e parë, që u zhvillua mes muslimanëve dhe jomuslimanëve, në betejën e Bedrit. Pas betejës ai i tha profetit (a.s): “O profet i Zotit, unë nuk arrita të marr pjesë në betejën e parë që bënë muslimanët, por në qoftë se Zoti më zgjat jetën dhe marr pjesë në një betejë tjetër, ke për ta parë ti edhe të gjithë besimtarët se çfarë do të bëjnë unë”. Çfarë bëri ky plak, Enes Ibn Nadr?! Kur erdhi beteja e Uhudit, atëherë kur muslimanët u tërhoqën nga beteja, kur shigjetarët e tradhëtuan urdherin e profetit të Zotit (a.s) dhe mbeti vetëm profeti Muhammed (a.s) me një pjesë besimtarësh, që po e ruanin atë, atëherë ky plak besimtar nuk e harroi besën që i dha Allahut (xh.xh) dhe iu turr ushtrisë armike. Një nga besimtarët e kap dhe i thotë: “Ku shkon o musliman? Ata do të të vrasin”. Plaku i përgjigjet: “Pasha Zotin, i kam dhënë besën Allahut (xh.xh) e nuk do ta thyej besën, se më ka mbetur merak që nuk mora pjesë në betejën e parë”. Pasi tha këto fjalë, ai futet në ushtrinë armike. Pas betejës e gjetën trupin e tij me mbi 80-të plagë dhe kufomën e tij të deformuar. Profeti Muhammed (a.s) tha: **“Me të vërtetë ky njeri e mbajti besën e tij”**<sup>2</sup>.

2. Transmeton Buhariu, Tirmidhiu dhe Ibn Ebi Hatim.

Allahu (xh.sh) në Kuranin famëlartë thotë: **“Ka prej besimtarëve nga ata burra që e kanë mbajtur besën, që i kanë dhënë Allahut (xh.xh)”**. (Ahzab: 23). I pari i tyre ishte Enes Ibn Nadr (r.a).

Besa mbahet me profetin e Zotit, me Muhamedin (a.s) e besa që i kemi dhënë këtij profeti është **“ta mbajmë fenë e tij, të mos e ulim atë”**. Besa që i kemi dhënë atij është **“të mos e humbim namazin”**. Porosia e fundit e Profetit Muhammed (a.s) para se të ndërronte jetë ishte: **“O besimtarë, kujdes namazin, kujdes namazin, kujdes namazin!”**<sup>3</sup>.

Ai besimtar që mban namazin, ai ka mbajtur besën përpara Allahut (xh.sh) dhe përpara profetit Muhammed (a.s).

A e dini si ka ardhur feja jonë deri në ditët tona? Mos kujtoni se ka ardhur në rrugë të shtruara me lule e trëndafila. Ka ardhur me gjak të derdhur, ka ardhur me sakrificë. Besa e parë që u mbajt në Islam ishte **besa e ensarëve**, atyre njerëzve që i dhanë besën profetit Muhammed (a.s). Ata thanë: “Vetëm hajde në vendin tonë, se do të të ruajmë siç ruajmë gratë tona e fëmijët tanë. Ashtu siç ushqejmë fëmijët tanë, ashtu kemi për të shpenzuar edhe në fenë tënde”. Ata me të vërtetë e mbajtën besën e tyre. Erdhi koha e u sprovuan shumë. U vdiqën fëmijët, u vdiqën gratë dhe pasuritë u shpenzuan, por ata e mbajtën besën e tyre, derisa Allahu (xh.xh) e plotësoi fenë e tij. Prandaj profeti Muhammed (a.s) vdiq në Medinë edhe pse vendlindjen e kishte në Meke. Nuk i tradhëtoi kurrë ensarët edhe pse u çlirua Meka, sepse ata e mbajtën besën e tyre dhe profeti (a.s) iu pati dhënë besën, që nuk do t'i braktiste kurrë këta muslimanë, që e mbajtën besën përpara Allahut (xh.xh).

Muslimanët kanë ditur ta mbajnë besën me profetin Muhammed (a.s), ta zbatojnë urdherin e tij edhe në qoftë se iu kërcënohej jeta. Tregohet një histori mjaft e habitshme: Në një nga betejat, profeti Muhammed (a.s) u thotë shokëve të tij: **“Në qoftë se do të takoni Ebul Buhturin, mos e vrisni atë, sepse kur ishim ngushtë në Mekë, ai erdhi dhe shpenzoi nga pasuria e tij, e mbajti besën dhe ishte bujar me ne”**. Gjatë betejës njërit prej të rinjve muslimanë iu dha rasti të paraqitej ballë për ballë me këtë person. Sapo e pa atë, iu kujtua fjala e profetit Muhammed (a.s) **“Mos e vrisni Ebul Buhturin”** dhe e anashkaloi. Ebul Buhturi ishte në ushtrinë armike, ishte edhe shumë i fortë, prandaj e pyet: “Pse u largove prej meje? A ke frikë”? I riu musliman i thotë: “Pasha Zotin unë nuk të kam frikë. Unë kam frikë Allahun (xh.xh), por profeti Muhammed (a.s) na ka porositur mos të të vrasim, se ti ke bërë një veprim të mirë e profeti i Zotit nuk e harron atë veprim”. Burri i tha: “Po sikur unë të të

3. Transmeton Ahmedi dhe Tahau i me varg të vërtetë.

luftoj, çfarë do të bësh?” Djaloshi tha: “Unë prapë nuk luftoj, sepse i kam dhënë besën profetit Muhamed (a.s)”. Por Ebul Buhturi nguli këmbë dhe iu turr muslimanit për ta vvarë. Ky musliman u largua, që të mos ballafaqohej me Ebul Buhturin, vetëm e vetëm që të mos thyente besën e profetit Muhamed (a.s). Tregon vetë ky djalë: “Sa herë që ktheja kokën, habitesha se ai po vinte pas meje për të më vvarë dhe isha në një dilemë të madhe: Ta vrisja këtë person, që më kërcënonte jetën apo të largohesha. Vendosa të largohem, por ai ishte më i shpejtë se unë. Kur ktheva kokën një moment, pashë se shpata e tij ishte mbi kokën time. Atëherë mendova se ishte më e rëndësishme për mua që të ruaj jetën dhe u ktheva dhe e vvara atë person”.

Po çfarë bëri ky musliman? Menjëherë në këtë moment, duke qarë e duke u dridhur u kthye tek profeti Muhamed (a.s) duke thënë: “O profet i Zotit unë e theva besën tënde, unë e vvara Ebul Buhturin” dhe pastaj i tregoi si kishte ndodhur. Profeti (a.s) i tha: “**Nuk ka problem, Zoti të fal**”. Shikoni deri në çfarë përmasash arrinte besa e këtyre njerëzve ndaj profetit (a.s)<sup>4</sup>.

Njëherë profeti Muhamed (a.s) i tha një grupi muslimanësh: “**Adhuroni Allahun (xh.sh) dhe mos i bëni shok Atij**” Pastaj iu tha në vesh: “**Mos iu kërkoni kurrrë njerëzve, asnjë gjë**”<sup>5</sup>.

Kaluan disa kohë e këta muslimanë patën vështirësi ekonomike, por nuk e shtrinë dorën, sepse i kishin dhënë besën profetit Muhamed (a.s). Madje kalonin në atë ekstrem, saqë kur ndonjërit prej tyre i binte shkopi dhe ai ishte hipur mbi kalë, zbriste vetë dhe e merrte shkopin edhe pse ishte plak i vjetër. Ata thoshin: “Nuk do ta thyejmë besën që i kemi dhënë profetit (a.s)”. Ata jetuan me besën ndaj pejgamberit (a.s) dhe vdiqën me këtë besë.

Kjo fe ka ardhur me gjakun e dëshmorëve, ka ardhur me besën e burrave, prandaj vetëm burrat mund ta mbajnë këtë fe, vetëm burrat dinë ta mbajnë amanetin përpara Allahut (xh.xh) dhe përpara profetit Muhamed (a.s).

Një vend tjetër ku duhet mbajtur besa është **besa me familjen**, është besa në mes bashkëshortëve.

Është e vërtetë se pjesa më e madhe e njerëzve nuk shkruajnë kushte në aktmarrëveshjen e martesës, por ato kushte dihen, ato kushte janë thënë përpara Allahut (xh.xh).



Kushti kryesor është që bashkëshorti të mos tradhetojë bashkëshorten apo anasjelltas. Burri nuk duhet ta tradhetojë, gruan, kur ajo nuk është në shtëpi dhe anasjelltas. Sot shikojmë krime familjare dhe ndoshta shkaku kryesor i tyre është mosmbajtja e besës. Besa mes gruas dhe burrit është besë ma Allahun (xh.xh). Profeti Muhamed (a.s) ka thënë: “**Nuk di ndonjë besë që mund të mbahet më shumë sesa besa mes burrit dhe gruas. Ajo besë është sekret, është amanet i dhënë përpara Allahut (xh.xh)**”.

Tek besa mes bashkëshortëve hyjnë edhe sekretet që kanë mes tyre. Këto sekrete nuk duhet të dalin në rrugë, por për fat të keq, kjo gjë është bërë epidemia e kohës. Shkaku kryesor i divorceve, i ndarjes familjare është se nuk ruhen këto sekrete.

Feja jonë të mëson ta mbash besën edhe me fëmijët e vegjël. Babai duhet ta mbajë besën me fëmijën e tij, sepse në qoftë se nuk e mban besën, ky fëmijë do të rritet si i ati i tij dhe nuk do ta mbajë besën. Kështu njerëzit rriten duke qenë njerëz të besës ose jo të tillë, sepse edhe të parët e tyre ashtu kanë vepruar.

Feja jonë arrin deri atje sa thotë: “Besa mbahet edhe me armikun, edhe me atë që nuk është i familjes tënde, nuk është i fesë tënde, nuk është i rrugës që ti ndjek”. Besa mbahet edhe me armikun, se është besë më Allahun (xh.sh).

A e dini si kanë hyrë në Islam njerëzit e një qyteti shumë të madh të quajtur Hims, në Sirinë e sotme? Kur muslimanët hynë në atë qytet, u thanë atyre: “Në qoftë se do të pranoni të hyni në Islam, nuk keni detyrime ndaj nesh, por në qoftë se nuk hyni në Islam, keni detyrim një taksë simbolike dhe ne do t’ju ruajmë juve nga çdo armik”. Ata nuk pranuan të bëhen muslimanë dhe paguan taksën. Pas shumë vitesh qyteti i tyre u sulmua nga ushtria armike. Kur muslimanët e panë veten të pafuqishëm ndaj armikut, menjëherë ua kthyen taksat banorëve të vendit dhe u thanë: “Na falni, ne nuk mundëm t’ju ruajmë, prandaj merreni taksën tuaj”. Banorët e qytetit ishin

  
**TA DUASH ISLAMIN,  
DO TË THOTË TA DUASH TË  
MIRËN, TË KESH DËSHIRË TË  
PËRHAPET MIRËSIA, BAMIRËSIA,  
VLERA, E PASTËRTA, TË  
PËRHAPET NAMAZI, TË PËRHAPET  
HIXHABI, TË PËRHAPEN PUNËT E  
MIRA NË SHOQËRINË KU JETON,  
TË KËNAQESH KUR SHIKON  
DIÇKA TË MIRË DHE TË URRESH  
KUR PËRHAPET E KEQJA.**


4. Siratu Ibn Hisham.

5. Muslimi.

kristianë, siç ishte ushtria që po sulmonte qytetin, por u prekën shumë nga sjellja e muslimanëve dhe thanë: “A të tillë njerëz qenkeni ju? S’ka bërë vaki të na japë kush taksat mbrapsht. Kemi pasur edhe të tjerë pushtues. Ata ishin kristianë si ne, por na kanë mbytur në taksa. Nuk kemi parë të tillë njerëz, nuk kemi parë të tillë fe. Që nga ky moment ne jemi muslimanë”. Kështu të gjithë u futën në fenë islame e iu bashkuan ushtrisë muslimane.

Dy nga sahabët kryesorë nuk morën pjesë në betejën e Bedrit. Do të pyesë dikush se për çfarë shkaku! Ndërsa po shkonin për t’u bashkuar me profetin Muhamed (a.s), i kapi ushtria armike, ushtria e kurejshëve dhe u tha: “Ku po shkoni?” Ata thanë: “Për në Medinë”. Ata thanë: “Ju shkoni për të luftuar me Muhamedin kundër nesh. Nuk do t’ju lëmë të lirë, derisa të na jepni besën përpara Allahut (xh.sh), se nuk do të luftoni me ta kundër nesh”. Këta muslimanë u detyruan të japin besën. U detyruan të betohen në emër të Allahut (xh.sh), që nuk do të luftonin me profetin (a.s). Sapo shkuan te profeti (a.s), i treguan çfarë u kishte ndodhur dhe e pyetën sesi duhet të vepronin.

Profeti Muhamed (a.s), ai njeri që ishte njeriu i besës u tha: **“Mbajeni besën e dhënë, mbajeni premtimin përpara Allahut (xh.sh)”. Ne e lusim Allahun të na japë forcën tuaj**”. Profeti (a.s) i tha këto fjalë, edhe pse ushtria muslimane kishte nevojë për numër, por besa e dhënë duhej mbajtur. Këta sahabë nuk e thyen besën edhe pse ajo u ishte dhënë armiqve, atyre që ndoshta do të vrisnin profetin Muhamed (a.s).

Profeti i Zotit e mbante besën e tij. Tregohet se Othman Ibn Talha (r.a) ishte personi, që kishte në dorë çelësat e Qabes. Kur Pejgamberi (a.s) ishte në Mekë, i kishte thënë njëherë: **“O Othman m’i jep çelësat të shikoj Qaben nga brenda**”. Ai nuk ia dha. Atëherë profeti (a.s) i thotë: **“O Othman, ndoshta do të vijë një ditë, kur këto çelësa të bien në dorën time. Çfarë do të bësh atë ditë”**? Ky njeri i tha: “Inshallah nuk jam gjallë deri atë ditë, por në qoftë se vjen puna, që çelësat e Qabes të bien në doren tënde, dëshiroj më mirë të jem i vdekur”.

Erdhi dita që u clirua Meka. Othman Ibn Talha (r.a) jetoi e u bë musliman. Profeti Muhamed (a.s) i tha: **“O Othman më ke premtuar dikur, se nuk do të m’i jepje çelësat e Qabes. A nuk m’i jep ato tani, që ta shikoj Qaben nga brenda**”. Othman Ibn Talha i vënë në siklet i thotë: “Posi o profet i Zotit, tani po shkoj t’ia marr nënës, sepse çelësat i mban ajo”. Shkoi në shtëpi dhe kërkoi çelësat, por nëna e tij nuk ia jepte.

Atëherë Omer Ibnul Hatabi (r.a) shkoi për të kërkuar çelësat. Omeri (r.a) kishte personalitet të madh dhe njerëzit e kishin frikë. Sapo nëna e Othman Ibn Talhas dëgjoji zërin e Omerit (r.a), menjëherë ia dha

çelësat djalit të saj. Kështu Othman Ibn Talha (r.a) ia çoi çelësat profetit (a.s), por ai i tha: **“O Othman ti pate thënë që s’do m’i japësh kurrë çelësat e Qabes dhe unë nuk t’i marr këto çelësa. Unë vetëm do të shikoj Qaben nga brenda dhe çelësat janë prapë të tutë. Askush nuk do t’i marrë ato çelësa prej teje apo prej familjes tënde deri sa të bëhet Kijameti, përveç ndonjë tirani apo zullumqari”**<sup>6</sup>.

Është fakt se edhe sot e kësaj dite, çelësat e Qabes janë në këtë familje, askush nuk guxon t’i marrë, sepse profeti (a.s) i ka dhënë besën kësaj familjeje dhe muslimanët nuk mund ta thyejnë besën e profetit të Zotit.

Në qoftë se dikush nuk e mban besën me Allahun (xh.xh), tek ai njeri nuk ka dobi, ai s’mund ta mbajë besën me asnjeri tjetër, sepse ai s’mban besën me Krijuesin, me Allahun (xh.sh).

Jemi shumë të sigurt, se të gjithë kalojmë momente vështirësie, momente krize, momente dobësie. Secili prej nesh, madje edhe ata që nuk janë muslimanë, edhe ata që thonë që nuk besojnë tek Allahu (xh.xh), i japin një besë Zotit, i japin një premtim Allahut (xh.xh) duke thënë qoftë edhe me ndërgjegjen e tyre: “O Zot, po na shpëtove nga kjo, nuk do të kthehem atje ku ishim”. Por në të vërtetë, kalon koha dhe këta njerëz e harrojnë besën, që i kanë dhënë Allahut (xh.sh). Kjo besë nuk mbaron me dynjanë, kjo besë do të dalë dëshmitare kundër njeriut ditën e Gjykimit.

Të nderuar besimtarë muslimanë! Asnjëherë nuk duhet ta harrojmë besën me Zotin tonë, madje muslimanët kanë obligim të mos harrojnë edhe besën, që prindi i tyre mund t’i ketë dhënë Zotit. Nëse e ke dëgjuar prindin tënd duke i dhënë besën Allahut, që do të shkojë në Haxh, kurdo që të të jepet mundësia, e ke obligim si musliman që ta mbash këtë besë, sepse është besë përpara Allahut (xh.sh). Ai njeri që nuk mban besën para Zotit, le ta dijë se dëmton dhe ul vetëm veten e tij.

Njeriu kalon situata nga më të ndryshmet. Ai shpesh i harron mirësitë e Allahut (xh.sh) dhe nuk falenderon e nuk e mban besën. Harron se një ditë nuk ka bukë për të ngrënë, ndërsa ditën tjetër shpërdoron pa masë. Harron se një ditë është i sëmurë, ndërsa ditën tjetër ngrihet i shëndetshëm dhe e harron veten e tij, harron edhe të sëmurët që janë siç ishte ai.

Lusim Allahun (xh.sh) të na bëjë njerëz të besës përpara Allahut (xh.sh), njerëz të besës me profetin (a.s), njerëz të besës me familjet tona, njerëz të besës edhe me jomuslimanët, madje edhe me armiqtë e Islamit.

Amin!..

6. Transmeton Siratu Ibn Hisham.



## Pse duhet të konsumoni ARRA?

Studimet kanë zbuluar se një regjim ushqimor i pasur me arra dhe vaj ulliri është shumë i mirë për uljen e kolesterolit dhe po aq efikas në rënien në peshë si një regjim i pasur në karbohidrate dhe me ushqime me pak yndyrë.

Sipas ekspertëve, ky nuk është përfitimi i vetëm që arrat i ofrojnë organizmit.

Arrat janë të pasura me yndyrna polio-të-pangopura, të cilat i bëjnë mirë shëndetit të zemrës dhe ulin kolesterolin.

Për të arritur në këtë konkluzion, studiuesit e mjekësisë të Universitetit të Kalifornisë analizuan të dhënat e 245 personave mbipeshë dhe obezë.

Pjesëmarrësit në studim ishin të moshave nga 22 deri në 72 vjeç.

Ata iu nënshtruan tre regjimeve të ndryshme ushqimore.

Regjimi i parë ofronte ushqime me pak yndyrë por të pasura në karbohidrate.

I dyti ofronte pak karbohidrate dhe ushqime me një nivel të lartë yndyre.

Regjimi i tretë ishte i pasur me arra dhe nivel të ulët karbohidratesh.

Ata që ndoqën këtë regjim, konsumonin rreth 40 gramë arra në ditë.

Kjo sasi është e barazvlefshme me një grusht e gjysmë arrash.

Në harkun kohor të gjashtë muajve pjesëmarrësit që ndoqën regjimin me arra humën njësoj peshë si grupet e tjera me dietë.

Ndërkohë, përveç rënies në peshë, grupi i tretë pati më shumë përmirësime në nivelin e kolesterolit në krahasim me grupet e tjera.

Kolesteroli i keq u ul ndjeshëm tek personat, organizmi i të cilëve ishte më i prirur ndaj diabetit.

Kjo nuk do të thotë se mund ta teproni me ushqimet me yndyrë.

### VLERAT SHËNDETËSORE TË ARRAVE

Sipas të dhënave, një regjim ushqimor i pasur me arra ofron yndyrna të mira polio-të-pangopura.

Në fakt, arrat janë të vetmet që ofrojnë kryesisht këtë lloj yndyrnash dhe acidin alfa linolenik.

Ky acid është një formë bimore që rrjedh nga acidet yndyrore omega-3.

Ai është thelbësor për funksionet e organizmit dhe trurit.

Duke qenë se trupi nuk arrin të prodhojë një acid të tillë, organizmi vuan nga mungesa e tij.

Studimi i lartpërmendur është publikuar në revistën e Shoqatës Amerikane të Zemrës.

Publikimi i tij u bë pak kohë pasi shkencëtarët e Harvardit rekomanduan zëvendësimin e yndyrnave të ngopura me ato polio-të-pangopura për një jetë të gjatë dhe zemër të shëndetshme.

A photograph showing several glasses of tea on a wooden surface, accompanied by fresh mint leaves and dried herb stems. The title 'ANTIBIOTIKË bio' is overlaid on the image in large, bold letters.

# ANTIBIOTIKË *bio*

Vjeshta ka shtrirë këmbët edhe pse dielli në këto ditë të bën të mendosh se je në pranverë, por njerëzit që kolliten, tështijnë dhe që nuk duken në punë se janë sëmurë, tregojnë se ka filluar stina e ftohtë.

Është një realitet i trishtë që muajt e ftohtë bashkohen me të ftohtët e gripin, por është një fakt.

Madje edhe më të fiksuarit ndaj higjienës dhe dizinfektantëve të duarve nuk i shpëtojnë dot virozave.

Mundësia për t'u sëmurë varet më shumë nga gjendja juaj shëndetësore sesa nga sa herë i lani duart apo i dizinfektoni, por kjo s'do të thotë që s'duhet të bëni kujdes ndaj ambientit.

Kur vjen puna për t'u mbrojtur nga sëmundjet kujdesi nuk është asnjëherë i tepërt.

Nëse plani juaj për të mos u sëmurë këtë vjeshtë fillon dhe mbaron me të konsumuarit të një gote më shumë lëng portokalli, ndoshta bëni mirë ta rimendoni këtë strategji.

Çaji mbetet ilaçi kryesor për të gjithë, por cili çaj funksionon më mirë?

## ÇAJI I MALIT

Të gjithë e kemi shijuar çajin e malit, një tisanë unike e shumë e shëndetshme, thesari i paçmuar nga i cili mund të përfitohet, jo vetëm duke e konsumuar.

Çaji i malit është një bimë e egër, që rritet në lindje të Mesdheut, veçanërisht në Ballkan.

Ashtu siç edhe emri e tregon më së miri, në

male në lartësi që variojnë nga 1500 deri në 1900 metra, shpesh herë në sipërfaqe shkëmbore.

Të huajt mbarojnë për çajin tone të malit, ndërsa shqiptarë janë mësuar me të dhe drejtohen shpesh ndaj çajrave të botës.

## ÇAJI I MENTES

Ky çaj lehtëson dhimbjet dhe problemet e ndryshme të stomakut dhe ndihmon procesin e tretjes.

Lehtëson të përzierat dhe çrregullimet e spazmave, forcon sistemin imunitar ndaj gripit dhe lehtëson problemet në frymëmarrje.

Elemion aromën e keqe të gojës dhe ndihmon në ekuilibrimin e oreksit.

## ÇAJI I XHENXHEFILIT OSE XHINXHER

Përmban nivele të larta të vitaminës C, magnezit dhe mineraleve të tjera. Një kupë çaji para udhëtimit, parandalon të përzierat nëse ju zë makina.

Përmirëson performancën e stomakut në tretje dhe uron problemet e ndryshme në sistemin e frymëmarrjes duke nisur nga ftohja deri te alergjitë e ndryshme.

Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe lehtëson dhimbjet e ciklit menstrual dhe qetëson muskujt.

Për shkak të nivelit të lartë të antioksidantëve, forcon sistemin imunitar dhe ndihmon në çlirimin e stresit dhe qetësimin e sistemit nervor.

## ÇAJI JESHIL

Çaji i gjelbër përmban përbërje bioaktive që përmirësojnë shumë parametra të shëndetit të njeriut.

Përbërësit e çajit të gjelbër përmirësojnë funksionin e trurit dhe rrisin nivelin e djegies së yndyrnave duke përmirësuar performancën fizike.

Në moshë të thyer, çaji i gjelbër ul riskun e Alzheimerit dhe Parkinsonit. Çaji i gjelbër vret bakteret duke ndihmuar në shëndetin e dhëmbëve dhe uljen e riskut për infeksione.









## "LUX DEKOR"

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e kuzhinave si dhe orendive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve. Bën shitjen e materialit: iverëplaka, MDF, folje për vakumpress, dhe të aksesuarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve – mvëshjen me ultrplast – laminat, si dhe plastifikimin vakumpres – ballonpress te balloreve me folje të pvc-se në dimensione të kerkuara nga klienti, gravirimin e fronteve me makinë CNC, kandimin – qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina të persosur kualitet dhe cilësi të lart.





**VILA DANTE**  
RESTORANT


 ADRESA: TUSHEMISHT, POGRADEÇ

# SHOPPING HOUSE

  
ADRESA:  
RRUGA QEMAL DRAÇINI  
TEK SAHATI, SHKODËR



# ÇAPA<sup>®</sup> musluk



## REYHAN

Kosovë për herë të parë  
me 5 vjet garanci

N.T.SH. REYHAN  
Distributor për KOSOVË

Të gjitha llojet e baterive, rubinetave të CAPA mund  
t'i gjeni tek firma N.T.Sh. REYHAN - Prizren.  
Si dhe mund të gjeni edhe nëpër lokale të tjera  
në KOSOVË

**ELEGANCË, BUKURI, CILËSI  
DHE 5 VJET GARANCI  
ME ÇMIME TË VOLITSHME**



ISO 9001



5 ★★★★★  
Yil Garanti

[www.capamusluk.com.tr](http://www.capamusluk.com.tr)

[www.reyhan-ran.com](http://www.reyhan-ran.com)

*Armatürde Dünyaya Vurulan Marka*

Rr:UCK, Pn Tel: + 381 29 225 555  
Prizren - KOSOVË Mob: + 377 44 115 238

Shitje me shumicë mund të kontaktoni  
përmes telefonave dhe web faqes.



Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,  
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,  
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!




Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,  
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

- 1 Staf arsimor cilësor
- 2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta
- 3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive
- 4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar
- 5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



**CIKLI FILLOR**  
*(djem dhe vajza)*  
**1**  
 NGA KLASA E **1**-RË  
 DERI NË KLASËN E **5**-TË



“Ta dini, se jeta  
në këtë botë,  
nuk është tjetër  
veçse lojë,  
dëfrim e zbukurim,  
si dhe mburrje  
ndërmjet jush  
e rivalitet për më shumë  
pasuri dhe fëmijë!..  
Jeta e kësaj bote  
është vetëm kënaqësi  
e rreme.”

*(Hadid, 20)*